

ODISE KOTE
AMERIKANI
ROMAN

BOTIMET TOENA

ODISE KOTE

AMERIKANI

roman

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Diana Çuli

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Mirjana Madhi

Në kopertinën e parë: instalacion titulluar “unDIMMED” (Të pa-zbehur) /
realizuar nga Valbona Fejza dhe Liridona Ura / Projekti ARTECH /
Fondacioni Gjirokastra.

ISBN 978-9928-376-29-9

© Autori *dhe* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollesha”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

... edhe e vetme, sikur fije e hollë të jetë, nuk humb.

Një ditë do të rritet për të dhënë fuqinë e dëshmisë...

Autori

Udhëtimi në invers i një AMERIKANI

Romani, *Amerikani*, është roman i rënies prej dritës në terr - invers i plotë i idesë së udhëtimit prej ferrit në parajsë. Në fundin e viteve 60-të, “naivi” i lirë, Nelson Andrea, violinisti i ri e i talentuar i filarmonisë së Bostonit, lë Amerikën dhe vendos të vizitojë përkohësisht Shqipërinë komuniste, dheun prej nga iku në moshën dy vjeç.

I tërhequr nga graviteti i një amaneti, artisti i ri bën fajin tragjik; ndjek me ndërgjegje *Exit*-n e gabuar dhe prej parajsës relative, befas përfundon te hyrja e një skëterre absolute - pistës së shkretë të aeroportit të vetëm të Shqipërisë staliniste.

Përmes fatit të Nelson Andreas, Odise Kote synon anatominë e diktaturës komuniste në Shqipëri - një shoqëri e ngritur mbi themele dhune dhe intrige, ku faji është së pari kategori politike, ku sjellja normale penalizohet, ku madje edhe gjestet fare të zakonshme mund të konsiderohen akte subversive.

Portreti i artistit të ri, rritur dhe formuar në njërën prej hapësirave metropolitane më *aflluente* të globit, jepet në sekuenca transformimesh shokuese. Nelson Andrea arrestohet, humbet statusin e njeriut të lirë, zhvishet përdhunshëm nga identiteti dhe pas periudhash burgimi e riburgimi, e gjen veten aty ku nuk e kishte menduar, në pikën fundore të konit, një terr pa dalje.

Stilistikisht, Gjirokastra e Odise Kotes, riimagjinohet me një kolor gjuhësor që i bën skenat dhe karakteret tredimensionale, risjell me nostalgji të matur një komunitet kuazi-kozmopolit e të harruar ku në mozaikun mondan të një bote jo aq urbane, veç hamejve, pijanecëve, lapërdharëve e nëpunësve *çinovnike*, shquhen me efektet e pranisë së tyre edhe një biondinë simpatike ruse dhe një mjek empatik serb.

Për ta bërë më të thyer relievin emocional të romanit, përshkruhet me skena reale vala e një epidemie vetëvrasjesh, e cila i bën më të prekshme përmasat e groteskut tragjik.

Për nga strategjia retorike, *Amerikani*, e ngre kurbën e vet si ndërthurjet e skenave realiste në prozën pikareske. Karakterizimi ndjek parimin e kontrastit midis karaktereve, veçanërisht në tipizimet e bashkëshortes shqiptare të protagonistit - Pandorës, një e pagojë që përpiket të flasë me gjeste - dhe, Hana Erdal, të dashurës nga Bostoni, një amerikano-hebraike që elokuencën e ka pjesë të karakterit.

Zhdukja e beftë e bashkëshortes shqiptare - Pandorës së bukur - në skenën e fundit të romanit, jo si trill, por si një akt vetësakrifikimi, sjell jo vetëm suspensë, por edhe diçka prej frymës së magjishme të baladave arbërore.

Amerikani sugjeron larmi mënyrash leximi, por së pari lexohet si elegji mbi natyrën efemere të lirisë individuale. Rrëfimtari, me pragmatizëm estetik, adapton një ton *omnipotent* e shpesh poetik, shndërrohet spontanisht në një lloj Virgjili udhërrëfyes, jo aq si ndihmë për protagonistin e shokuar sesa për të orientuar vetë lexuesin.

Gëzim Basha

Nuk kishte si ta kuptonte prej nga i vinte ajo krusmë mërzie. Në gojë s'i hiqej një shije hidhërimi. Në kokë i kumbonin fort tingujt e kohës së dytë të koncertit për violinë të Bethovenit. Madje përgjatë fluturimit tingujt sikur ishin strukur brenda trurit dhe mezi prisnin çastin e çlirimit, të dilnin, të bridhnin të lirë nëpër hapësirë. Kishte kënduar me heshtje, cep më cep qiellit të pafund kontinental dhe lotët i rridhnin rruazë pas rruaze. Rridhnin e gremiseshin. Ngjanin se ishin udhëtues, pas tingujve të kornos, zbrisnin në grykë, pa u larguar asnjëherë dhe instinktivisht ai i shoqëronte me tingujt e brendshëm të violinës. Ata tinguj, që violina i luante në pozicionet e epërme të telit, diku në hemisferën e sipërme të trurit që rrihte fort, krijonin më shumë vetmi, një zbrazëti shpuese si vrimat e errëta të qiellit. Pikërisht atë çast iu bë sikur violina e trurit i ra nga dora përposh në humbninën e zezë dhe ai u ndje i vetëm, i pafuqishëm, i dërrmuar.

Kreu I

Ditë e paharruar, 23 maj 1967. Avioni i linjës Vjenë-Tiranë u ul në pistën e ngushtë, të lagur të aeroportit të vetëm shqiptar, rreth orës 23 e 18 minuta. E gjithë hapësira ishte errësirë, me një ndriçim të zbehtë në qendër, sikur një teh kryeneç drite i ishte ngulur natës në brinjë. Me kutinë e violinës në dorë dhe çantën mbi shpinë, Nelson Andrea zbriti shpejt, ndër të parët, shkallëve të avionit *Lufthansa*. Sapo shputat e këmbëve prekën tokën shqiptare, tokën e ëndërruar prej kohësh, atë e ndalën. Pa më të voglin shpjegim dy burra të fuqishëm e zunë për krahësh, e rrëzuan barkas në tokë dhe i hodhën pranga në kyçet e duarve. E kontrolluan fije për fije, gjer në thua. Më pas e ngritën si pupël, i hodhën thesin e xanës mbi kokë dhe e futën në Gazin 69 të degës së punëve të brendshme. Gazi u nis menjëherë. Veç shoferit, ishin dhe dy burra të tjerë të armatosur që shoqëronin. Dëgjohej kohë pas kohe një bisedë e shtruar dhe kolla e thatë e njërit prej tyre që sikur shkulej nga fundi i dheut. Tjetri ishte hokatar. Rrëfente pa pushim histori fshati, me gracka dhelprash, pusi e rrëshqitje burrash nga fiqiri, dredhka, rrëmbime nusesh dhe brinjarë. Rrëfente e qeshte. Të dy pinin cigare të dredhur. Binte erë e keqe. Disa herë iu përzie. Nuk volli. Kur mënjanohej disi, njëri nga burrat e zinte për krah. Dora e tij ishte e fortë si ganxhë hekuri. Duhej të ishte dora e hokatarit, pasi i ndihej fryma që hynte

nëpër vrimat e thesit të xanës, mu brenda veshit të tij. Si të mos mjaftonte kjo, gërvima qaramane e kofanos përzier me erën e padjegur të benzinës vriste pa mëshirë çdo perceptim apo ide që mund të lindte ashtu vjedhurazi. Kur ndaluan ishte ende errësirë. E futën menjëherë në godinën dykatëshe, që ruhej me ushtarë prej portës hyrëse deri në brendësi të godinës. Pjesa ballore e godinës ishte e lartë, tjetra, shtrihej pas si të ishte një kafshëz me bisht.

Fjalja e parë që i tha njeriu që e mori në pyetje ishte: - E dimë se ju amerikanët, që vini në Shqipëri, mund të na bëni dhe gjëmën. - Më pas duke turfulluar shprazi gjithë pakënaqësinë: - Kush u jep lejë ju? Ç'bën kështu kjo ministria jonë e jashtme, është në vete apo jo? - Nelson Andrea ndjeu se ishte në keqkuptim të pashpjegueshëm. Madje në udhëkryq. Përse e kishin ndaluar? Ç'ishte ky njeri që i fliste sikur dëshironte ta lëndonte dhe më pas ta fajësonte për diçka që atij nuk ia rrokte ende mendja?

- Ju lutem, - u përgjërua me një shqipe aspak të saktë. - Më thoni ç'po ndodh me mua? Dokumentet e mia janë në rregull. I kanë autoritetet. Leja e dhënë nga Ministria e Jashtme përmes ambasadës shqiptare në Vjenë, dokumentet e tjera të verifikuara edhe nga Ministria e Brendshme, janë të gjitha tek autoritetet. Atëherë përse jam këtu? - Pas këtyre fjalëve, marrësi në pyetje, një gjatovino veshur plot sqimë, me kollare me kuadrate të vogla, duke folur një anglishte të pastër i jep përgjigjen më të pabesueshme: - Amerikan, në dosjen tënde gjeneralitetet kanë disa mospërputhje serioze.

- Ndërkaq sytë e tij kishin marrë një dritësim të çuditshëm që ngjasonte me atë të një nuselale në çastin kur pikas prenë. - Deri në verifikimin e sqarimin përfundimtar jeni në paraburgim, në pritje. Të shohim sesi do të venë gjërat!
- Pas kësaj fjalie të thënë si me ngut, sytë e tij u zbardhën si të bëheshin gati të shuanin errësirën brenda tyre. Nelson Andrea mbeti shtang, si mumje.

Gjatovinoja nuk erdhi më, por fjalia e tij “Të shohim sesi do të venë gjërat!” ia ngriu zemrën. Ai sikur ia paratha fatin. Ende pa zbardhur nata dy hetues dhe një daktilografist hynë në dhomën ku e mbanin të izoluar. Ata nuk pritën shpjegime prej tij, por e akuzuan menjëherë si agjent në shërbim të KGB-së sovjetike, infiltruar në Shqipëri si shtetas amerikan.
- Të dyja superfuqitë e kanë pjesë të punës infiltrimin e agjentëve të tyre në radhët e kundërshtarëve, - i tha njëri prej hetuesve, duke i përmendur miqësinë me njëfarë Nikolae, violinist rus që studionte në konservatorin e Bostonit dhe me një vajzë hebreje të ardhur nga Lindja, Hana Erdal. - Akuza i ngjau e pështirë, absurde, e mundimshme, por i tulatur siç ishte nuk gjeti forcë të reagoonte si duhej. Hetuesit e përkthyen heshtjen si thyerje, si fitoren e parë.

Dy muaj hetuesi e rëndë nuk mundën ta mposhtnin Nelson Andrean. Asnjë provë qoftë dhe e tërthortë nuk u gjend. Dhuna, argumenti shtesë gjatë marrjes në pyetje

nuk funksionoi. Ai u bë i heshtur, gojëkyçur. Argumenti i agjentit të infiltruar sovjetik në Shqipëri nuk dukej bindës. Nuk u gjet asnjë lidhje tjetër, as ndonjë shenjë adhurimi ndaj Bashkimit Sovjetik, asnjë mundësi depërtimi diku. Gjithçka shterpë. As përgjuesit e fshehtë nuk regjistruan dot ndonjë rrëfim, monolog apo çast shpërthimi në vetmi. Por, e gjitha kjo, mos ndoshta ishte një gabim? Hetuesit e përgjonin gjithë kohës. Ai i ndiente shikimet e tyre të mbushura me dashakeqësi dhe mosbesim. Kur kishte humbur çdo shpresë, e çuan në gjykatën ushtarake, ku trupa me tre gjyqtarë, pa asnjë provë e dëshmitar dha shpejt e shpejt një vendim të çuditshëm: “Dënim në emër të popullit me një vit e katër muaj burg për shkelje të territorit të Republikës Popullore të Shqipërisë përmes dokumenteve të falsifikuara”. Vendimi hyri në fuqi menjëherë, e futën sërish në një Gaz 69, që e shpuri të vuante dënimin në burgun e Ballshit.

Kur e hodhën si leckë në dhomën bosh, të atij burgu, kuptoi që hetuesia ndaj tij nuk kishte përfunduar akoma dhe se ajo ishte dhoma e marrjes në pyetje. Kalvari i vërtetë sapo kishte nisur. Prapë hetuesi? Përballë tij ishte një karrige. Në tejanë gjendej tavolina e vogël, makina e shkrimit sipër dhe një llambë vajguri që lëshonte fare pak dritë. I dhembte koka egërsisht. Sikur një dorë e padukshme e gjuante mizorisht, nga pas, pa ndalur, me çekiç në tëmtha. Acarim i mprehtë, ndjesi ankthi dhe erë e padurueshme gazi e vajguri iu bë lëmsh në stomak. Në sy ndiente qelqe xhamash të prerë që e shponin me tërbim. I digjte barku.

Gjumi po ia shtrëngonte nofullat si të ishte morskë metalike. Nuk i kishte mbetur asnjë pikë fuqie në muskuj. Si gulç po e shtrëngonte në fyt edhe gracka e arsyes që s'pranonte asnjëfarë përgjigje. Kur u kthjellua disi pa se një gjatovino syskifter ishte ulur përballë. Hollak, shufër lajthie, ngjante i mbirë nga hija. Koka e tij ishte varur pa peshë mbi dy supet e rrëgjuara. Papritur mendoj se ai vinte nga ndonjë rreth ferri. Gjatovinoja syskifter e pyeti për emrin, familjen dhe arsyen: përse kishte ardhur prej asaj Amerike në Shqipëri? Ai u përgjigj shkurt e drejt. Foli sikur jetonte në kufi, midis asaj bote dhe kësaj tjetrës që nuk e njihte. I tha se një borxh i madh e detyroi të vinte në Shqipëri. Duhej të nderonte me shenjtëri, në banesën e fundit, gruan që u kujdes për të kur nëna e tij mbylli sytë sapo e solli në jetë. Ajo u bë gruaja e dytë e babait. Grua për kokë të gruas, por që nuk iu bind atij kur i kërkoi të linin Shqipërinë në vitin 1944 dhe të iknin në SHBA. Gjatovinoja syskifter duartrokiti. - Prekës e mallëngjyes ky shpjegim, - shpërtheu në gjysmë zgërdhitje cinike. - Hëm. Histori që s'besohet lehtë, gjithsesi është më mirë sesa pa asnjë alibi. Dhe ti nuk pyete për asgjë, apo jo Nelson Andrea? - i përmendi ai emrin. Qeshi dhe rrëfeu një histori të ngatërruar, me fund hidhërak. Rrëfeu për dikë që e ndiqnin teksa vjedhtas kishte hipur mbi një çati. E gjuanin nga të katërta anët me çifte. Përpiquej i ziu të mbrohej, po, më në fund, një kapsollë e zuri në pulpë të këmbës dhe u rrëzua. Ra nga gjithë ajo lartësi e përsëri nuk e uli kokën. E po unë për të zbritur kisha! - dhe shau me rrënjë e degë ndjekësit e pashpirt. - Ja kështu Nelson Andrea! - Përmendja përsëri e emrit nuk ishte ngasje për të thyer monotoninë. Për të parën herë ndjeu turbullim. Ngriti kokën dhe kur sytë e tyre u

përqasën sikur u shpall diçka, diçka e murrme, e paformë, ajo që nuk mund të fshihej më kurrë. Ishte armiqësi apo thirrje misterioze për kompromis? Shikimi i tij digjte. Ingjau se ai e kërcënoi: “Ta dërgoj shpirtin në ferr dhe zemrën ta pjek atje në heshtje të harresës. Fol me të vdekurit njëherë, që të kuptosh më mirë të gjallët e mbijetuar, se do të kalbesh gjithë jetën në këtë burg. Mos ia fsheh vetes të vërtetën që e di se qëndron në fund të ndërgjegjes”. Nuk tha asgjë nga këto. Në ngasje të parrëfyeshme tërhoqi karrigen, e afroi pranë tij dhe foli me një zë të shtrajjtshëm, të mprehtë si brisk, që ngjasonte me turjelat e holla që futen imtësisht në dhëmballën e qelbëzuar. - Të gjithë e kemi nga një sekret, - dhe sytë e gjatovinos u ngulën në thelbin që e gërryente parandjenjën e tij shqetësuese, parandjenjë që nuk arrinte ta përmblidhte, e më pas ta zhbirilonte. - Të kthehemi tek ne të dy. Si thua? Heshtja tënde mund të na kushtojë jetën të dyve. Kohët e fundit edhe profesioni im ka qenë disi i paqartë. Bota është e Zotit, thoni ju të asaj Amerike. Le t’i gjykojë Zoti disa gjëra. Po vallë Zoti a e ka mendjen tek unë? Një muaj më parë më ngjau kthesa më e papritur e jetës. Më transferuan këtu në këtë humbëtirë, në këtë moçal. Përse? Mos ndoshta për një provë të re? Papritur u shfaqe ti, dhuratë nga qielli apo mallkim? Mos je ti prova? Ti do të jesh ose varri, ose shpëtimi im. Le të mos i humbasim kohë njëri-tjetrit.

Jashtë dritareve gjysmë të hapura u dëgjuan shkrepitima shtrëngate në qiell. Pastaj nisi shi. Pikë-pikë, mijëra gjilpërëza uji e disa currila nisën të hynin gjithandej në dhomën e pyetjeve. Ishte e pazakontë se si gjatovinoja syskifter ia shqiptoi sërish e sërish emrin: Nelson Andrea.

Duke kuptuar etjen e tij, gjatovinoja syskifter i ofroi kanën me ujë. Nelson Andrea i çuditur me veten a me faktin që ende s'kuptonte asgjë, piu i babëzitur, si për të mbushur ashtu atë farë boshllëku që ndiente në lukth të kraharorit. Gjithçka dukej absurde, jashtëtokësore, nën atë shi të imët, të pjerrët, si lot të verbërish, në mes të qiellit dhe erës. Riprodhonte copëza e copëza prej ngulmimit të tij të lodhshëm e disi të rrëmbyeshëm dhe vetja i ngjau i zhbartur prej fajit, ngase ishte stepur. Kishte rënë në atë gjendjen e çuditshme të përhumbejes e vetëharrimit. Megjithatë një ngërmim i errët, i fjetur, shqiptimi i emrit që kumboi si jeh mallkimi e ndërkreu. A mos ishte jeta e tij një komedi e panjohur dhe ai vetëm duhet të mësonte të qeshte? - Dua avokat, - thirri dhe nuk besoi se ato ishin tingujt e grykës së tij. Gjatovinoja syskifter skërmiti dhëmbët me neveri, dhe një vragë iu krijua befas mbi vetull. Vragë si e çarë thike. Nelson Andrea nuk e duroi dot atë skërmitje poshtëruese. Ai kuptoi, më në fund, se ishte i pashpresë, se ishte veç një kafshëz e sertë, e kapur, futur brenda kafazit, që mbyste ulërimën e vet. Vështroi trarët e dhomës si kërcisnin, si thyheshin, duke u tkurrur e psherëtirë me spërdredhje dhimbjesh të mundimshme, në një përpëlitje të skëterrshme prej qeniesh të gjalla. Vetëdija e vagullt për gjendjen ku ndodhej e shtyu të besonte se ishte gremisur në atë zonë të errët, të paarritshme prej dritës, ku çdo rreze që hyn, gëlltitet për të mos u dukur më. E kishte ajgëtuar e pllakosur sakaq lodhja, rrënimi, në atë zellin e ethshëm të mposhtjes. Por teksa frikej e fikej, ndjeu diçka përbrenda që e këndellte, që e tërhiqte kundër humbjes dhe fatit që të braktis. - Të paktën më thirr një prift të rrëfëhem, - u lut pa shpresë. - Dëgjoje

rrëfimin tim dhe do të bindesh! - Hija e murrëtyer, e sertë e gjatovinos syskifter, me kufizim me sa dukej dëshpërues të mendjes u egërsua: - Dëgjo këtu ti imperialist: Kishat kemi nisur t'i shkulum, ne. Ju që i keni, mbajini. Pijuni lëngun! Helm do të pini! - Nofka "imperialist" që ai nuk e kuptoi përse iu tha, nuk do t'i shqitej gjer në fund të hetimeve. - Jam djalë i një poçari të ndershëm, - ndryshoi kësaj here timbri i zërit të skifterit. - Poçari kur e mbaron katruven me baltë nuk harron t'i vendosë dhe vjegën. Që njeriut të mos i bjerë nga dora e të thyhet. Duhet vjega që katruvja të jetojë e të mbahet në duar, brez pas brezi. Dhe unë i vendos vjegën çdo të panjohure, çdo misteri sado i thellë qoftë. Mbaje mend dhe mos e harro këtë gjë. Nuk iki nga kjo dhomë pa vjegë. Te kjo dhomë kanë hyrë me dhjetëra armiq të popullit. Kanë hyrë si luanë e kanë dalë si lepuj, si qengja. Mos e kërko fatin e tyre. As mos e ndill. Ndjesa dhe falja janë një udhëtim i mbarë. Ndaj këtu do zbrazesh. Do më thuash fije e për pe se kush të ka dërguar dhe për kë punon?

Ah, ja ç'na qenka gjithë ky fjalim! Ky zë balte. Nuk kishte më fuqi të dëgjonte. As të mendonte. Qe shterur. Dëshironte të rrëzohej. Të binte. Të mbyllte sytë. Nuk donte as të fluturonte në largësi të pamat. Ndihej i tëhuajtur, i shpërnjohur, si një makth pa shpjegim. Ishte në një tjetër tokë, në një tjetër qiell, të errët, plot shkrepitima të frikshme, a thua koha që grindur me zotat dhe ashtu e ngurosur, në mëri nuk dinte ç'të bënte?

Pa ëndërr të çuditshme. Ëndërr dite. Shtrirë mbi batanije të zezë. Lerosur me vajra e baltë. Në qeli. Dy të burgosurit e tjerë Sako Premti dhe Zija Përlushi flinin të mbledhur kruspull. Ndërsa ai pa në ëndërr sikur dirigjenti i filarmonisë John Bryanti i kishte besuar rolin e solistit në koncertin për violinë e orkestër në A minor të Antonin Dvorakut. Besim dhe vlerësim i epërm. Ndihej në qiell të shtatë. - Mua? Vërtet? Si ka mundësi? Kaq besim të... - nuk mundi ta përmbyllte habinë përzier me gëzim. - Po, po jeni përzgjedhur ju, Nelson Andrea.

Një vit më parë, sapo përfundoi studimet në Akademinë Shtetërore të Arteve dhe u regjistrua menjëherë në konkursin shtetëror për një vend violinisti në orkestrën e madhe simfonike të Bostonit. Studimi i jashtëzakonshëm dhe talenti u shpërblyen. Fitoi. Prej gjashtë muajsh ishte njëri nga tre muzikantët e rinj të Orkestrës. Po a mund të ishte solisti? Violina e parë? Kjo ishte ëndrra e ëndrrës. E ndau sfidën me Hanën, Hana Erdalin, e dashura hebreje nga Nju-Jorku, studente në vitin e tretë të Akademisë dhe vendosi të nisë menjëherë nga provat. Të dy bashkë u ngjitën në ballkonin e pasmë të shtëpisë dykatëshe të Andrejve, me pamje nga pylli, plot mëshetekna e blirë, vendosi partiturat në legion e drurit dhe hapi kutinë e violinës *Stradivari*, dhuratë e babait në njëzet vjetorin e lindjes. Me padurim lëmoi ëmbël telat me pastë, mbështeti mjekrën mbi gushë, në drurin e bekuar, rregulloi e shtrëngoi disi akordet me gishtat e gjatë e të hollë dhe e ngriti pastaj harkun gati për interpretim. Po çfarë? Si një bisk me brymë që thuhet e bën krrak, krrak, në vend të tingujve melodiozë, në ajër rrëshqitën pëshpërima. Tinguj pa kuptim, pa ngjyrë, pa ide. Ato u

tretën shpejt si mërzi që dilnin prej shpirtit, prej pafuqisë për të thënë diçka të plotë, të vërtetë. Frika qarkullonte e rrokullisej nëpër ato pëshpërime. Por, vetëm një pjesë. Jo e gjitha. Tjetra që mbetej, rrinte e strukur. Ku? E strukura donte të thoshte se asgjë nuk kishte mbaruar dhe se ai do të luftonte për ta zhbërë të gjithë frikën. I zënë në kurth nga kjo shtrajtë tingujsh paranojakë, ngatërruar në labirinte të panjohura, u zemërua me veten dhe kuptoi që zemërimi i vinte prej hutisë të shpresës. Hana jo vetëm që nuk u nxeh me zemërimin e tij, por befaz u duk më e afërt, më intime. Si mundej? Heshtja fryhej e veshtullohej. Në kujtesë iu përtëri me qartësi të padurueshme propozimi i dirigjentit, fjalët e thëna, mirëkuptimi dhe besimi i tij. Nuk kishte asnjë nënkuptim që fshihej pas atyre fjalëve, nëse vërtet fshihej diçka, dhe befaz ndjeu se e keqja i kishte mbërritur nga diku tjetër. Ajo “diku-ja tjetër” ishte e paqartë, egërschane, e pazbërthyeshe, pushtuese dhe që s’mund të kthehej dot mbrapsht. Ç’që kjo e keqe e pakuptueshme, pa shenjë, pa shpjegim paraprak që e goditi aq shpejt, shtizë, si në zbardhje të vetëtimës? Aq sa ndiente dëshirën për sqarim, për shuarje të dyshimeve, për të dalë, në fund të fundit, nga ky mjegullim, po aq atë çast, madje më ethshëm, ndiente dëshirën për t’u fshehur përsëri diku brenda saj, në ngulm, për të fituar kohën e zhbirimit, deri në shterim. Ç’ishte ky tejçim pëshpërime që e kishte pushtuar e topitur mendjen e tij, tejçim si e folur nën narkozë? Hapi sytë vrikthi e brofi në këmbë. U ngrit dhe vuri re se i kishin hedhur një kovë me ujë të qelbur në fytyrë. Kishte fjetur disa orë mbi një dyshek prej balte dhe trupi i dhembte për dreq. Nga kuadratet e hekurave të dritares së ngushtë që binte pjerrët mbi kokën e

tij, vuri re se lart, qielli ishte përplot vizatime të çuditshme nga retë e murrme.

Berberi i burgut ia qethi kokën zero. Gardiani e urdhëroi të hiqte xhakëtën e re, stof me kuadrate dhe në vend të saj i hodhi krahëve një kapotë të vjetër ushtarake në ngjyrë të papërcaktuar, zhgun, zhul e vjetrim. E nxorën jashtë në shesh ku ishin të rreshtuar të burgosurit e tjerë. Pas pak ra një çangë shurdhuese dhe pas saj fërshëlleu një bilbil shefi. Të burgosurit u nisën në punë. Vargan. Ecnin njeri pas tjetrit. Kokulur. Në të dyja anët, para e mbrapa shoqëronin policët kujdestarë me automatikët në krahë. Vendmbërritja ishte një orë larg. Ecnin në tokë të nginjur me serë, vajra, naftë e ujëra të qelbura që e kishin ngjyer keqas sipërfaqen duke zhuritur barin e bimësinë. Diku-diku, shfaqeshin gropëza, diku syprina të tokës që bënte guf-guf. Andej dilnin gazra të zeza, zjarr dhe derdhej lëng i tejnxeur. Pjesa më e vështirë ishte ngjitja përtpjetë në kodër. Vendi ishte mbushur me atë gurin gri në të kaftë, gjithë të çara e vrima përsipër, vende-vende i thërrmuar sikur të qenkësh spërkatur me gaz. Në rrëpira të thella, si të ndukura e të shqyera nga shakullimat dhe erërat, kishin mbirë ca pemë të ngjeshura maresh të kuqe që i jepnin tablosë ngjyrat e thella të përgjakjes. Era e rëndë që nuk linte të rritej as idhnakun, atë bimë të trishtuar rrafsh me tokën, nuk ia kishte dalë të frenonte rritjen e bimësisë tjetër, gjembaçe të gomarit, xana, shkurre, ferrat gjithfarëlloj, driza e gorrica të egra, të shkurtra e shtrembaluqe për dreq, që kishin mbushur kodrat

e ulëta të vendosura si në rresht njëra pas tjetrës. Ja, mu aty do të mbërrinin. Do të pastronin e bënë dyst të gjithë sipërfaqen e kodrës, si koka e qethur zero e të burgosurit të ri. Do t'i shkulin vetëm me duar e lopata, me ato pak kazma e vegla pune që komandoreshin me vigjilencë nga rojat kujdestare. Kodrën më pas do ta punonin në tarraca për ta mbjellë pastaj me ullinj. Ajo ditë i ngjau skëterrë. Puna ishte rraskapitëse. Rojat me automatikë mbi kokë. Gëk. Asnjë fjalë. Ai kishte ambicie të egër dhe ndërgjegje pune. Kombinim aspak me vend për atë vend ferri. Shkulte gjithë zemërim shkurre e ferra sikur të shprazte aty bezdinë e menjëhershme, vetminë kobzezë dhe fatin e pakuptimtë. Kishte ende një fije shpresë se ndoshta keqkuptimi i krijuar do të sqarohej, do të zgjidhej, më në fund, gjithçka. Nuk ka mundësi që njeriu të mos merret vesh me njeriun! A nuk ishte ai një qytetar i zakonshëm i kësaj bote që kishte ardhur në tokën e të parëve, nga matanë oqeanit, për të nderuar në banesën e fundit nënën e tij të dytë? Gruan që e vuri në prehërin e saj. Që e rriti. Të nderonte Marien për kokë të Maries! Marien me gërshetin e gjatë, të verdhë, si kalli gruri. E mbante mend se si luante me gërshetin e saj. Si qeshte. Iku dy vjeç nga Shqipëria, vetëm me babanë, në SHBA. Maria s'pranoi që s'pranoi të martohej me Sotir Andrean. Jo se nuk linte kokën për të, por, sepse nuk donte të linte të vetme në fshat nënën e saj të sëmurë nga tuberkulozi. "Ik", i tha babait. "Ik në kështetën tënd. Kështu paskësh qenë i shkruar fati im!" Dhe ata ikën. Babait i mbeti koka pas. Pas vdekjes së nënës, Maria u bë gruaja e dytë e babait. Grua e fortë, llërëngjeshur. Me pulpë të trashë të këmbës. Gjithë ditën punonte të mbante dy shtëpi, të sajën dhe të tyren. Të

gjithë në fshat besonin se Maria do të ikte një ditë bashkë me babain. Por, nuk ishte e thënë. U zhgënjyen. Maria nuk e braktisi mëmën e saj. Gjithë kohëve atje në Boston, ku u vendosën, babai nuk e harroi asnjëherë Marien. Babai u martua sërish. Me Davën, gruan kuzhinierë, skocezen që punonte në restorantin e tyre, me të cilën lindi dy fëmijë të tjerë, vëllain Piter (që babai e thërriste Petro) dhe motrën Sofi që u pagëzua me emrin e gruas së parë, të nënës së ndjerë. Derisa mbylli sytë, babai kishte vetëm një amanet për të: “Nëse nuk do të jem gjallë, do të shkosh ti te Maria në Shqipëri, t’i mbyllësh sytë e kulluar nga mirësia, ta çosh me nderimet e duhura atë shenjtore në banesën e fundit. Në Vasilikua. T’i bësh varr të madh”. Dollarët për këtë amanet babai i kishte hequr mënjane në llogari bankare. Por nuk e mbërriti dot ditën, pasi iku nga kjo jetë shtatë vjet më parë. Amaneti ra mbi të. Sa një mal. Kur erdhi koha e përmbushjes së tij, u nis. Pa pyetur për asgjë. Fluturoi mbi oqean. Nga Vjena mori linjën për Shqipëri. Por... ja, tani e gjitha kjo i ngjante si përrallë. Ja si përfundoi. Për herë të parë pas gati dy muaj e dyzet e tetë orësh i erdhi keq për veten. “Por ndoshta kjo është një provë e Zotit që duhet ta kapërcej!”, u mbush me kurajë. Qëkur është krijuar bota kanë ndodhur miliarda keqkuptime, gjëra qesharake. Janë dënuar shenjtore për mëkatarë dhe anasjelltas. Por gjërat në fund janë sqaruar. Ky mendim sikur e ngrohu, e ngushëlloi dhe e shestoi urinë e tmerrshme që bashkë me urthin përvëltonjës po i gërryente stomakun. Dielli i zbehtë i ditës kapërceu në anën tjetër, në perëndim, kur u dëgjua sërish fërshëllima e bilbilit të shefit dhe të burgosurit, të urdhëruar prej kujdestarëve me automatikët që s’i hoqën asnjëherë

prej krahëve u kthyen në kampin burg. I dhembte gjithë trupi, gjymtyrët e krahët, por më shumë i dhembnin duart e pamësuarat që u gjakosën qysh në fillim. Gjemba e rrodhe gjembaçësh iu futën në mish, nëpër gishtërinj. Thellë.

Lodhja i kishte këputur krahët. Nuk kishte asnjë dëshirë. Një avull i pistë, gri, gati i padukshëm po tërhiqej nga retë. Tym i zi dilte nga oxhakët e lavanderisë dhe kuzhinës, që binte erë të rëndë mazuti. Era e keqe merrte dheun e shkonte shumë larg. Ajo erë të sillte në gojë shijen e kufomave të përcëlluara. Qielli ngjante si i mbushur me hi. Tutje larg, majat e kodrave si kurrize devesh të lodhura, të etura për ujë, qëndronin kokëfortë të palëvizura. Kur dremitja e ëmbël topitëse i mpiu gjymtyrët, mendjen dhe shikimin, dikush si fantazmë a hije e zezë iu afrua pranë. Sako apo Zijai? Ç’kërkonte t’i thoshte? Iu bë sikur tha: “Duan të të helmojnë. Ki kujdes!”. Prej asaj mbrëmjeje, ai nisi të hante pak ushqim dhe pastaj ikte në banjën portative, përjashta mensës dhe e villte. Ky ritual u bë i zakonshëm. Bashkë me të erdhi anoreksia, sëmundja që nisi të thajë lëngun dhe mishin e trupit të tij ashtu si thahet gjethja në diell. Mbeti vetëm kockë e sy të dalë jashtë zgavrave. Kufomë.

Iu kujtuan shumë mirë të gjitha. Netët kur endej lokaleve të zhurmshme të Bostonit me Hana Erdalin. I bëhej sikur e kishte para syve. Sikur ishte kapur për dore me imcaken

simpatike. Ajo kujdesej për të. Ecnin në mes të natës, të çakërdisur për të mos iu dorëzuar gjumit. Hapat lëkundeshin e gjunjët dridheshin. Mendja shkrepse si një aparat aventura të reja. Sytë e saj nuk i ndaheshin. Sytë e hebraikes. E përgjonin çdo çast. Sy të thellë. Të mëdhenj. Të kaftë. Sy butësisht kërkues. - Ti ke entuziazmin e një fëmije dhe arrin çdo gjë, - i pëshpëriste duke e kafshuar lehtas në vesh. - Çfarëdo të ndodhë mos e humb kurrë shpirtin fëmënor! - Ç'ishte ai paralajmërim profetik? Përse duhej ta humbte shpirtin fëmënor? Kush do t'ia rrëmbente? Ku ishte ajo tani? Si ta njoftonte ku gjendej? Përse çdo gjë shkoi për drejt? Frika dhe pendesa si një vrimë e zezë e përpinë të gjithin në shtjella të padukshme. Shpirti i tij qëndroi fshehur, heshtur, brenda atij trupi kockë e lëkurë. Kurndjeu se po afrohej mbase fundi, kapi fort dhe i tundi kockat e kafazit të kraharorit që e mbanin mbyllur, sikur të kishte fuqinë e një ciklopi. Duroi. Ndjeu dhimbje si ta kishin prerë mes për mes me thikë. U tërhoq në cep, iu ngjit një eshtre duke lëshuar ca piskama të ngjirura e pikëlluese që ikën të treteshin larg. Shumë larg. Sikur të mos kish ardhur në këtë vend, në këtë tokë që e njihte vetëm prej rrëfimeve, do të ishte pranë Hanës dhe gjithçka do të shkonte më së miri. Deri në minutat e fundit para se avioni të ulej në tokën e të parëve, ai nuk dinte asgjë çfarë e priste. Nuk kishte sesi ta dinte. Kishte planifikuar ditë udhëtimesh në fshatrat ku kish lindur nëna dhe babai, disa takime me kushërinj e të afërt (dhuratat i bleu sipas listës së lënë nga babai) dhe ndoshta mund të organizohej një koncert violine në qytetin e vogël jugor. Të gjitha ishin bërë pluhur e hi. Copë-copë e cifla, si të ishin bomba lufte. Gjithë natës vërtiste ndër mend të gjitha këto deri kur agu

i mëngjesit e gjeti të ulur këmbëkryq përballë dritares së ngushtë të qelisë. Sako e Zijai flinin ende me lodhjen në trup, ose bënin sikur. Kurse mendja e tij gati sa s'pëlciste nga kujtimet, kurse sytë ishin skuqur e bërë gjak. Ajri po ngrohej. Tani e kishte më të lehtë të shquante pikëllimin pasi zhurmat ia kishin rrëmbyer hapësirën pipëtimës së natës. Dukeshin qartas rojat e armatosura në kullat e larta metalike, sprethet e betontë të kapanoneve-qeli, katramaja e zezë dhe eternitet. Sa deshi të çohet në këmbë për t'i uruar mirëseardhjen ditës së re, befaz një mollëkuqe u ngjit në dorën e tij. Insekti i vogël, brumbullor, lëvizte hareshëm në lëkurën e tij. Ç'donte mollëkuqja në qeli? A ishte ajo një shenjë, një sinjal? Mollëkuqja lëvizte ngadalë e luante qetësisht nëpër ata gishtërinj të ënjtur, të gjatë, të çarë, që s'kishin më asgjë të përbashkët me të dikurshmit. "Si t'i bie me këta gishtërinj violinës moj mollëkuqe?", vetëtiu si flakë zjarri në tru.

Pas tri orësh të mira ecjeje duke ndukur këmbët osh, nëpër ca bokërima që dukej se s'do të mbaronin kurrë, pa gjetur asnjë hije, asnjë fije bari a burim uji, më në fund, u dukën ca pellgje të zeza të shpërndara pa rregull, syprina e të cilave të verbonte keqas. Ishin si gjëndra lebrose. Rruga për atje ishte plasa-plasa, plot vija të thata përrrenjsh. Thatësisirë e përvëlim. Sa më shumë u afroheshe, aq më tepër aroma e rëndë, sflitëse, me shijen e të vjellave, të sillte ndër mend mortet e kohëve të vjetra. Ngjante se zërat ulëritës, të çjerrat e fageve vinin prej thellësisë së asaj toke kafe e errët

në të zezë, me ato pellgje si njolla të rënda tuberkulozi në mushkëritë që s'merrnin dot frymë. Duke ngritur kokën nga qielli, drejt atij dielli përvëlues që rrinte si saç, vështrimi i të burgosurve lutej: “Përse duhet të të besoj, o Zot?”.

Ishte ora dhjetë e paradites. Ah sikur të binte një pikë shi. Kushedi ç'gëzim do të sillte? Befas një re e vockël, e vockël fare, sa një gisht dore, që mezi dukej tej në perëndim, ngjalli në çast shpresën e tridhjetë e shtatë të burgosurve që nduknin zvarrë e vargan këmbët njëri pas tjetrit.

Ah sikur...? A ka gjasa për shi? Po askush nuk foli. Nuk tha atë që mendonte. I nxehti që kishte tharë gurmazet, gjuhët, kishte prerë çdo dëshirë. Askush nuk fliste. Të merrej fryma. Ende pa ndalur në sheshpushim, vendi ku do të shtronin kurrizin për punë, normën e ditës, Rexhoja, një karakter i një kohe tjetër, plak i lodhur që s'bënte zë për asgjë në botë, ra përdhe si të ish hardhi e tharë e këputur nga rrënja. Ashtu vinte ai, i gjatë, i hollë, pa fuqi. Meskëputur. Ra dhe nuk pipëtiu. Pa zë. Sikur iu fik kandili. Nuk e dinte përse ishte dënuar ai burrë, por dukej tejet i vjetër për të bërë burg. Rexhoja nuk shoqërohej me askënd. Nuk hapej. Gojëkyçur. Fillikat. Por ama ishte shumë i vendosur për bërë normën ditore. Ia arrinte me shpirt ndër dhëmbë. As që bëhej fjalë të shmangej, t'i ikte punës, të bënte hile. Sikur aty, te vuajtja dhe lodhja e punës së rëndë ditore gjente kryqin, fjalën e Zotit që do t'i falte mëkatet. Pleqëria s'është për burracakët, pasi sfida e madhe e një burri është pleqëria dhe Rexhoja e kish shkruar në ballë këtë gjë. Rexhos së shkretë sytë ia mbylli Fetah Lëvonja. Kur mbërriti kapteri komandues trupi i tij ishte ftohur krejt e në atë përvëlim mizor dielli, ai ngjante me një shtatore.

Shtatore e rënë përdhe. Atë çast njeriut të gjorë i mbushej mendja top se ndonjëherë jeta nuk ishte bërë për t'u jetuar, por vetëm sa t'i hidhje një sy e të zhdukeshe pa thënë asnjë fjalë. Qetësisht kapteri komandues urdhëroi ta zhvendosnin trupin e tij drejt një ledhi aty pranë, ledh me tufa fieresh të dendura. - Lëreni aty. Hidhini dhe një këmishë fytyrës. Nuk do harxhojmë ditën kot! Pas punës do ta çojmë në kamp për ta varrosur. E heqim me vig, - kështu urdhëroi kapteri komandues pa kthyer kokën fare nga meiti. Ato fjalë pa shpirt fluturuan qiellit si zogj të zinj, zogj që ngjanin me një tufë të çuditshme paqëndrueshmërisht psikopatie.

Po shembeshin muzgjet. Honet e natës. Nelson Andrea heshtur në qeli. Dy të burgosurit e tjerë s'pipëtinin. Era frynte nga të katërta anët. Mbështjellë me batanije qëndronte galiç. Natën dyshimet janë të dendura. S'mund të jesh shenjtor kur jeton në ferr. Rrekej të mblidhte shpirtin. Ku dreqin bridhte ai? E tmerronte fataliteti ose fakti që shpirti mund ta braktiste. Të vdiste. Të bëhej frymë që ta rrëmbente era. Ta shpërndante ku të mundte. Ai ëndërronte shtegtime të detajuara për shpirtin e tij. Në vende të shenjta, të bekuara. Sepse gjithësia është brenda njeriut. Njeriu i di destinacionet e veta. Por, tani i ngjante se përbrenda tij ishte bërë eklips, me kaq shumë terrinë, vetmi, përçudnim. Ku e përplasi fati? Jeta nuk e çon gjithnjë njeriun atje ku ai dëshiron të shkojë. Kur do t'i kapërcente togjet e pafundme të fantazmave e hijeve për të dalë në mbretërinë e dritës? Sa herë i ishte dashur të luftonte? Sa herë kishte nxjerrë thonjtë? Dhjetëra

pyetje shponin si gjilpëra trurin e tij. Përgjigjet vononin. Gardiani rojë erdhi shpejt. Hyri me vrull në qeli dhe thirri: - Çohu imperialist! - (ku u gjet kjo fjalë). Tek vendi! Ishte mesnatë. Mesnata e kishte kuptuar se diçka nuk shkonte. Kushe kishte spiunuar sërish dhe përse? Ai ecte para, gardiani pas. Drejt e në dhomën e marrjes në pyetje që gjendej në anën tjetër të kampit - burg. Dhoma ishte ajo e një nate më parë. Asgjë nuk kishte ndryshuar. Dhe stoli ku ishte ulur, dukej i palëvizur. Aty ku e kishte lënë. U ul. Priste. Priste gjatovinon syskifter. Ai nuk erdhi. E kishin zëvendësuar me një shkurtabiq babaxhan, mustaqezi dhe kokë të madhe. Sytë i kishte të skuqur dhe këmishën e mbante zbërthyer dy kopsa për të treguar gjoksin e gjerë leshtor. Me ç'dukej kjo ishte një nga kapardisjet e tij. Ndryshe nga gjatovinoja syskifter, shkurtabiqi i ngjau pak akshi e pak hutaq. Sesi i ndërthureshin këto të dyja nuk dinte ta thoshte, por ja! Ashtu ishte. Ky hetues s'dukej fare pervers. E kishte diçka në mend për të. Si të thuash, ai mendon pak mbrapsht. Dhe mban si maskë pamjen e shkretë të babaxhanit. Shkurtabiqi pak akshi e pak ëndërrimtar, kishte ardhur nga kohë të mugëta. Është burrë i fortë, i mirë dhe ka guxim. Zoti i dhëntë shëndet, siç i thonë. Ai u afrua pranë tij në tavolinë dhe i bëri shenjë me kokë policit të daktilografimit që ishte ulur në tejanë. Ai nisi të shtypte pyetjet dhe përgjigjet. Shkurtabiqi bëri të njëjtat pyetje si gjatovinoja syskifter. Mori të njëjtat përgjigje. Herë pas here i afronte kokën e madhe deri te hunda dhe i pëshpëriste: - Mos u tremb buçko. Pyetje rutinë. Më pas do kemi ca punë, po do t'ia dalim. Si thua? - Ai nuk tha asgjë. Vetëm se... vetëm se... një zgjim i vonuar iu përdeez, vezulloi rrëshqitazi dhe ashtu siç mori

hov edhe u fik. I shtypur nga një mërzi e pafundme, për herë të parë deshi të provojë, të luante me diçka të rrezikshme, të thënë ashtu shpërfillshëm, kinse: - Jam shtetas amerikan, a e dini? Ku është pasaporta ime? - Besoi që kishte thënë fjalët e duhura. E gjitha qe plot kuptim dhe njëherësh enigmë, nisur në kërkim të një shpjegimi për të hapur portën e lirimit. Por pikërisht përmendja e pasaportës amerikane ishte gabimi që shënoi fillimin e kthesës në qëndrimin e shkurtabiqit. Pasaporta amerikane pickoi ligisht, dhunshëm, ngatërrueshëm, ishte shenjë e pakuptueshme, dhe në humorin e shkurtabiqit ra befas si pezm i mjegullt, shkrepje vetëtime, zezim që u shoqërua me ndërprerje të mendimeve në fundajë të fjalëve. Ke dashur ndonjëherë t'ia mbathësh nga e kaluara jote? Të ikësh diku tjetër ku mos të të gjejë askush? Atë dëshironte ato çaste. Shkurtabiqi e shqepi në dru. Me ç'i erdhi përdoresh. Pyetjet pas kësaj u bënë tinëzare dhe përgjigjet e tij të zvergura, pa zell zbulimi. Kur truri zgjedh gjithnjë gjëra të këqija, kjo është shenja e gjendjes së paradedresionit. Mjegulla penguese si mburojë, do të ishte prej atij çasti perde e hekurt. Deri në fund. Njëzet e shtatë mesnata të tjera rresht, që zgjatnin deri në agim, sa herë që shkurtabiqi mustaqelli e merrte në pyetje; të pangrënë, të pagjumë, të sflitur nuk sollën asgjë të re. Jepte të njëjtat përgjigjet standarde dhe shkurtabiqi akshi do ta humbte shpejt kontrollin e kapardisjen rurale. Midis fjalëve ngatërrestare, do të humbte gjithnjë qetësinë, sensin logjik, pasi diçka do t'i mungonte përherë. Dhe argumenti shtesë ishte e rrahura.

Ndonëse ferr, makth, kurthe, pagjumësi e frikëra, ajo lloj hetuesie pasi kishte marrë e vuante dënimin, përfundoi pa ndonjë gjë konkrete. As e zbutën dot dhe as e vunë në shërbim të tyre. Nelson Andreas iu ngul në tru mendimi që drejtuesi i vërtetë i fatit së tij ishte veç aksidenti dhe jo diçka tjetër. Nuk kuptonte përse i shkrepiti të besonte që rasti do të zgjidhej shpejt, sa hap e mbyll sytë, si të ishte një keqkuptim banal nga ata të rëndomtë. I huaji brenda njeriut, ai që zakonisht bën të kundërtën e asaj që mendon e bën ai i zakonshmi, e shtynte të jepej i tëri te mirësia. “Le ta kenë fituar luftën këta (ç’punë kam unë me luftën e tyre?), edhe këta njerëz janë si gjithë pjesa tjetër e botës”, qetësonte mendjen. “Lufta ka mbaruar prej kohësh, njerëzia janë kthyer në shtëpi e shohin punët e veta. Pastaj, lufta nuk ka asnjëherë fitimtarë. Zoti nuk do që ca të qajnë më tepër e ca të qajnë më pak. Fituesi le të falë. Falja nuk është kurrë frikë.” Dhe i pushtuar i gjithi nga mornica të holla mirësie, asaj dite me diell të ngrohtë, edhe kapter Gërdhuqin, përbindëshin e pashpirt të kampit e shikonte disi me përdëllesë. Ka dy lloj njerëzish në këtë botë e shfajësoi sërish i huaji brenda vetes, ata që bëjnë gjithçka për të fituar me çdo kusht dhe gjithë të tjerët. Egërsinë e kapter Gërdhuqit, kamxhikun e lëkurës që s’e ndante nga kyçi i dorës, këpucët me proka që të godisnin në kërci të këmbëve dhe sidomos grushtin e egër të dorës cung, prerë nga një bombë lufte, po e mundnin përsëri ato mornica mirësie. Po afrohej kohë e drekës kur u ul në rrënjën e dalë të një valanidhi shkurtan, pemë lëkurëlëmuar që sikur ndillte paqe me gjethet uniforme, gati simetrike si rreshtat e të burgosurve që i fërgëllonte një puhizë e lehtë ere. Sikur të

kisha edhe violinën këtu, në duart e mia, kaq, ja kaq... dhe nuk do të doja gjë tjetër nga jeta! Nëpër duart, me gishtërinj që ishin trashur e shtrembëruar për dreq nga stërmundimi e lodhja, hop, papritur prej dheut, nisi të ngjitej një insekt i vockël, sa një gjysmë thoi, shpinëkuq, me pikëza të zeza përmbi. Lëvizte lehtë e pa u ndier. Prapë... Ishte hera e dytë. Herën e parë ishte një insekt brumbullor, ndërsa e tanishmja ishte nusepashkë, nga ato që plakat thonë se sjellin fat. Hop, hop, e po atë çast iu bë se dëgjoi dhe tingullin e hollë të violinës. “Ndiq zërin e tingullit tim”, ndjeu njeriun tjetër, atë të zakonshmin. “Ndiq zërin e tingullit tim, sepse unë të lashë të jetoje.” Mbushur me kapilarë iluzionesh, rrëmoi dheun dhe gjeti një petëz guri majëmprehtë. Gur ngjyrë dheu. Mbi lëkurën e lëmuar të pemës hoqi pesë vija të holla si pentagram dhe pastaj vizatoi çelësin Sol. Gishtat e prerë, të çarë, plot vragëza mavi, dregëza të kuqe plagësh të pambyllura, dridheshin. Ah, sa e kishte marrë malli! Nisi të fërshëllej një melodi, që si shpend i padukshëm, doli lehtësisht nga hapësirat e mushkërive. Sikur tingujt mezi prisnin ta shpërthenin kafazin e krahavorit e ta shtynin me duart e padukshme shpendin drejt hapësirës, ta shtynin lart, lart, që ai të dilte prej andej dhe të ikte pa kthim, drejt qiejve. U ndje krejt pa peshë. Sikur do të fluturonte dhe vetë. Nuk ishte ngopur plotësisht me ajër lumturie, kur befas, mu në fund të qafës hollake iu vërvit me shpejtësi rrufeje kamxhiku i gjatë i Gërdhuqit. Sikur i preu damarin. Ai e kishte përgjuar, i qe afruar tinës nga pas dhe pastaj i ishte turrur si bisha, si bisha kur i turret presë së vet. - Imperialist, armik i popullit, qen! - ishin të ulëriturat e mbushura me jargë të kapter Gërdhuqit. - Kujt i bën shenjë ti, kujt i jep

sinjal? Imperialist. Kaq ta bësh dhëmbin. S'më ikën dot nga duart. Lëkurën do të të rrjep! - nuk pushonin të goditurat me kamxhik dhe këpucët e rënda me proka. Dora cung e godiste poshtë ijës derisa e çau cipën e barkut dhe gjaku nisi të rrjedhë çurg. Kapter Gërdhuqi pushoi vetëm kur u lodh. Ky ishte çasti kur ai, njeriu i zakonshëm, ndryshe nga i huaji brenda vetes e kuptoi përfundimisht se në këtë jetë nuk e ndan dot me çdo njeri mirësinë dhe nderin.

Në nëntor, gjashtë muaj pas arrestimit të çuditshëm në aeroportin e vetëm të Shqipërisë, vuajtjes së dënimit në kampin-burg të Ballshit, e zunë ethet e forta. E përvëloi temperatura e lartë, kolla e shqeu sa i merrej fryma dhe pështynte gjak nga mushkëritë e holla. Sako e Zijai nuk e prekën me dorë. Ose e merrnin për spiun ose për të sëmurë me kolerë. Askush nuk e besoi. Komanda e nxirrte përditë në punë të detyruar. Dilte nga qelia, ndalte dhe i hidhte një shikim të gjatë kapterit përgjegjës. Ai qëndronte serbes përjashta, me kapotën e re, shtrënguar fort prej rripit në mes. Kapelën e mbante mënjanë, flokët e verdhë si qime derri dhe mjekra si pllakë guri rrinin pa lëvizur. Një dorë e kishte gjithnjë në këmbëz të pushkës, tjetrën lëshuar, gati për t'ia ngjeshur surratit të burgosurit të parë që do të guxonte të hapte gojën. Njeri që dukej se ishte pa shtëpi e katandi. Pa fe e pa besë. Pas tij ishte porta e madhe prej hekuri që zbriste ngadalë në rrugën e paasfaltuar, që të çonte te kodrat e tmerrshme të punës.

A thua do të shihemi prapë, kapter? Kjo pyetje bëhet kur je jashtë, ndërsa në burg nuk i dihet asnjëherë ç'mund të ndodhë. Burgu gjithnjë është punë djallëzore, tinëzare. Dhe nisej me shpirt ndër dhëmbë për të arritur rreshtin, shokët. Ajo rrugë ishte e rrezikshme. Mendjen e mbante te shpresa e lirimit, zgjidhja e keqkuptimit, që venitej e venitej, që ikte e ikte dhe ai se kapte dot, ndonëse i fliste me zë të ëmbël. Deri kur u rrëzua në një natë të thellë me shkrepitima e shira rrëshekë dhe humbi në kllapi. Në shtratin prej balte. Mbuluar vetëm me një batanije. Në kontrollin e natës në qeli, e besuan për të vdekur. - Imperialisti na duhet gjallë! - ulëriti kapter Neziri, qimeverdhi. Shpejt ta shpiem poshtë. - Dy gardianë e morën në krahë, mbi një vig druri, ndezën fenerin me vajgur dhe u nisën për ta çuar në fshatin e afërt, ku banonte infermieri Selman. Shtëpia e tij ishte edhe infermiera e burgut. Selmani ishte i zoti në punët e mjekësisë, me përvojë dhe i papërtuar. Ia dinte kleçkat çdo gjëje. I ndërroi gjithë rrobat, e mbështolli me lesh të dhirtë, të palarë. I vuri pastaj mbi lëkurë të trupit ca pllaka të holla shtufi që i nxori nga prushet të mbështjella me leckë. E përvëloi djalnin. I dha për të pirë ca lëngje që vetëm ai i dinte se ç'ishin dhe e ushqueu me supa të lëngshme që ia përgatiste e bija. Kaluan disa orë dhe u duk se imperialisti po e kapërcente ngadalë kllapinë. - Ky, do të flejë këtu pranë zjarrit, - tha pastaj i lehtësuar Selmani. - Do ta ruajmë gjithë natën. Ju të tjerët s'keni ku veni me këtë kohë. Zbrisni e flini në çardakun bosh. - Çardaku përposh ishte për kafshët. Gardianët nuk e zgjatën. U ngritën. Zbritën poshtë. Dyshimet për Selmanin, nëse ju shkon ndër mend kjo gjë, kishin dalë prej kohësh të kota. Ai vinte nga lufta.

Kishte dhënë prova të thella besnikërie. Shtëpia e Selmanit nuk ishte ashtu siç dukej, ruhej, përgjohej. Gjithë natën Selmani qëndroi te koka e tij. Hiq e vë kompresë. Vajza solli tesha të thara. E ndërruan dy herë. Diku në zbardhje të ditës së re, nisi të flasë në gjumë. E folura në moshën e tij, sjell pikëllim. - Jepu duarve, - iu turr vajzës. - T'i vëmë sërish pllakat. - Ashtu vepruan. I futën në prushet e zjarrit derisa u bënë të kuqe, i mbështollën me rrobe dhe qarkuan gjokset e shpatullat me to. Djali lëshoi rënkime të thella. Fryma nuk i ngjitej dot sipër, mbi kraharor, për të dalë në sipërfaqe. Dhembte. Dhembte dhimbja. Dhimbja është thyerja e guaskës që ndihmon të kuptuarit. Por ndonjëherë sa më shumë e dëshiron një gjë aq më shumë e humb atë. - A do shpëtojë ky baba, - lëshoi vajza pa dashur ankthin e mbledhur lëmsh. Selmani e pa vëngër. Ai burrë kishte virtyte. Por besimi në virtyt në ndonjë rast është më i rëndësishëm se vetë virtyti. - Më sill veglat dhe briskun, - urdhëroi aty për aty të bijën, Selmani. Frika e saj nuk ishte kot. Diçka parandiente. Gruaja gjithnjë parandien më shpejt. Edhe ai kishte dyshimet e tij. Vajza e dinte radhën e punës. Nxori nga kanistra ca fasho të papërdorura. Një pecetë të madhe me vegla, rakinë dhe tamponët, teshat e tjera gati për mbulim dhe copën e drurit për t'ia lidhur në gojë. Mori biçakun e hollë me majën gjatuce, e ngrohu mbi prushet e mangallit, pastaj e leu me raki. Ia zgjati babait. Selmani ndërhyri shpejt dhe me siguri. E çau poshtë grykës. Mbi kraharor. Gjaku shpërtheu. Djali u drodh. U drodh jeta. - Doli e keqja. Ia hodhi, - tha Selmani i vendosur. I pastruan gjakun. Vajza e thithi disa herë gjakun me buzët e saj dhe e derdhi në pjatën e vjetër. E fashuan me kujdes. Ia mbështollën trupin me të

nxeha. E mbuluan. Kokën e djalit e mbështetën në trupin e vajzës. Fillimisht rënko i thellë pastaj pak e pak, munda të marrë frymë lirisht. Ashtu dhe e zuri gjumi. Të flesh në krahët e një vajze të re është më tepër se të bësh dashuri. Intimiteti që krijohet është i pakufishëm. Ndien frymën, lëvizjet e dëlira e deri prek me fantazi ëndrrat e saj, avujt e ngrohtë të dëshirave. E di ç'ndodh kur ndahesh midis dy gjërave? Midis jetës dhe vdekjes? S'bën mirë as njërën e as tjetrën. Stuhitë të nxitin qarkullimin e gjakut, zemra të pluskon, pavarësisht se vdekja të nduk me gjithë dredhitë e saj, me kthetrat e përgjakura. Ai rënkonte e rënkonte në krahët e saj, ndërsa përjashta dritareve dita e re përleshej me shpërgënjtë e shtrëngatës. Era frynte si e tërbuar. Edhe fatkeqësia që endej në atë dhomë-infermieri ishte si ajo erë e fortë. E tërbuar. Si stuhia që po vinte. Si stuhia që na merr gjërat e dashura, ato që askush nuk mund të na i marrë.

Shpesh njerëzit e varfër janë dhe njerëzit më të ëmbël. Prej katër ditësh dergjej në shtëpinë-infermieri, në një shtrat ndryshe nga i qelisë, mbushur me kashtë e xhefka. I jepnin ushqim të ngrohtë dhe e mbulonin me velenxa leshi. E kuronte Selmani me vajzën e tij. “E dua të gjallë, e dua në këmbë”, kishte marrë porosi të rreptë infermieri i burgut. Nuk e kuptonte Selmani këtë gjuhë: Edhe armik, imperialist, edhe kujdes i veçantë e temena për të. Këto sikur rrinë skiç! Të gjithë kanë nga një talent të ndryshëm në jetë, po Selmani kishte shumë. Ai ishte si demiurg. Merrte vesh nga mjekësia, po ishte dhe pak kovaç, sepse

ndreqte edhe veglat e punës për të burgosurit. Ishte edhe berber, pasi rruante e qethte komandantin e burgut dhe gardianët, por ishte dhe xherah kockash. Me siguri edhe veteriner, që nga planifikimi i lindjes së gjësë së gjallë, rritja e deri te therja, por edhe kuzhinier me shije. Selmani ishte meteorolog se parashikonte motin, kur duhej të dilnin e sa duhej të punonin të burgosurit, edhe dentist, sepse kishte një darë, eh ç' darë, që e mbante me vete në çantë për dhëmbët kryeneçë të të burgosurve. Ishte dhe gjeometër pasi maste me sy dhe tregonte normën për çdo të burgosur. Gjithëdija e tij popullore ishte si uji në shkretëtirë në kampin-burg, futur si në pus, në gropën më të humbur të botës. Por gjëja më egoiste e tij ishte fakti se bëhej copë për të ndihmuar të burgosurit. Selmani kishte për këtë gjë lejen e duhur të komandës. Askush tjetër. Po përse i ndodhte kjo? Mbase sepse shlyente ndonjë mëkat të vjetër që i rëndonte në shpirt. Apo përfitonte atë, ndjenjën e mirë e të kulluar për të cilën ka kaq shumë nevojë njeriu i bërë pis? Ndjenjën që e merr kur ndihmon të tjerët. - Jam falënderues për çdo gjë që kam. Kështu e jetoj jetën time u..., dhe kjo është arsyeja pse jam ky që jam sot, - i pëshpëriti në darkën e vonë teksa i ndërronte plagën që ia dezinfektoi me raki për të ngordhur infeksionet. Falëndero dhe ti Zotin që të la gjallë. - Pas kësaj Selmani iku të dridhte cigaren në hajat. E gëlltiste, nuk e pinte atë të shkretën. Nuk ngopej. Era e saj vinte deri brenda dhomës. Duhmë. Kur ai ishte jashtë, vajza i vendosi sërish kompresa në ballë. Digjte ende. E mori dorën e tij në të sajën. - Pse të thonë imperialist, - pyeti me pafajësinë e një fluturë që shkon e ulet gabimisht në oxhakun e zjarrtë të furrës. Një i kuq i bukur, i veçantë, i purpurt, i pashfaqur

më parë, ia mbuloi fytyrën dhe gushën. Po ta vështroje, marroseshe, çmendeshe! Dy buzët si qershiza të plota, të pjekura, të lakuara anktshëm, përvëlonin, ishin gati të jepeshin. Nuk duronte dot durimi. Djali u lëshua. Lëshim atë çast do të thoshte: Shpirtërim! Ëndje. Dritë. Ikje. Shpëtim. Rikthim te të gjallët. Te violina. Tingujt. Muzika. Djali i rrëfeu kimerën e tij. Historinë e trishtuar të babait. Marien, gruan e dytë, që ai e donte për mend të kokës. Ikjen në SHBA. Shkollimin. Amanetin e babait. Rikthimin në Shqipëri dhe arrestimin. Kampin-burg dhe shpresat e humbura. - Tani jam i humbur. Krejt i vetëm. Asnjë nuk e di ku kam përfunduar. As vëllai Piter dhe as motër Sofia. As Hana Erdali. Më kujtohet vetëm një emër... një emër që nga fëmijëria, Kristofor... Kristofor. Ishte mik i babait. Farmacist. Nga fshatrat e jugut. Po, po farmacist ... - dhe nuk pati fuqi të vijonte më tej. E mbuluan djersët dhe sytë shkëndijuan fort, a thua thërrmonin zjarrthe rënkimesh e vuajtjesh. Apo diçka tjetër...? Vajza i shtrëngoi dorën lehtas sikur deshi t'i thoshte: - Mos e humb shpresën...!

Nuk ishte shëruar ende kur e çuan në qeli. Selmani u tha gardianëve: - E ka ende të hapur plagën! Mos e merrni në qafë! - Sus! - ia bënë me shenjë. - Sus! - Në kamp kishin ndodhur ngjarje. Sakon e kishin larguar nga qelia. Dy mirditorë, kushërinj të parë me njëri-tjetrin, Ndue Mërgëga dhe Marash Mërgëga ishin vrarë nga rojat shoqëruese në tentativën e tyre të arratisjes. Atje në kodrën e tmerit. Dy kushërinjtë kërkuar lejë për nevoja personale dhe sapo u

zhvendosën pas një bokërime, ia mbathën me të katërta. Për fat të keq nuk ia dolën. Rojat i pikasën. I ndoqën. Qëlluan me breshëri, pa paralajmërim, pa më të voglin hezitim. Pastaj i lidhën duke i tërhequr rrëshqanthi. Ashtu të pluhurosur, përplot njolla gjaku i sollën deri në kamp. Një ditë më pas, Trifon Meraja, “oratori-filozof” i kampit-burg, vari veten i dëshpëruar në hekurat e dritares të qelisë. U fol se nën shtratin prej balte iu gjet një thes me dorëshkrime.

Nelson Andrea ia kishte ngulur sytë hekurave të trashë të qelisë. As dy gishta nuk hynin dot midis kuadrateve të dritareve. Dielli donte edhe pak që të binte nga ajo anë. Të harrosh jetën, madje të harrosh edhe që harron, i rrinte gozhdë në tru. Para se të hynte në burg, nuk kishte dëgjuar asgjë për të. Fjala burg ishte thjesht si një ide.

Njeriu nuk ia mbath dot fatit të tij. Si në çdo kimerë, pjesa e pasme e dramës, sado e rëndë të jetë, sjell pashmangshëm edhe komedinë. Një fije e hollë e ndan. Kur u mbushën pesëmbëdhjetë muaj nga burgosja, krejt papritur e thirrën në komandën e burgut. Si mund ta harronte atë ditë? Ishte korrik. 9 korrik 1968. Gjendej në majë të kodrës, mbi ca bokërima të zeza, duke shkukur rrënjë shqope. Duart i ishin bërë çapraz. Të çara e plot gjemba të futur nëpër rremba. Gishtat ishin fryrë kollopaqe. Dielli përvëlonte saç. Përvëlimi i kishte ngjitur frymën në dy mushkëritë e sëmura

dhe anët e buzëve ishin damkosur me të bardhën e lerosur të pështymës. Sytë flakërinin. Gulf e zjarr. E thirri kujdestari-rojë. - Eja shpejt këtu, - i foli, - do ikim. Të kërkon vetë komandanti. Në komandë. - “Kaq e pata”, mendoi. “Mos ndoshta është kurth? Kurth me arratisje? Ikje dhe më pas goditja me breshëri?” Në netët e gjata të vetmisë, atje në qelinë e ftohtë, me igrasi e myshk, i ishte betuar vetes: “Do të mbijetoj. Do t’ia dal. Me çdo mënyrë. Një ditë do të iki nga ky ferr dhe do t’i rrëfej botës tmerret e mizoritë e tij. Njeriu nuk mund të ikë pa lënë asnjë gjurmë nga kjo botë! Pa dhënë asnjë shpjegim! Pa treguar se cili është dhe ç’di të bëjë me jetën e tij. Kur je fajtor, është gjithnjë tepër vonë. Nuk ka më kuptim. Po cili është faji im? Askush nuk më thotë. Besimi që kam se do t’ia dal mund të më shpjerë deri në njëfarë pike. Fati do më shtyjë mbase dhe ca më tutje. Por kjo nuk mjafton. Nuk është përfundimtare. Mos duhet të veproj tani? Po ç’të bëj? T’i afrohem, t’i rrëmbej automatikun rojës dhe ta grij? A mund ta bëj këtë gjë? Nuk ka gjëra të thjeshta vëlla, as të lehta. Jetës nuk ia hedh dot. Atëherë mos ndalo. Merre vendimin e duhur. Sa nuk është vonë”.

Kishin zbritur rrëpirën e gjatë, disa kthesa të forta mbuluar nga bimësia e egër dhe po nxitonin në moçalishten harbuar nga barërat e lëpjetat. Papritur këmbët shkelën diçka të butë, të lëngshme, të qullshme. Dhe u fundos. Në fillim lehtas, më pas tërhequr fort në thellësi të tokës. Ulëriti. Roja pas tij e kuptoi, mbërrii shpejt dhe i zgjati kondakun e armës. Gropa thithëse me serë, naftë, baltovinë argjile, qull e trashë, mbetur kushedi qyshkur e tërhiqte si djall teposhtë. Në ferr. E çuditshme! Roja e tërhiqte për

sipër. Ishte zhytur deri në mes në masën viskoze të vdekjes. Roja mblodhi nga i kish e nga s'i kish gjithë fuqitë e tij dhe në stërmundim fatal ia arriti ta nxirrte të burgosurin në anë. Pas kësaj fuqitë e të dyve ishin prerë. Këputur. Duart nuk i ndienin më. Dërmuar, ngjyer e llangosur u ngrit dhe hodhi me përtesë hapat që të çonin drejt komandës, aty ku e kishin kërkuar. Te zyra në kaponon e priti komandanti i burgut, Shefqet Zëraliu. Pa e ngritur kokën e tij tullace, me ca vurrata të kuqërreme përmbi, ai i komunikoi urdhrin. - “Sot më datë 9 korrik 1968, Nelson Andrea, lirohesh nga burgu i Ballshit, për qëndrim të mirë e punë korrekte.” Kolegji i bashkuar i Gjykatës për Qarkun Vlorë, Berat, Fier. Merr ato që janë të tuat në magazinë e thyej qafën! - përmbylli pritjen komandanti i burgut.

- Ku të shkoj? - guxoi të rebelohej. - Më jepni pasaportën time të iki! Të iki një orë e më parë nga ky vend!

- Ku... ku... ku do të ikësh ti? - koka tullace e Shefqet Zëraliut u skuq si një karpuz i çarë. Tingulli iu ndërkye si t'i kish pickuar gjarpri kordat e zërit dhe gjuhës iu tha pështyma. Dridhej nga zemërimi.

- Jam shtetas amerikan, - foli thatë, ndërkohë që nuk e kishte të qartë se ç'do të ndodhte pas atij shpërthimi.

- Prrr... prrr... prrr, je një mut që të hash amerikan. Dil atje jashtë e shtro kurrizin në punë. Sillu mirë e bëhu njeri për së mbari. Që mos vish prapë këtu. Dëgjove? Punë ka plot.

- Nuk kam ku shkoj, jam fillikat në këtë vend.

- Hej bela, bela e madhe. Ky vend tani e tutje është atdheu tënd, mor jezit. Ngule si gozhdë në tru këtë gjë, more vesh? Mora, thuaj!

- Atdheu im është Amerika. Më mbani kot këtu! - sytë iu përflakën dhe grushtet iu shtrënguan fort. Nuk dinte ku t'i përplaste.

- Ik jashtë. Ik se më duhet i lirë krevati tënd, mbush ti apo s'mbush? Qërohu sa pa m'u ndërruar mendja! Qërohu të thashë, - dhe befas kordat e zërit u tendosën në ulërimë bishe. - Qërohu, jashtë, jashtë qelbësirë! - Doli nga zyra e tij krejt i shastisur. I humbur. Zyra ishte e para, në fillim të kapanonit të madh të burgut, si nja tridhjetë metra e gjatë, por ai nuk mund të hidhte dot as dy hapa më tej. Brenda tij gjithçka kishte shterur. Kishte mbetur vetëm shkretimi. Shkretim në ajëz të lotit.

Kreu II

Mbështetur pas murit të portës, me duart ngjeshur pas kokës, nuk e mori vesh sa qëndroi pa lëvizur. Si hije. Hije e murrëtyer. As rreckat e trupit nuk regëtinin. Kur vdes njeriu, ai shndërrohet në frymë. Vdekja e lirë e frymës është vdekja e lirë e njeriut.

Çfarë i kishte ndodhur Nelson Andreas?

- Tundu, luaj vendit mor zorzop, ç'më ri si hu gardhi! - iu gërmush roja i komandës. - Ik sa pa iu ndërruar mendja komandantit. Ik, të thashë.

Roja nuk e kuptonte përse amerikani nuk tundej nga vendi. Ai qe ngjitur në mur. Fytyrën e kishte si prej dheu. Sytë të zgurdulluar, pa shprehje. Bosh. Në thellësi të tyre roja nuk mund ta shikonte atë pyetjen brengosëse, përse? Përse më dënuat? Ku të shkoj tani? Roja u nxeh ca më tepër nga memecëria e tij pakuptim dhe ia këputi me kondak këmbëve.

Ai i tha: - Mos më gjuaj më. Tani jam i liruar. S'ke të drejtë!

Roja u përgjigj: - Je një mut që të hash i liruar. Dole nga vrima e miut, nga biruca dhe kujton se shpëtove? Na, naaaa opingën e Sheros. Atje jashtë, e zeza të pret. Dëgjon, e zeza! Do të të zhdëpin më keq se këtu!

Ai: - Me siguri ti nuk thua të vërtetën. Më mirë se në burg do të jetë.

Roja: - Hë, hë zorzopi. Shko provoje njëherë, shko. Mbushu! - ulëriti. - Dhe mos provo të kthehesh prapë se di unë ç'të bëj pastaj, dëgjoveeee...

Ai i hodhi një vështrim që rojës i shëmbëlleu me atë të kufomave të thara.

Vapa i merrte frymën. Damarët e qafës të fryrë e të trashë si gishtërinj kullonin në djersë. Qepallat e ngathtësuara në mërzi e padurim mezi përplaseshin me njëra-tjetrën. Këmbët nisën të zhvendosen ngadalë sikur lëvizte një kufomë. Duhej të shkonte në fund të korridorit, që ngjante si furrë gëlqereje, gjithë afsh e zjarr përvëltonjës, në atë kapanon me mbulesë eterniti. Aty priste intendentin i burgut. Në gojën e tij flakë, më tepër se fjalët vinin rrotull ca zhurma që nuk dihej se ç'donin të thoshin. Nuk pipëtinte asnjë mizë. Gjithçka ngjante e topitur. E vdekur. E ndiente se fuqitë mund të mos mjaftonin për të shkuar deri në fund. Mollëzat e gishtave ngjiteshin për muri. Pastaj shtynin para. Shkumëzime e theqafje dhe ca vegime të turbullta bënë shtjella, i vërtiteshin në kokë. Solli ndër mend Zotin. I ngjau se ai shkoi para tij. Dhe i kërkoi ndihmë. U tremb. Po sikur të mos më ketë njohur? E ndjeu se ajo ishte rruga dhe nuk mund të kthehej mbrapsht. Mblodhi gjithë fuqitë, që se ku ishin fshehur në mjegullimet e durimit dhe vuajtjes, e bëri përpara. Kur mbërriti në fund, te dhoma e plaçkave, intendentin i pëshpëriti si askush tjetër në atë botë: - Kot u mundove. Gjërat e tua i mblodhi Rakoja. Engjëlli që të pret

përjashta! - Ç'ishte ai engjëll? Nuk kishte fuqi t'i besonte ato fjalë të çuditshme. S'kishte vdekur ende dhe kur çdo gjë dukej e mbaruar, i lindi dëshira të rrinte vetëm. Vetëm me vetveten, pa u përzier me askënd. E vetmja gjë që iu përhit, u shndërrua në avull magjik, perde e mjegullt profeti ishte Hana. - Hana, Hana Erdal, e bukura ime! - thirri emrin e të dashurës që kishte lënë atje larg, në kontinentin matanë oqeanit. - Hana, Hana Erdal, ti nuk je veç statujë e lashtë antike, të cilën e shoh. Ti je njëkohësisht dhe qiell, dhe teleskop, hyjni dhe yll i palëvizshëm. Dhe një zbulesë e përnjëmëntë. Je një diamant. Në këtë botë nuk ka as diamant të përsosur. Diamanti i përsosur do të përbëhej vetëm prej dritës. Prej dritës je krijuar vetëm ti Hana Erdal, derisa erdhe më gjete në këtë ferr. - Dhe ra përmbys. U pre.

- Të gJORIT Rako që i shkoi mundimi kot. Megjithëse këtij s'i ka mbetur asgjë, ka shkarë nga të gjitha anët, - qenë fjalët e fundit të intendentit të burgut.

Dielli i pasdites ia përzhiti fytyrën më keq se flaka e pandehmave dhe mëdyshjeve. Sytë i flakërinin shkëndijëza. Qe kapur në udhëkryqe dhe s'dinte ku t'i shpinte këmbët. Tej, mbi një shqope, ulur galiç, një burrë hollak me kostum prej doku jeshil ia bëri me dorë. U zvarrit ngadalë, më tepër prej moskuptimit sesa nga droja, hodhi disa hapa para, drejt tij. Fuqi nuk kishte më. Burri me kostum doku jeshil u ngrit në këmbë, hapi krahët për ta përqaftuar dhe i thirri me një zë basi të trashë që binte ndesh me trupin e tij kockë e lëkurë: - Të shkuara e të harruara nipçe! Hallet e tua mbaruan! Tani më ke mua! Do ndreqen të gjitha. Që të gjitha!

Teksa fliste me zërin e plotë, kokrra e madhe e gurmazit mezi ulej e ngrihej në lukth. Si të ishte gur Sizifi. Ajo ishte e madhe sa një grusht. Pas këtyre fjalëve që s'i kishte dëgjuar asnjëherë në këtë tokën shqiptare, fytyra e tij e përzhitur, me ngjyrë si e mishit të kuq, u përhit, u bë menjëherë e hirtë, gati si e ngrirë. Kush ishte ky njeri që e priti në dalje të burgut? Mos vallë ai Rakoja, për të cilin foli intendenti? Më tepër se sa frikë nga e panjohura, ai kishte dyshim. Dyshimi nuk i ndahej. Si të ishte rojë personale.

- Si the se quheshe zotëri? Rako? - dhe i hodhi vështrimin më rraskapitës të njeriut.

- S'ka gjë, më thirr Rako, ndonjëherë shoku Rako, por asnjëherë zoti Rako. Po s'ka gjë, s'ka gjë, Rako më mirë, - dhe qeshi me zërin gurgullonjës.

Ai ndjeu t'i lëvizte vrikthi gjaku në damarë. Gjaku dëshironte të shpërthente. Nga kujtesa iu zgjua si në shkrepje vetëtime porosia e të atit: "Atje në jug të Shqipërisë kemi një kushëri, farmacist të vjetër. Burrë i shenjtë. Me nam duhet të jetë. Kristofor ia thoshin emrin. Kristoforin do ta gjesht në fshatin tim jugor, në fshatin që ngrihet mbi ca kodra të buta, me pemë të harlisura, me zogj e shpezë nëpër ujdhesa, me kishën që nga koha e Justinianit të parë, me ca shtëpi të varura në ajër, me bashtina e puse, me buronja e ujëra kristali, me lumë që zbriste në rrëzë të malit, me ca gurë të murrme të gdhendur me gjeometri, me ca këngë që ta ngjethin mishtë, me ca brigje plot lezete e ca pemë frutore gjithë aroma, atje ku dielli është tjetër, ku dhe drita është tjetër dritë. Një peizazh gati biblik, ku histori të padëgjuaara më parë i dalin përpara syrit të njeriut. Atje do të vesh biri im. Atje do të gjesht Kristoforin. Ai do të të japë dritën që të

duhet. Nuk e di ç'humbet njeriu nëse nuk e merr me vete atë dritë! Në qafë paç veten po nuk shkove, biro!”.

Por, vetëm kaq shkreptiu. Shkreptiu si dritëz. Gulçi iu mblodh në grykë. Lotët janë gjuha e heshtur e dhimbjes. U mëdysh të fliste. Të pyeste apo? Prej muajsh gjuha e tij ishte ngathtësuar. Përtonte të fliste shqip. Në gjumë fliste anglisht. Shqipen gati e humbi. Kënaqej ndonjëherë vetëm me renditjen e mendimeve në humbellat e mendjes. Asgjë nuk duhej të dilte përjashta. Ishte rrezik. Rrezik dhe likuidim.

- Jemi kushërinj, një farë e një gjak, more! - buçiti Rako. Buçima e zërit sikur dilte nga toka e plasarit, e zhvoshkur, bërë thela-thela. Në vend të vapës së padurueshme, nisi të ndiejë të dridhura, madje djersa u ftoh, u bë akull. Që kur i thanë se dikush e priste jashtë, nisi të ndiejë t'i gumëzhinin në veshë zëra njerëzish, në kalim e sipër, jo zëra të qartë, por të fshehtë, sikur murmurisnin, përtyeshin dhe lëshonin të qeshura pa kuptim. Lëkura djersitej dhe pluhuri i argjilës që ngrihej prej erës së lehtë të rrugës që trashur dhe ishte bërë shollë. Nuk depërtonte asgjë. Me ç'dukej i ftohti vinte nga brenda. Nga dyshimi që po gërryente.

Kush na qenkej ky Rako? Po Kristofori ku është?

Për herë të parë ai e shikoi në fytyrë. E shikoi me atë butësi uji që thyen shkëmbin. Rakoja kishte sy të zinj, të errët. Ata sy ngjanin se ishin vetëm errësirë. Errësira nuk mund ta dëbojë errësirën; vetëm drita mund ta bëjë diçka të tillë. Urrejtja nuk e dëbon urrejtjen; dashuria mund ta dëbojë. Në anën e majtë, poshtë vetullës kaleshe, kokërdhoku i syrit sesi ishte prerë në mes nga një vijëz e hollë, e bardhë, që sikur e ndante atë mëdysh. Në çast iu bë se matanë asaj vije

të hollë, të bardhë, ishin fshehur të gjitha misteret e botës. Mjaftonte të ndukje atë fill dhe kasaforta e mistereve hapej.

- Unë e di ç'hoqa të rregulloja lirim me kusht, - sytë e tij u mbushën me ndriçim, ndriçim të errët që ai s'e kishte ndeshur askund.

- Domethënë ... - dhe u mbështet te pema e vidhit si nja dy metra ngjitur me portën. Zuri veshët me pëllëmbët e duarve, sepse gumëzhima e zërave që po afrohej, ngjante me lukuni ujqërish të rraskapitur dhe ishte e padurueshme. Gumëzhima vinte vërdallë tij. Ndjeu edhe më shumë akullim thellë gjoksit.

- Më mirë të mos ishe munduar. Ç'do të bëj unë në këtë vend?

Pyetja në vend të hutonte Rakon që priste duarlidhur, i kujtoi Nelson Andreas se duhej t'i dorëzohej fatit, fatit që po e vështronte trishtueshëm me bisht të syrit dhe që pak orë më pas do ta tërhiqte branë nëpër rrugët e panjohura të dyshimit. "Mos e vrit mendjen ku do të të çojë rruga", iu soll ndër mend një nga porositë e të atit. "Përqendrohu vetëm te hapi i parë. Ajo është pjesa më e vështirë, vetëm për atë je përgjegjës. Pasi ta kesh hedhur atë hap, lëri të tjerat të vijnë natyrshëm. Nuk duhet të të rrëmbejë rryma. Ti vetë duhet të jesh rryma."

- Ta thashë që në fillim, - kërceu me durim të sosur Rako, - të kam nipçe! I njëjti gjak më solli këtu!

- Po si? - mundi të belbëzojë me pandehmën që s'e linte të qetë. Dyshonte se ai burrë me vijëzën e hollë, të bardhë në mes të kokërdhokut të syrit të majtë, diçka i mbante fshehur, pa ia thënë troç. Në qiellin përvëlak të atij fillimkorriku u shfaq papritur një re e brishtë, si të donte t'i

thoshte se qenkëshin gabuar me të, i kishin dhënë një shpirt të butë, por dhe një fat të vështirë përplot rreziqe e kurthe.

- Jam kushëri i Kristoforit nga mëma, - u përbetua Rakoja si një shenjtor i rrëgjuar nga të ngrënët e pakët. - Doktor ka kohë që na ka lënë, pasi e këshilloi Zoti: “Shko e çlodhu atje nën tokë se boll u shërbeve njerëzve. E kaluara është një vend i stërmadh, ka vend për të gjithë, vetëm e sotmja është një rrip i ngushtë që mezi na nxë”. Eja të ikim nipçe, se dhe pak e do bjerë nata. Kemi kohë të molloisemi, - dhe e tërhoqi për dore të liruarin Nelson Andrea.

U deshën më pak se tri orë të mira ecje më këmbë, për të mbërritur te rruga nacionale. Ecje nëpër një rrip të ngushtë toke, koriye me bimësi të shkurtër. Të djegur. Edhe shputat e këmbëve përvëlonin. Përcëllonte përcëllimi. Shtegu ngjitej përmes lloshit plot me gjembaçë e barëra të këqija, në një vijë të ngushtë si udhë mizash. Duhma e frymës ishte e rëndë dhe veç një fije shkrepëse kërkonte që të shpërthente si fuçi baruti. Tokë e bërë eshkë. Kishte vetëm një ngjyrë që shtrihej gjer tutje në horizont, atë të barit e kashtës, ngjyrë të verdheme, që dukej sikur do të shpërthente zjarr. Ngjyrë e shkretimit. Asnjë pemë për hije. Gjékund. Sikur ishte tokë e mallkuar. Insekte e miza me tepri, aq sa ushtria e tyre dukej se vinte nga diku për të të sulmuar egërsisht. Edhe qielli ngjante i kuqërremtë, si të ishte pushtuar prej shkretimit. Nuk e dinte nëse ai qiell ishte gjithnjë ashtu, pa vrull e shtrëngata, sikur të kishte hequr dorë përgjithmonë nga toka. Ngriti kokën dhe i hodhi një

vështtrim dyshues: “Po shpirtrat e njerëzve ku janë?”. Sytë e tij ishin aq dritëshkurtër sa të mos mjaftonin të depërtonin në thellësi të tij. Në thellësitë ku fshihen historitë njerëzore, të ferrit e parajsës.

Sikur të binte një shi, me siguri do të ndizeshin dritat diku, do të ndizeshin dhe aromat e filizave të gjelbër. Edhe ngjyrat me siguri do të ndryshonin. E ndiente kokën të rëndë plumb.

- Përse erdhe të më marrësh? - foli, sikur pyeti një të vdekur që kishte ardhur të lutej për të. - Nuk bredh kot lart e poshtë unë.

- Do më njohësh, më thonë Rako Sirani, - nxori dufin e lodhjes së padurueshme burri me kostumin jeshil që e shoqëronte.

Pas fjalëve të thëna nga burri me kostum jeshil, ai ndjeu se diçka mungonte, gjërat po shembeshin, u ndje i vetëm, i lënë në baltë. Pikërisht atë moment, një zë që s’e mori vesh se nga mbërriti, i buçiti në vesh: “Beso më mirë te vetja jote! Merr guximin dhe pushto frikërat e tua! Shpesh, e vetmja gjë për të cilën ke nevojë është një dorë për të mbajtur, një vesh që të dëgjojë dhe një zemër që të mund të të kuptojë. Provoje njëherë. Ku i dihet!”.

- Ku po shkojmë?

- Aha, më në fund, - Rako Sirani u gjallërua sikur kushedi ç’mrekulli kishte ndodhur dhe zëri që i doli prej grykës ishte si një fill gjaku.

Ishin afruar në xhadenë e rrugës ku frynte puhizë ere e nxehtë. Dëgjohej vetëm potere e zhuzhunave¹ dhe bretkosave.

¹ Lloj insekti.

- Ç' do bëhet tani me mua? Ku po shkojmë?

- Je liruar me kusht. Tani do vish me mua, atje në qytetin jugor, - dhe ç'zë të fortë që kishte?

- Çfarë? E pamundur! Si mund të ndodhë kjo gjë?

- Kolegji i bashkuar i gjykatave të ka liruar me kusht: "Ndalim të ushtrimit të profesionit dhe të pjesëmarrjes në veprimtari artistike e shoqërore. Përjetësisht!", - dhe e shqiptoi atë vendim shtrajtur, si një gjë krejt të zakonshme, pa më të voglin ngurrim.

- Po... po unë, kurrë nuk kam marrë pjesë në një gjyq të tillë. Ky është mashtrim... do të protesto... do, - dhe nuk e mbaroi dot fjalën se Rako Sirani nxori vendimin e ia la në dorë.

- Ja kjo është, - dhe sytë e tij të errët ranë mbi fytyrën e Nelson Andreas. - Më mirë mbylle gojën dhe ta lëmë me kaq. Ndryshe, ndryshe e pëson keq. More vesh, mora thuaj!

Deshi të përplaste gurët, të ikte me vrap, të zhdukej, po ku të shkonte? Nuk kishte pikë fuqie. U kthye, e zuri për rrobash burrin shoqëruar dhe me zë që s'ishte i tiji, ulëriti: - Ku është parë e dëgjuar t'i hiqet njeriut e drejta e profesionit, pasioni i muzikës, spektatori? Domethënë asnjë tingull, asnjë interpretim, asnjë koncert...? Memecëri. Fshirje e gjithçkaje që kam mbërritur me aq mund e sakrifica në jetë? Në mijëra orë studimi e përqendrimi sflitës? Ky është më tepër se një krim. Vrasje. Në asnjë traktat estetik, në asnjë histori të muzikës botërore nuk gjendet një rast i tillë! - Asnjëra nga këto shpërthime nuk mundi të dalë jashtë gjoksit që po çahet prej përpëlitjeve të dhimbjes. Kujt t'ia thoshte? Rako Siranit?

Kishte studiuar pesë vjet në Konservatorin e Bostonit, një konservator i pavarur artistik për muzikën, vendosur në

Boston, Massachusetts. Konservatori ishte themeluar qysh në vitin 1867 dhe ishte një nga institutet më të vjetra të artit të arsimit të lartë, një nga dhjetë më të mirat në SHBA. Prej vendbanimit të tij, ai shkonte me biçikletë në kampusin që ndodhet në lagjen “Fenway-Kenmore”, që vijon të jetë një nga thesaret kulturore të Bostonit. Në atë konservator, me një mjedis përzgjedhës të të mësuarit intim, për të marrë vëmendjen e personalizuar të fakultetit, vetëm tre deri në gjashtë studentë në klasa shumë të vogla, ai përvetësoi gjithçka, kulturën, muzikën, teknikën e interpretimit, pasionin dhe virtuozezin. Ndërsa tani, Rakoja, ky burrë me kostum doku jeshil dhe vijën e bardhë ndarëse në mes të kokërdhokut të majtë po i thoshte se qenkësh dënuar prej Kolegjit të bashkuar të gjykatave për të mos e prekur me dorë violinën e tij. Ndalohej me Ligj! Çfarë vendi është ky? Në cilin planet ekziston?

Nelson Andrea u këput si ndonjë i vdekur. Jeta në burg i kishte dhënë mësimin se një gënjeshtër e vetme mjafton të dyshosh te çdo e vërtetë. Nuk kishte më energji. Rakoja u tremb, e ngriti në duar dhe më pas e uli anës një guri kilometrik. Nelsoni ndjeu nxehtësinë e gurit. I pihej ujë. Pyetjet njëra pas tjetrës i kishin hipur përsipër dhe me tërbim po i zinin frymën. E kishin mbërthyer pa mëshirë me ganxhat e tyre. Priste të dëgjonte: “Do t’i kthejmë të gjitha, lirinë, pasaportën amerikane, violinën”. Goja i ishte mbushur me gulfe zemërimi kur Rakoja e zuri për krahësh (si të paskëshin qenë krahë të vdekuri) dhe foli fjalë të buta: - S’bëhet qameti. Gjëra të vogla janë. Shyqyr që ike nga ajo vrima e miut! Po avash, avash...

- Çfarë kanë bërë? - bërtiti.

- Asgjë nuk kanë bërë. Kusht i vetëm i lirimit është se nuk do t'i biesh më qemanes, ja kësaj, - dhe nxori tërë qejf nga thesi i plaçkave violinën *Stradivar*. - Të ndalohet dhe pikë. Punë e madhe! Ha-ha-ha-ha.

Nelson Andrea humbi ndjenjat. Rako u tremb sërish se nuk do ta çonte dot të gjallë në qytetin e tij. I zbërtheu kopsat e këmishës, rripat, lidhëset e këpucëve, gjithçka. Kërkoj ndihmë. Ujë. Nuk gjeti asgjë. Për fat, ca minuta më pas u shfaq një makinë e vjetër tip ZIS me karroceri, ngarkuar me çimento dhe dërrasa të gjata. Vendet para ishin të zëna. Shoferi e ndihu Rakon ta ngrinin së bashku trupin e tij sipër. Shtruan mushama disa dërrasa përsipër dhe e vendosën trupin në karrocerinë plot pluhur çimentoje. Rako i mbante kokën mbi gjunjë dhe i fërkonte damarët e qafës. Me pak raki. Rakinë ia dha shoferi. Faqore xhepi. Nelsoni nuk shqiptonte më fjalë. Sikur ato të mos ekzistonin. Po shihte ëndërr apo...? Nëse nuk të frikësojnë, ëndrrat nuk janë të mjaftueshme.

“Rrëfhem o Zot që je në qiell për diçka të keqe që kurrë nuk e kam bërë. Nuk e kam tradhtuar kurrë të dashurën time Hana Erdalin. Erdha në këtë vend sipas porosisë së tim eti dhe vetë Zoti e di përse. Nuk arrita të takoj askënd. Im atë la këtu një grua të gjorë, të cilën erdha ta nderoj në amshimin e saj. Do t'i thosha fjalët e fundit të lamtumirës. Nuk ia mbërrita dot. Më burgosën. Nuk di të kem mëkatuar.”

“Nelson Andrea ajo grua vdiq e braktisur.” Ishte Hyjnori. “Në mjerim. Tha se priste në prag të portës atin tënd. Aty edhe i doli shpirti.”

“Ai e ka paguar haraçin e ikjes!”

“Pse të dërgoi ty atëherë, përse nuk erdhi vetë? Frikacaku.”

“Është plakur shumë dhe gjunjët i dridhen. Edhe duart”, ngriti sytë me lutje. “Tensioni ia godet pabesisht zemrën.”

“Mëkatin e tradhtisë e ruan ende në trupin e tij. Ai mëkat nuk zhbëhet.”

“Jo ai e ka paguar ndëshkimin.”

“Ai njeri, të cilit nuk dua t’ia përmend emrin, shkeli betimin e kurorës. Ç’mund të them tjetër për të?”

“Domethënë rrëfimi im s’paska vlerë? Mos duhet të shkoj diku tjetër?”

“Ç’ka bërë ai për të mbajtur premtimin e dhënë para Zotit?”, gjykoi ashpër Hyjnori.

“Keni zemërim të madh?”

“Do të më bindësh se ishte njeri i mirë dhe atje në Amerikë e nderonin të gjithë?”

“E nderonin.”

“Po mëkatin që ka lënë këtu në Shqipëri? Mëkati nuk humb dhe asnjëherë s’është i mirë.”

“Ka kaluar kaq kohë, nuk e paskeni harruar?”

“Koha? Nuk e dini që është zonjë e nderuar dhe na i kthen borxhet tona të vjetra? Ai ia ka borxh kësaj toke. Iku dhe se ktheu kokën pas. Ku humbi?”

“Si mund ta thoni këtë gjë? Ai punoi në biznesin familjar dhe në minierë, sa i doli kurrizi. U sëmur. Mushkëritë iu bënë copë e thërrime. Nuk pushoi dot asnjëherë.”

“Borxhi është gjak dhe ai gjak tani është në trupin tuaj.”

“Ç’është e vërteta unë gjakun e tij mbaj në trup, po nuk ndiej erë mëkati.”

“Për të zhbërë mëkatin duhet të jesh i ashpër, i pamëshirshëm me veten. Kur e dorëzon shpirtin në duart e Zotit duhet të jesh i larë, më i mirë se të gjithë.”

“Jam.”

“Duart dhe shpirtin i ke të pastër?”

“I kam.”

“Do t’jua provoj që s’është e vërtetë. Do të kujdesem vetë për jetën tënde”, tha mosbesues Hyjnori.

Trupi i tij, ashtu i drobitur siç ishte ndër ethe përdridhej e fërgëllonte si një peshk i stërmadh. Shtrëngesat, gërvima e dërrasave dhe rënkimet dëgjoheshin ca më tepër kur gomat e mjetit ZIS përplaseshin në gropat e thella të rrugës që gjarpëronte nëpër natën e zhytur në errësirë dhe dyshime. Sipas një besëtytnie, kur njeriu është duke vdekur, zogjtë nuk fluturojnë, por ecin në këmbë. Nuk duan të jenë afër parajsës. Atij iu bë se në fatalitetin e tij e shoqëronin zogjtë që ecnin me këmbë. Ishte mirë që e kishte marrë dhimbjen me vete, për ta lënë diku, në një nga raftet e kujtesës, ndoshta si relikte, apo shenjë që ta kujtonte dikur se duhej të dëshmonte a ndoshta të hakmerrej.

Këmbët i kishte cingor të ftohta. Ca më pas ndjeu t’i ngroheshin. Nuk u çudit aspak kur vuri re se ato po ia mbështillte me këmbët e veta Hana Erdali. Këmbët e saj lëshonin afshe. Dhe ishin si dikur në parkun e mështeknave pas konservatorit, në lagjen “Fenway-Kenmore”. Te vendi i përhershëm i takimit. Si përherë zonja Mendelshtein shëtiste qenin e saj në korsinë e biçikletave dhe çifti neozelandez,

pleq simpatikë, rrinin të përqafuar në stolin e katërt, përbri. Hana e kishte pritur derisa mbaroi provat e koncertit. Nelson Andrea do të interpretonte pjesë nga “24 caprichos del violin” të Niccola Paganinit. Ajo priste në fund të sallës, pas perdes, në ankth, teksa krahu i tij vizatonte me harkun mbi tela tinguj të mprehtë, të fuqishëm dhe me një hijeshi të pashembullt. Miqtë e përbashkët thoshin se Nelson Andrea kishte aftësi të magjishme në improvizim, tingull të hollë, të shpejtë, aftësi teknike në interpretim e veçanërisht në arritjen e një tingulli unik. Të ulur në stolin e drunjte, në sekretin e tyre të padeshifrueshëm, ndiqnin muzikën e ëmbël të frymës së njëri-tjetrit. Dhe prekeshin.

Po pse figura e saj mezi dallohej?

E kishte fituar zemrën e saj dhe fitues, si një ëndërrimtar i padorëzuar kurrë, ai i kërkonte të realizuara të gjitha dëshirat. Për çudi ato ia linin vendin njëra-tjetrës me shpejtësi, por pa atë kohën e duhur të shijimit. Mungesa, mungesa e kohës së shijimit sikur i copëtonte kujtimet e pafund. Hana Erdalin e kishte njohur rastësisht në pritjen që Adele Blon Ari kishte dhënë në restorantin presidencial të shqiptaro-amerikanit Anthony Athanas. Në atë pritje mbresëlënëse, luajti një kapriçio të violinistit të jashtëzakonshëm spanjoll Pablo Sarasate. Pritja zhvillohej në pjesën e përparme të resortit, përballë hapësirës blu të oqeanit. Tingujt shkriheshin me fladin e lehtë të pasdites dhe sikur treteshin në pafundësinë e ujërave. Kur e përfundoi interpretimin, pikasi se midis elegancës vezulluese të zonjave, ishin një palë sy të kaftë, plot dritë e shkëlqim që nuk e rreshtën vëmendjen dhe ngulmimin për asnjë moment. Ata e ndiqnin kudo. Ishin magnetizuar. Ata sy të kaftë, të mëdhenj në atë lëkurë të

bardhë si dëborë prilli e drodhën shpirtin e tij. E para iu afrua ajo. Me trëndafil të bardhë në dorë. Ia dhuroi. Ai e përmbloodhi në krahët e tij. Sikur të ishin lindur bashkë, të luanin bashkë në fëmijëri, të studionin bashkë në konservator dhe në fund të binin në dashuri.

Ai i tha: - Takohemi?

Ajo: - Ku?

Ai: - Te Katedralja e Shën Gjergjit.

Ajo: - (Qeshi me të madhe)

Ai: - Është katedralja ku u mbajt mesha e parë në gjuhën shqipe më 22 mars 1908, prej atë Theofan Nolit në sallën e “Kalorësve të Nderit”. Atje më pret im atë.

Ajo: - Budalla.

Ai: - Sa të lë violinën dhe ikim...

Shkuan te Katedralja e Shën Gjergjit. Ati i tij, një burrë flokëbardhë, gjithë gjallëri e hijeshi, pastronte. Asaj i mbetën në mendje dy qukat e faqeve dhe mjekra e hollë e disi e gjatë. Nelson Andrea i la violinën dhe të kapur për dore brodhën rrugëve të qytetit. Pastaj hynë në parkun e mështeknave. U puthën. Zgjodhën një stol dhe e shënjuan si stolin e dashurisë Nelson Andrea - Hana Erdal. Gdhendën inicialet e emrave të tyre. Pikërisht te ky stol janë ulur sërish pas mungesës së gjatë. Padurimi është ulëritës.

Hana po i fliste. Po për çfarë e pyeste?

Ku ishte fshehur ai gjithë këtë kohë dhe ajo që paskësh qarë aq tepër për të shuar ankthin e saj?

- Të kërкова të mos ikje. Të mos ikjeeeee ...

Heshtje mërmërimë.

- Po ti s'më dëgjove, - këmbënguli. - Mbetë pas amaneteve. Më beso, amanetet gjithnjë i krijojnë probleme

njeriut. Si të thuash jetojmë duke vrarë kohën tonë, çdo çast me kujtimet e së shkuarës.

- Po pse gruaja dyshon gjithmonë? Merr mesazhe nga qielli apo si është puna, - e preku lehtë në gushë. - Apo parandien diçka që unë ende nuk mund ta kuptoj?

- Atje do të të duhet të japësh shumë shpjegime, - këmbënguli ajo bezdisshëm. - Mund edhe të keqkuptohesh. Atje është një vend komunist. A je i gatshëm të përballesh me çdo pasojë a rrethanë të paparashikuar?

Pyetjet vrasëse ia kishin dalë që, midis, të vendosej distanca akullnajore. Sikur midis asaj dhe atij të ishte futur në mes një perde kontinentale. E pakapërcyeshme. Megjithatë femra triumfon. Ndjeu duart e saj ta mbështillnin. Thjesht. Po thjeshtësia nuk është kurrë diçka e thjeshtë. - Shikomë dhe kuptomë! - thërrisnin sytë e saj, që sikur kërkonin të mos kishte frikë nga të pasurit frikë. Pastaj e ndjeu trupin e saj lakuriq, të zjarrtë që ziente nga ëndjet. Ai nuk refuzoi. U ngjesh te gjinjtë kërcitës që dridheshin në krahët e tij. Trupi ngjante i tejdukshëm ngjitur në trupin e saj. Lëshuar prej forcës së gravitetit. Si t'ia bënte që atë çast buzët e tij nuk ishin bashkuar si duhej me buzët e saj?

Ç'i donte të mbetura ashtu shkretë, ndërkohë që Hana Erdali, kruspullosur, e futur e tëra tek ai, ngrohte mishin e meskofshëve për aktin final? Nuk e kishte menduar se ajo do të ishte mbrëmja e fundit e takimit. - Po shkoj të përshëndetem me ditët që do të mungoj, - deshi të bënte shaka. Ishte i sigurt që pas kësaj do të merrte njëfarë shpërblimi. Buzët e plota të Hanës. Po Hana që ngritur në këmbë dhe vinte vërdallë duke numëruar sekondat e fundit të ëndrrës që së shpejti do të këputej.

- Merre me vete këtë, - deshi t'i pëshpëriste, por nuk mundi. Ëndërr ishte ajo? Ëndërr e vërtetë nuk është ajo që shikon kur je duke fjetur. Ëndërr e vërtetë është ajo që të lë natën pa gjumë.

Kur qenkësh zgjuar, Nelson Andrean e kishin zbritur me kujdes në tokë nga karrociera e mjetit ZIS (pasi të gjithë e dinin të vdekur) dhe vetë ai ishte habitur pa masë që këmbët i kishte ende të ngrohta. Kishte kapërcyer mesnata, koha me sa dukej ishte ndaj të gdhirë kur Rako Sirani hyri në portë të madhe, me çape të lehta hajduti, mos i thërriste kush dhe eci drejt odëjashtës. Vetëm kur u mbyll porta, u pa një hije që e ndiqte pas, dhe ai iu gërmush gjithë mërzi: - Boll! Dil nga aty! - Rako Sirani ishte vonuar shumë dhe Nelson Andrea dëgjoi si fëshfërimë gjarpri vetëm pyetjen e çuditshme të një tjetër gruaje: - E solle? - dhe bashkë me të, përgjigjen më enigmatike të botës: - Ëhë! E solla!

Kreu III

Kanatet e dritares u çelën tejtejet sapo ra drita. Pemëve të bashtinës dëgjoheshin cijatjet e zogjve që luanin me rrezet e diellit nëpër degë. Frynte erë e freskët që të mbushte mushkëritë, ndërsa pjerrësive çmendurake të shtëpive rrëshqiste kërshëria që kërkonte të prekte horizontin që s’dukej askund. Nelson Andrea ndjeu se në ato pjerrësi jeta e tij, po merrte rrokullimën drejt të panjohurës që s’dihej ku do të ndalej. Rako Sirani nga dritarja e shtëpisë përmbi pa orën e dorës dhe ashtu rrëgjuar i pohoi vetes: “Qenka shumë i ndjeshëm. Nuk fjeti as dy orë shejtani. Duket qartë që e paska munduar pezmi! Pezmi lë gjurmën e vet. Me këtë ndjeshmëri, keq do ta ketë. S’do ta honepsin dot dhe do ta hanë të gjallë. Bela e madhe!”.

Dita e parë, e plotë në lirinë me kusht ishte e vështirë për të dy, Nelson Andrean dhe Rako Siranin. Rako e ftoi të uleshin në sofanë e gurtë dhe një grua thatanike si shkurre ishte (ndoshta ajo që i priti në mesnatë) me shami të zezë në krye, u solli në tabaka, ujë pusi dhe një kupë me gliko arre. Pastaj solli bukë me djathë dhe thelpinj me arra. I la në shesh dhe iku. Si hije.

- E di që dje vuajte shumë, po tani më dukesh që e ke marrë veten. Ditë e re kështu i ri. Haje të ëmblën! - dhe për

vete mori në dorë filxhanin e kafesë duke ndjekur me bisht të syrit çdo lëvizje të tij.

- Për mua s'ka ditë këtu. Janë net dhe të gjitha njësoj. Dua të iki sa më parë. Më jep pasaportën. Unë jam amerikan - psherëtiu nervoz me zërin që fryu si puhi mëngjesi.

- Ç'pasaportë thua more? Kujt ia mban tani të kërkojë pasaportë? Kupton se ku je apo s'kupton?

- Ju faleminderit për mbështetjen tuaj, Rako. Singerisht. Megjithatë kushtet ma bëjnë të pamundur qëndrimin në këtë vend... - i ktheu përgjigje qetësisht alarmit të tij.

- T'ëmën e s'ëmës o Nelson Andrea! Akoma e ke mendjen te pasaporta? Të kanë sqaruar besoj atje në Ballsh. Pasaporta jote ka humbur. Është grisur, djegur a kushedi ç'farë. Nuk ekziston më. Kupton? Ngulite në tru kaq gjë! Ka humbur!

- Po mund t'i drejtohem shtetit amerikan, me letërporosi, përmes ambasadës amerikane në Greqi ose ndonjë ambassade të ndonjë vendi fqinj. Më ndihmo në ke Zot! - dhe bashkoi dy duart para fytyrës.

- Ti nuk ditke asgjë mor nipçe ç'kohëra të poshtra kanë ardhur? Si mund t'i drejtohesh ti një ambassade amerikane, në një shtet të huaj? Kush je ti xhanëm? Po unë si mund ta bëj këtë gjë?

- Jam shtetas amerikan. E shkruaj unë letrën, - dhe sytë i shkreptinë si ato xixëllonjat që bëjnë vija të ndritura kryq e tërthor, - e dërgoj në emrin tim dhe ti je jashtë kësaj valleje.

- Mblidhe mendjen njëherë e mirë, tani je një shqiptar. Je si unë. Si yt atë. Në fund të fundit këtë origjinë ke. Po kërrove lëmoshë lart e poshtë, të mori lumi. Pranoje fatin tënd dhe s'do të të dalë keq. Këtu kanë thyer kokën burra

me një pëllëmbë mustaqe, merr vesh ti? - shprazi fundin e durimit dhe kokërdhoku i majtë me vijëzën e bardhë në mes nisi të lëvizte i shqetësuar lart e poshtë.

- Nuk ka shpresë? - tingujt duket sikur dolën me zor nga gurmazi i lodhur.

- Unë do të ndihmoj jo vetëm se të kam timin, por e kam dhe detyrë shteti. Po t'i mblidh mendjen, dëgjon. Nuk bëhet shaka në këtë shtet. Do të shikoj mos të nxjerr dhe një pasaportë të re shqiptare. Mbase të ndërroj dhe emrin se ky që ke, Nelson, Nelson... bie erë amerikanizëm. Do të na hapësh punë. Mbiemrin mbaje siç e ke.

- Vërtet beson se do e pranoj këtë fat?

- Fatit duhet t'i bindesh nipçe. Ç'kujton ti se është jeta?

- Kurrë!

- Atëherë ç'pret që nuk vdes? - kokërdhoku i tij i shqetësuar lëvizte si i çmendur. Duart e gjata eshtake, gjithë lesh, u lëshuan poshtë si të bëheshin gati për sulm.

- Ç'do të bëj unë në këtë vend?

Do të gjejmë dhe një punë, dhe strehë ku të futësh kokën. Tani e tutje në dynja ty do të njohin si nipin tim. Nipi nga fshati. Djali i motrës që më ka vdekur. E more vesh? Kështu do t'ju themi komshinjve kureshtarë, të njohurve në punë e miletit në Pazar. U morëm vesh? Sakën se të shpëton goja! Sa t'i vë në vijë gjërat. Më tutje shohim. Me të parë e më të bërë, po derisa të mësohesh e të njohësh qytetin do të rrish këtu tek unë. Mos më bësh ndonjë marrëzi e të vete mendja të arratisesh? As dreqi s'të shpëton dot pastaj nga varja në litar, ja aty në mes të sheshit "Çerçiz Topulli".

Nelson Andrea ndjeu ta lëshojë zemra kur kuptoi se ditët e këqija prej atij çasti s'do kishin të mbaruar. Pas një

kalvari vuajtjesh e peripecish po niste një tjetër akoma më i vrazhdë, më i pakuptimtë. Zinxhiri me sa dukej s'do të kishte të sosur.

Ç'njeri qenka ky Rako Sirani dhe përse ati i tij nuk ia kishte përmendur asnjëherë ekzistencën? Ç'detyrë shteti kishte ai të kujdesej për të? Përse po e mbante në shtëpi? Po shpenzimet e fjetjes, ngrënies, rrobave kush ia paguan? Si mund të shpëtonte prej tij?

Brenga, ngaqë kishte humbur lirinë dhe identitetin, ngriti krye. Befas, përleshaj saj, po provonte një ndjenjë të panjohur më parë, urrejtjen! Urrejtjen. Energjinë shkatërrimtare që po i përndizte trupin dhe mendjen. Shkretëtira. Venat e gjakut sa s'po pëlcisnin nga zjarrmia. Për herë të parë në jetë uroi vetëpërmbajtjen, sjelljen e urtë, dëgjimin. Paralel me të, mendoi të kryente një vrasje. Të vriste Rako Siranin, njeriun që po e riburgoste, por kësaj here ndryshe, pa ia lidhur këmbë e duar. Ai po e çonte drejt një bote tjetër. Atë çast përbuzi gjithçka që i erdhi ndër mend, humbjen e pasaportës, arrestimin, burgun, torturat, mashtrimet, kujtesën, botën e pabesë. Ka raste kur analiza e njeriut me lakun në fyt mbërrin në një pikë dhe aty ndalon. Fatin pastaj e merr në dorë, ajo dora hyjnore e Zotit. Si një çlirim a si një shpëtim, iu kujtuan sërish fjalët që ati ia përsëriste shpesh atje në dhomën e gjumit kur e qortonte për gabimet: “Ne rritemi duke u rrëzuar dhe vdesim duke qëndruar poshtë!”. Pse kishte thënë ashtu? Tani nuk tallej dot me të. Tani ishte vetë një udhëtar i botës dhe çdo ditë zbulonte një zonë të re brenda shpirtit të tij. Mendja nuk është enë për t'u mbushur, por një zjarr, i cili duhet të mbahet ndezur.

Nuk e besoi se sa gjatë mbeti pa gojë, ashtu në shastisje e humbime gjersa Rako i rrahu shpatullat duke i pëshpëritur:

- Më e mira do të bëhet. Mos e vrit mendjen. Ç'i qi t'ëmën!
Shko vish teshat e reja që të kam blerë se do të dalim në
qytet. Dhe sakën, sakën: Gojën me kyç!

I ziu njeri! Doli dhe u shtang, në atë qytet guri që
ngjante se do të gremisej. I hidhte këmbët kuturu. Shtëpi të
deformuara, formë mbi formë, me kënde që futeshin te njëra-
tjetra, të varura, skiç, kapërthyer në kapriçio ndërtimore të
çuditshme, me sprethe të shqyera, mure e barqe të fryra, tela
elektriku korkolepsur, suva të rëna, vrima të mëdha, harqe
dhe pastaj thyerje trigonometrike pa kuptim, të gjitha këto
si pikturat surrealistike të Salvador Dalisë, e marramendën.
Sokakët ndërlihdës, midis asaj katrahure unike, ishin aq të
ngushtë sa të merrej fryma e nuk ngopeshe dot me ajër. Ishte
e pamundur për njeriun e këtij qyteti të rrotullonte krahët
nga lumturia. Kaq ngushtësi. Pëllëmbët do të gjakoseshin
në muret e gurta. Hapësira dhe shikimi kufizohej. Thyhej,
përthyhej. Lindnin antifomat. Dritaret ishin po ashtu të
ngushta dhe me hekura në formë katrorësh. Si dritare burgu.
Të dy me Rakon u ngjitën nëpër një rrugë kalldrëmi gunga-
gunga, që më tepër ngjante me mur të pjerrët, të prishur.
Po e gjithë kjo skëterrë e kish një fund, kur dolën sipër, në
qafën e Pazarit. Aty syri merrte sheshpamje dhe harmonia
ndërtimore jepte shenjat e qarta të daljes nga shpërgënjtë e
gjakosur të mundimit e ndërkryerjes. Me përqendrim pak
më madh mund të vërejë se si shkollat ndërtimore të krejt
Ballkanit, mbase dhe psikikat e qytetërimit e tyre, ishin
kacafytur, përleshur e gjakosur për pak më shumë hapësirë,

dritë dhe ekspozim, që në thelb do të thoshte liri dhe njohje. Sa e shtrenjtë paskësh qenë hapësira e këtij qyteti? Gjatë ecjes për krahu Rakos nëpër sokakët shtrembaluqë, udhës për Pazar, ai nuk mund të mos vërente gjithë kureshti dhe një veçori tjetër të qytetit: njerëzit. Sa shumë njerëz të gjatë, të zymtë, duhanpirës dhe kurrizkërrusur! Si të mos mjaftonte kjo, shfaqej si gravurë, ecja e grave kokulura që ndiqnin dhjetë metra nga pas burrat e tyre. Kur u përballën me një ndërtesë trekatëshe guri, harqelartë në ballinë, dritare të mëdha, pozante e që s'ngjante hiç me të tjerat, as orient dhe as oksident, pak para ngjites për në qafën e Pazarit, Rakoja e ndali, dhe në kapardisjen boshe si sakatllëk psikologjik që e kishte brenda vetes, sqaroi: - Këtu punoj unë.

- Këtu? Ashtu? E çfarë pune bën ti këtu? - dhe përgjatë atij çasti pyetja sikur solli trazirën e një grumbulli zërash, njëlloj si murmurima e gurëve që tërhiqen në zallishtë. Në fakt do ta kuptonte ca kohë më pas, ato ishin pëshpëritjet e thashethemet që dilnin nga kafenetë e mbarsura dëng, binin mbi Rakon mbase dhe mbi të, dhe mbetën si kujtim i parë që dhe mund t'i urrente, por kurrsesi nuk mund t'i fshinte.

- Jam arkivist në Komitetin Ekzekutiv të qytetit, por punoj dhe atje, - dhe uli tonin kapardisës të zërit, - punoj dhe në Degën e Brendshme si shifrant. Më thërrasin herë pas here. - Pas këtij shpjegimi që nuk u kuptua ashtu si duhej prej Nelson Andreas, Rakoja e tërhoqi për krahu dhe të dy sipas fabulës, ungj e nip, hynë në kafenenë ballore të qafës së Pazarit. Kafeneja ishte plot. Plot me burra. Asnjë grua. Të ulur nga tre e katër nëpër tavolina, burrat pinin duhan dhe flisnin me zë të lartë. Dikush ia bëri me kokë Rakos dhe ata shkuan te tavolina përfund, në tejanë të dritares.

Kamerieri solli dy teke raki. Rakoja piu një gllënjke dhe tha: - Faleminderit Baze. - Ashtu bëri dhe ai. Bazja, miku që e ftoi ia nisi menjëherë ankesës: - Vate dhe xhamia në të s'ëmës. Iku. S'ka më allah, allah që në pesë të sabahut!

- Më mirë, - mbajti iso Rakoja. - Ç'të mirë patëm nga pëllitja. Na dha gjë bukë? Jo!

- Mirë, mirë xhanëm, po sikur jeshëm mësuar me të, - shfaqti shenjën e parë të nostalgjisë Bazja.

- Ehu, gënjeshtër ishin, opium. Se mos i deshëm vërtet. Ca kohë kaurë e ca të tjera myslimanë. Përdh... përdh... Bela i kishim, - tundi kokën qortueshëm Rakoja.

- Jo mo s'thashë gjë... Po ç'tuhet në Komitet mo vëlla, kush do prishet më parë xhamia e Memi Beut në Pazar apo kisha e Kryeëngjëjve në Çetemel?

- Komiteti ka punë të tjera Bazeeee! Po ç'të ha meraku o Baze kush do prishet e para. Fut gjë në xhep ti?

- Jo mor jo, po kam gusto. Kam gusto të shoh kush do ta ruajë mjekrën i pari, myftiu i Pazarit apo prifti i Çetemelit? Se thonë që njëri do të bëhet kafshar e tjetri do të bëhet bekçi. Ha-ha-ha-ha.

- Hë dreq që s'të pushon goja. Që të vegjël na mësonin të kishim kujdes nga ujku, por tani që jemi të rritur zbulojmë se rreziku i vërtetë vjen nga delet. Ç'i thua kësaj ti Baze? Po vuri fre gojës të paktën. Vuri fre. Sakën se flet dhe me të tjerë kështu! Janë punë me zarar këto Bazeeee. Ti e di atë këngën: *Shëndet paç xhiko Lale / as të paç e as më pe...!*

- Ashtu, ashtu.

- E pra...

- Jo mor jahu sikur thashë, po meqë rinia e ka nisur me zjarr këtë punën e prishjes së kishave e xhamive, thashë

ti bashkonem dhe unë rinisë, - kapsalliti sytë Bazja që e kuptoi se duhej ta fuste bishtin ndën shalë. Dhe nuk iu durua të thoshte dhe një gjë të fundit: - ajo që besohet kudo, nga të gjithë dhe përgjithmonë, i ka gjasat të jetë gënjeshtër. Ja kështu...!

Pa mbaruar Bazja fjalën, bufisti i lokalit ngriti zërin e radios. Buçiti zëri i udhëheqësit. Udhëheqësi iu drejtua të rinjve, të rejave, punëtorëve e fshatarëve, grave e burrave të Shqipërisë të ngriheshin e të shkulnin nga themelet kishat e xhamitë. Me zjarr e hekur. Shkretim. Fjala *shkul* menjëherë sikur fitoi fuqi cikloprike që të sillte ndër mend pluhurin, rërën dhe hapësirën e shkretëtirës së Saharasë. Ishin ditët e para të një inkuzicioni kulturor e fetar që kishte nisur kinse siç u tha, nga të rinjtë revolucionarë në një shkollë të mesme të Durrësit. Flaka u përhap me shpejtësi dhe udhëheqësi po i printe popullit. Tinëzisht, udhëheqësi përmendi fjalën dritë, dritë midis fjalëve shkul, zjarr, hekur, djeg, rrafshim etj., që bënte kontrast të thellë psikik dhe ishte luks i pazakontë. Gjëja më e ndritur me gjënë më të errët. Drita, drita diellore dhe gjëja më e errët në botë, vdekja. I manovronte shkathtësisht dhe i shfrytëzonte të dyja. Burrat dëgjonin gojëhapur. Heshtja zgjati deri në fund të fjalimit. Pas fjalës së udhëheqësit në programin e radios u lëshua muzikë. Këngë revolucionare, ritëm e patos. Ky sikur ishte sinjali të riniste tollovia. Zërat u ngritën në kupë të qiellit. Drejtimi ishte dhënë. Rakoja nuk humbi kohë dhe iu drejtua: - Ia bëtë fora more nipçe! - Nelson Andrea shqeu sytë. Ishte i gjithi në mënyrën habitore duke mos kuptuar asgjë nga ai realitet që e vendoste pa dëshirën e tij midis absurdit dhe groteskut. Por Rakoja kishte përlogaritur gjithçka.

Bazja nuk duroi: - S'të ka ngjarë hiç!

- E kam të motrës së ndjerë, asaj të fshatit. Është i tronditur nga dhimbja, po do t'i kalojë. Do rrijë këtu në qytet tani se dhe ne helbete s'kemi fëmijë dhe e duam një për pleqëri...

- Ç'thua more, si ta nxë goja, ti je i ri, marshalla. Do bësh fëmijët e tu. Ky të rrijë sa të dojë, po a ... - kuturisi Bazja që nuk e fshehu dot kënaqësinë e hakut të marrë.

- Harro mushkë Valarenë, - kroi zërin Rakoja që u kapërdi dhe bëri sikur e gëlltiti qesëndinë. Pavarësisht therjes në brinjë, ai e kishte mendjen tjetërkund. Qeshi përbrenda vetes për triumfin, atë që aq lehtësisht ia kallli Bazes, thagmën e nipçes. Bazja ishte agjenci lajmi. Sapo të dilte nga kafeneja, Pazari dhe gjithë qyteti do ta merrte vesh lajmin: Rako Sirani, burri që s'bën fëmijë e solli nipin nga fshati në qytet për ta pleqëruar...

Qielli i atij muaji ishte si i prerë me thikë: paradite angështi mbyttëse, përvëlim dhe pasdite shira me rrëshkë e rrebeshe. Mërzi. Mërzi pafund që futej gjer në vrimat e harcat e mureve, rrëzomave e sokakëve spërdredhur nga ngërçi e ligësia. Mërzia shtohet më tepër në orët e mbrëmjes, orë kur dukej se zotat shpraznin gjithë ndërkryerjen dhe mërinë e tyre. Hera-herës nëpër rrugë dëgjohej buçima fitimtare e zërave. - Janë vullnetarë, - qartësonte Rakoja. - Që janë vonuar kaq shumë, me siguri kanë ardhur nga larg. Mbase nga fshati malor i Labërisë. - Ditët fillonin e mbylleshin me lajmet e prishjes së kishave, xhamive dhe arrestimet. Prishja

paraprihej nga tubimet e zgjeruara të grave e vajzave. Ato diskutonin me zjarr ligësinë e zakoneve prapanike dhe helmin reaksionar të besimeve fetare. Rrokopuja dhe rrëmeti nuk ndalej. Si të mos mjaftonte ky rrëzim, disa kisha mesjetare u shndërruan menjëherë në vatra kulture. Kërcim dhe hare. Disa të tjera u bënë hambarë të misrit dhe fasuleve. Me xhamitë, vullnetarët u treguan disi më të përmbajtur. I topitur prej plogështisë e moskuptimit, Nelson Andrea strukur në krevatin e drunjte të odëjashtës, mbërthyer në mall torturonjës, qëndronte pa lëvizur në pritje të Rakos. Bashkë do të bënin ritualin e përditshëm, shtëpi - Pazar. Pinin kafe bashkë, mësonin thashethemet e reja të qytetit dhe pastaj ndaheshin. Ai kishte pikasur se në këtë qytet nuk kishte nevojë për media, gazeta e radio. Në qytet të përpinte thashethemi. Rakoja më pas shkonte në Komitet, ndërsa ai vërdallosej rrugicave e diku rreth drekës zbriste në strehën e tij, odëjashtën. Atë mëngjes Rakoja i tha se pasi të pinin kafe në Klubin e Gjuetarëve, do ta çonte të qethej. Flokët ishin rritur me tepri pas daljes nga burgu dhe ai s'mund të ecte ashtu serbes rrugës së gjimnazit apo lulishtes së artizanëve të qytetit. Ishte bindur. U ndanë shpejt me njëri-tjetrin dhe ai hyri në berberhanen në qendër. Berberhania ishte një kthinë e vogël, por xixë nga pastërtia. Ishte një normalitet i lëmuar, i rehatshëm, si varrezë lulësh. Berberi, një gjatovino plak që dukej se do t'i cikte koka në tavan, me fytyrë sikur kish fikur zjarrin me ujë dhe me sytë lavrashë plot shkëlqim, e ftoi të ulej, me gjest përlusës, si t'i thoshte se në berberhanen e tij fshihej serioziteti i duhur mbi gjërat që kanë më shumë rëndësi. Koka e Nelson Andreas e paqethur, e pamodeluar prej një kohe të gjatë,

bubuzhel si tallej Rakoja, ia jepte atë përshtypje. Kokë fshatari e pagdhendur!

- Hë more nipi i Rako Bandillit, si do t'i qethim flokët? - pyetja e tij hokatare iu duk bulurimë e heshtur gjallnimi. Mendja e njeriut është magnet. Po mendoi gjëra pozitive do të tërheqë gjëra pozitive, po mendoi negativisht do të tërheqë mendime negative. Ndonjëherë lëkura, moda, raca, ndotja a pastërtia e mjedisit, sëmundjet, frikërat, të gjitha bashkë përpiqen të njëjsojnë portretin njerëzor. Berberi i pëlqeu. Duhet të jetë burrë i zgjuar, ndryshe nga Rakoja e të tjerët dhe kjo shkreptimë e marrë drite kërkoi t'i depërtojë brenda gjer në vena. E kishte marrë malli për hoka. - Prit i bërtiti vetes, sepse çdo histori ka tri anë: e jotja, e tij dhe e vërteta. - Si t'ia bënte? Ku të gjente të fliste me një njeri normal.

- Si të duash ti, - puliti sytë i dorëzuar, brishtësisht, me atë zhurmimin e hollë, që lënë në eter krahët e një fluturë të lodhur nga vapa e mërzia. S'kam asnjë pëlqim.

- Ma lër mua në dorë, - berberi që e lexon gjithnjë fytyrën e klientit, nxori shpejt e shpejt nga komodina me shkathtësi të habitshme pecetat e bardha, ia rrotulloi rreth qafës dhe filloi zanatin me gërshërët që i përplaste me njëra-tjetrën pa pushim. Duart me gishtat e hollë, të gjatë kishin elegancën e një violinisti. Lëviznin shkathtësisht sikur gjithçka e dinin që kur kishin lindur. Duar profesionisti. E qethi shkurt, me një cullufe të lehtë mbi ballë. Nelson Andreas as që i bëri përshtypje modeli i për zgjedhur prej tij. Kishte hequr dorë nga disa gjëra më të rëndësishme, ose më saktë ende nuk e dinte kush ishte, ç'kërkonte në këtë vend dhe ç'do të bëhej me jetën e tij? Një ligështim therës i vërshoi në damarë.

Tani e kishte më të qartë pse fytyrat janë pasqyra të shpirtit: shkëlqejnë me shkëlqimin e tij dhe nxihen me nxirjen e tij.

- Pak xhel? - as vetë nuk e kuptoi sesi shqiptoi atë fjalë që sikur rrekej të zbulonte të veçantën, për të rikthyer një copëz nga shpirti i humbur... - Mbase erdhi edhe si reminishencë e asaj kohës tjetër.

- Livando. Vetëm livando ka tani, - dhe tundi kokën berberi plak me ato leshrat pis të zeza, të lyera me pak brilantinë shkëlqyese, që kushedi sesi e siguronte. Nuk e pyeti ku e dinte xhelin, parfumet a gjëra të tjera si këto. As i tha: Si ka mundësi që ti nipi i Rakos prej fshatit na paske kaq naze e pretendime. I ngriti zërin radios që transmetonte muzikë popullore: - Të tjerat? Të tjerat le t'i lëmë për herë tjetër, - dhe nisi të rrëfejë barsleta e qyfyre duke qeshur me të madhe.

Nelson Andrea u ngrit vrik. Nxori lekët nga xhepi dhe deshi të paguajë. Të ikte sa më parë.

- Ka paguar Rako Sirani, - dhe ai ndjeu vështirimin më zhbirues të jetës që sikur deshi t'i thotë: - Zogjtë nuk e ndërtojnë folenë në kafaz, që të vegjlit e tyre të mos trashëgojnë robëri. Mos e harro!

Berberi dukej njeri fisnik, zotëri i vërtetë. Me ç'dukej ishte nga ata të cilëve ngase vdekja nuk iu erdhi në kohën e duhur, çapiteshin ende nëpër kohë, në gjurmët e nostalgjisë.

Kurrë nuk e kishte ndier më të ngadaltë e të dhunshme jetën në këtë vend, se sa ditën kur u ngjit në fshatin ku kishte lindur. Prej tij ishte larguar dy vjeç dhe s'mbante mend

thujase asgjë. I kishte kërkuar Rako Siranit ta çonte te varri i nënës. Pas shumë kohësh, më në fund, ai e lejoi të shkonte, sepse dhe për të lëvizur nga një vend në tjetrin duhej lejë. Lejë nga dega e brendshme. Dhe shkoi në fshat për të qarë te varri i saj, në krahët e Sofisë, kështu e quanin nënën e tij. Ta pikëllonte edhe atë dhe t'i thoshte se ishte mëkatar pa faj dhe sa shumë që vuante. I kishin thënë se ajo iku nga bota e të gjallëve sapo e solli në jetë. Ndaj donte çmendurisht të shikonte fshatin, fshatin ku ajo ishte martuar dhe e kishte lindur dhe le të vdiste pastaj. Nuk i kishte folur askush për të. As Sotiri, i ati. Si kishte qenë ajo? Si kishte vdekur? Nëna e panjohur, që, ndonëse kishte vdekur, çuditërisht nuk i shfaqej, por ai e ndiente fort shpirtërisht. Prej saj me ç'dukej kishte brenda vetes artistin. Dhe atë brengë krijimi që i ngjan aq shumë hjekës së vdekjes. Pse nuk i kishin treguar asgjë për Sofinë? Si kishte qenë ajo? Kur u ngjit në fshat ç'të shikonte: Shtëpia e Sotir Andreas që i thanë se gjendej matanë arrave, ishte prishur. Në oborr kishte veç një saç të vjetër, dy-tri pemë dhe dy-tre qen stani që ruanin tufën me dele. Tutje, ishte një pus. Përse erdhi këtu? Mos donte të pinte ujë e të shuante etjen? Apo mos donte të lahej në përroin e mullirit që rrokullisej si vajtim? Gjithë fshati ishte me shtëpi të mëdha, gjysmë të rrënuara, bosh. Ca më tutje fushëtim me ullinj të vetmuar, heshtje e qetësi si në një qimiter. Atëherë ç'ishte gjithë ajo çoroditje, si një dalldi, që e bëri të dridhej? Ai kishte ardhur vetëm të ngashëronte në varr të nënës, si një mundësi për të rimarrë fuqi që të vazhdonte jetën. Ngashërim. Dhe rrëfim. Ai e kishte mbajtur kujtimin e saj (për fat të keq pa e parë kurrë) brenda gjoksit të tij. Po kush e kishte parë nënën që ai mbante në shpirtin

e tij? Kërkoi të dinte vendin e varrezës së fshatit dhe ia treguan. Shkoi atje pa mbajtur frymën. Ishte ditë e ftohtë marsi, paçka se nën rrezet e një dielli në perëndim. Dëgjohej fërfërima e gjetheve të reja. Edhe pemët lëkundeshin prej atij fliladi perëndimor. Ngadalë po binte muzgu. Në varreza, ndryshe nga fshati, pastërtia ngjante shembullore dhe shihej dora e dikujt që kujdesej vazhdimisht për to. Duhet të jetë kujdestari i varrezave, besoi, ai që vazhdimisht thotë, se e bën për shpirt. Kështu i kishin thënë. Aj, aj. Ja ku qenkësh! Si hije. Hollak. Flokëbardhë. Ishte vërtet njeriu dhe jo fantazma, në mes të varrezave që ndizte qirinj, pastronte gjethe e barëra. Pa zhurmë. Nuk kishte parë burrë më të bukur. I gjatë, me kostum të errët, tejet nostalgjik, sikur sapo kishte ndier dhimbjen e mprehtë të një brenge që s'mbyllet. Lëvizja dhe veprimi i njeriut s'duhet të përgjohet, por Nelson Andrea nuk rrinte dot pa e parë atë burrë. U afrua ngadalë dhe e pyeti, e pyeti për Sofinë. Për varrin e saj. Kur përmendi emrin Sofi, ai u drodh, sikur të ishte duke parë gjëmën e padëgjuar. - Ah, Sofia. Vajza me gërshe të verdha gjer në fund të këmbëve. Gjithë fshati qau kur iku ajo, (çudi nuk tha vdiq). Lutemi për të. Lutja jonë del nga zemra e mbytur në dhembje, plot vajtime të trazuara me shpresa. Mirësia, dëlirësia dhe bukuria e saj nuk është e shurdhër ndaj rënkimeve dhe lotëve tanë. Ajo vuan bashkë me ne. Ajo ka qenë dhe pranë teje duke të fashitur dhimbjet, plagët, vuajtjet, lodhjet, duke të lehtësuar nga lëndimet e shpirtit. Me siguri. Ajo e di që besimi ynë, që është dhe besimi yt, është i madh dhe i përjetshëm, sepse është krijuar çdo ditë me sakrifica të mëdha...!

- Nuk ke frikë? - Nelson Andrea pëshpëriti në mundim brengën që po i çante gjoksin. - Nuk ke frikë, (kujtoi zërin e udhëheqësit: t'i shkullim me zjarr e hekur dhe brohoritmat e turmës) sepse dhjetëra njerëz që enden nëpër rrugë i ka lëshuar shpirti. Sa prej tyre mund t'ju kallëzojnë? Dhe atëherë...!

- Unë shërbej për të gjithë ata që janë në udhën e Zotit. Të tjerëve u bëj thirrje të braktisin rrugën e mëkateve, të djallit. Askush nga ata nuk i ngre dot sytë nga qielli pa u ndier i turpëruar për ndyrësitë që ka bërë. Le të pendohen sa s'është vonë. Turpi nuk të shëron. As të ndihmon të lash mëkatet. Turpi të shënjon! - kështu tha rojtari plak që dukej sikur bënte krezmime për besimtarët. Ai fliste dhe një pikë lot që i gëlonte në mes të syrit të trishtë, rrokullisesh shqepur e grisur nëpër qerpikë dhe i mbetej në cep, pezull, për një kohë të pakohë, pa u rrokullisur, derisa ai e fshinte me dorë.

- E ke njohur nënën time, Sofinë? - Nelson Andrea i thërriti kujtimeve të pajetuara, sepse çdo ditë ishte rritur duke përfytyruar Sofinë, si fliste, si përkëdhelte, si e ushqente, derisa u bë burrë, kur i lidhte kollaren mbi këmbë e bardhë. Si do të ishte jeta e tij nëse Sofia do të jetonte? A do të ishte ajo me Sotir Andrean në Amerikë? Këtë nuk e mësoi dot kurrë. Nuk kishte si ta mësonte. Nga kush? Sotiri, ati, nuk e shqepi kurrë gojën. Nuk fliste për Sofinë. Asnjë fjalë të vetme. Nuk e zinte në gojë. Sikur kishte bërë be. Sa herë binte fjala, ai ngrihej dhe ikte. Ikte ndonjëherë me ditë të tëra. Kaq shumë zemërohej që s'ia respektonin paktin që kishte bërë me veten dhe të tjerët. Sikur e kishin mallkuar. Po si nuk pëlçiti xhanëm? As kur mbylli sytë nuk i tha asnjë fjalë për Sofinë. E mori me vete në varr të fshehtë e saj.

Po çfarë kishte ndodhur? Kush do t'ia tregonte djalit të saj?

- Kush nuk e njohu shenjtorën Sofi. Ashtu ishte ajo, - e përmendi nga të thellat rojtari plak i qimiterit që nuk e fshehu tronditjen e habinë. - Paske ardhur që nga Amerika?

- Kam ardhur, - për herë të parë pohoi qenien e tij si amerikan. - Po ku është varri i saj? Dua të shkoj aty!

- Prit, - tha rojtari plak. - Do të shkojmë bashkë. Është goxha larg. - Mblodhi gjithë veglat në çantë dhe u nisën.

- Ku? - pyetja e tij u ngjit pas hapave të shpejtë të rojtarit. U ngjitën lart drejt rrëpirës që të çonte te vendi i shenjtë. - Këtu? - habia e tij e lëkundi dheun, sikur ra tërmet. Hynë brenda në ngrehën e gjymtuar. Dritë nuk kishte. Rojtari ndezi kandilin.

- Sot do flesh këtu, nesër shkojmë te varri. Është gjynah të vemi natën, - dhe e zuri djalin për supesh si të ndanin bashkë të njëjtin mendim. Hëngrën bukë misri me djathë e qepë dhe u rregulluan për të fjetur në një qosh të kishës, në pjesën perëndimore, pas altarit të zbërthyer, pasi pjesa tjetër ishte kthyer në magazinë kallamboqi. Atje të grinte era e malit, që frynte me shkulme të pasosura, ndonëse jo shumë tinëzare. E dëgjonin erën si vraponte me ca sokëllima të zgjatura, e dëgjonin si hynte e dilte nëpër vrimat e të çarat e mureve, duke goditur me duart e saj prej ajri kryqet, ikonostaset, menteshat e dyerve. Ca korniza shenjtorësh të mbetura në mure u rrëzuan. Me krakëllimë. Pak para se të gdhihej era u qetësua. Por pastaj u egërsua prapë. Atë çast rojtari i tha: - Sofia nuk ka varr në fshat. Eshtrat e saj erdhën dhe i morën vëllezërit, dajot e tu. Një vit pas varrimit. Dhe janë atje...!

- Si ta thonë emrin më the, - rojtari plak picërroi sytë që të shquante më mirë ndonjë nishan a siluetën e saj në fytyrën e tij.

- Nelson, Nelson Andrea, biri i Sotirit, - u ngashërye prej mallit për tokën ku i kishte lindur koka. Njëzet e pesë vite që kur kishte ikur (dy vjeç e mori ati në Amerikë) njëzet e pesë thika që në shpirt po dhembnin.

Rojtari heshti, u dogj përbrenda si një perëndim. Me sy të hapur, sikur shihte një ëndërr llahtari, llogariti me mendje se sa shpejt ndërronin motet dhe mallkonte veten që kishte mbetur i gjallë të jepte shpjegim. Dita e të vërtetës kishte mbërritur, i duhej të ishte i ngopur me frymë dhe pa ata sytë e mjegullt plot lot si dritare të ngrira me brymë. E gjora zemër, ç'sharrë të sharron e të pret enët e gjakut?

- Nelson më the? - zgjati veshin. - Jo, jo. Nelson? Mbaje për në Amerikë, Nelsonin. Këtu të pagëzuan me emrin Gur. Gur ta vunë emrin. Gur të thirri Sofia deri në frymë të fundit. Nuk e ke dëgjuar piskamën e saj kur ngjitet gjer në hënë: Gur, o Guri im!

Mbeti pa fjalë. Nuk dinte gjë prej gjëje. I gjithë malli i tij kishte qënë flu, një re e përhershme në qiell që e kujtonte se diku, atje matanë, matanë, larg oqeanit, në vendin e quajtur Shqipëri, nëna e tij Sofia kishte humbur jetën sapo lindi djalin e vetëm. Dhe e kishte pagëzuar me emrin Gur, që të bëhej i fortë, i dobishëm, i pavdekshëm. Po si, si kishte ndodhur kjo?

Rojtari plak i qimiterit, i merr dorën në pëllëmbën e tij të rreshkur nga vuajtja dhe i rrëfen historinë, krejt si të rrëfente një përrallë. Secili e shikon më parë përrallën që rrëfen, si në ëndërr, ndaj duhej dhe nata që ata ndenjën

bashkë. Nata duhej që të largonte mornicat-akull që i kishin ngrirë zemrën dhe sytë.

- Sofia erdhi nga lindja, andej nga kufiri, - ia nisi rrëfenjës. - Sotiri, ati tënd ishte ndërtues me nam dhe kishte shkuar të ndërtonte një urë në fshat të saj. Vetë i tretë. Se ashtu punonin ata. Kishin marrë veglat, qereste, ushqime e zahire, deri dhe qerret me gëlqere. Biles dhe leshrat u binin erë gëlqereje. Atje punuan si dinin. Mjeshtërisht. Aq ishin të kënaqur në fshatin kufitar, ndarë në mes me pjesën tjetër strugane, sa bënë be kokën e tyre. Vendasit kishin provuar disa herë të ngrinin urë, por urat u binin. Nuk mbanin. Nuk mbanin qerret e punës dhe gratë që shkonin ngarkuar sa nga njëra anë e kufirit në tjetrën. Ura e re i kishte shpëtuar. Ajo dukej e fortë. Gur. Gur i ngjizur e ngjeshur me fije leshi, gëlqere, të bardhë veze dhe mjeshtërinë që ustallarët nuk e tregonin. Këtë urë të fortë, anës lumit, rrinte e na e vështronte një vashëz. Sofi ia thoshin emrin. Sytë e saj ishin mbërthyer mbi ustain më të ri, Sotir Andrean. Dhe ustai i ri, mustaqelli e shpatullgjerë, nuk ia ndante vështtrimin. Kur mbaroi ura dhe ustallarët do të ktheheshin, ajo shkoi me vrap në shtëpi e iu tha të vetëve: - Mbamëni dhe këtë darkë se nesër unë do shkoj ku Zoti më ka caktuar fatin. - Na thuaj, - e pyetën vëllezërit. - Ç'është gjithë ky ngut? Na thuaj para se të flemë. - Iki me Sotir Andrean, muratorin mustaqelli, - tregoi Sofia gjithë mburrje. Ngritën supet vëllezërit. Muratorët ishin fisnikë. U ngrën dy vëllezërit e për gjithë natën e shkuan atje ku kishin bujtur ustallarët. U ulën me ta e shtruan muhabete. Ranë dakord e shtrënguan duart. Të nesërmen, që pa gdhirë, përcollën motrën e tyre deri te burimet e ahishtave të gjera matanë fshatit. Sofia,

hipur në qerre, si perëndeshë e dheut erdhi në fshat. Ç’dasmë që tundi dhenë! Pjesën tjetër të historisë ti e di, - mbylli sytë e lodhur, që atij i ngjanë si dy porta të tempullit të flijimit dhe mori frymë i lehtësuar. - Po varri, varri i saj ku është? - ngulmoi, si të klithte një ulërimë. Këtë s’ta them dot, - tha plaku dhe psherëtima e tij e dërgoi përfytyrimin kushedi në ç’varrezë të panjohur mbuluar me baltë të zezë. Me një gur harrimi përsipër. - Ka njëzet e shtatë vjet që nuk e di ku është ai varr. Erdhën dy vëllezërit dhe e morën. Ti ishe ende në shpërgënj. Nuk kishe si ta merrije vesh. I morën vëllezërit eshtrat e saj dhe ikën. Ikën në atë fshatin e tyre juglindor në kufi, matanë në Strugë. Atje duhet të jetë varri. Nuk e di në anë të lumit, apo në brendësi të urës. Këtë e dinë vetëm ata o bir ... - Kaq tha rojtari plak atë mëngjes dhe e fali si dhuratë frymën e fundit. E kishte mbaruar detyrën. Po a ishte vërtet rojtari plak apo fantazma ajo që e ndihu Nelson Andrian të mësojë një pjesë të historisë? Këtë do ta shohim në vijim.

Nga të gjitha malet rreth e rrotull qytetit, Mali i Gjerë është më shkëmbori, me përrenj egërshanë, që lëshojnë poplat¹ e tyre përposh në brigje e fundaja, me shiun më të hollë, ndonjëherë edhe përmbi shtëpi e bashtina. Qyteti është vendosur në prehër të malit, në ca gërxhe e rrëpira të thella që s’dihet ku e kanë fundin. Mali ka atë gurin gri me të cilin shkrihet e gatuhet gëlqerja, ky është shpjegimi pse

¹ Gurë të rrumbullaktë - dialektore.

të gjitha mpiksjet, ndërtimet dhe lyerjet bëhen me gëlqere. Gëlqere, të bardhë veze dhe lesh të dhirtë, nga shpikjet më të qëndrueshme ndërtimore. Diku në hyrje të qytetit janë furrat e mëdha të gëlqeres, në brendësi hauret e karvanëve të kafshëve me të cilat ajo transportohet. Gëlqerja është element i rëndësishëm i jetës. E bardha e saj është simbol pastërtie e ndriçimi. Çdo shtëpi ka në bashtinë të vet nga një gropë gëlqereje. Me gëlqere lyhen muret, drurët e pemëve, sofatet, pusët, sterat¹ e deri gatuhet ëmbëlsirat e glikotë. Një e tillë gjendej edhe pas odëjashtës së Rako Siranit. Ajo pluskonte gjithë natën gllu-gllu. Era dhe dielli ka djegur e dërrmuar një pjesë të mirë të faqeve, shpateve të malit, pikërisht aty ku nisin rrugët e gurit, që shpesh lëshojnë një të bardhë, të shndritshme si të bekuar prej Zotit. Baza e ndërtimit në qytet është hipotenuza e drejtkëndëshit dhe asnjë shtëpi nuk i bën dot hije tjetrës. Dhe as i zë dot diellin. Kjo mjeshtëri nisi qysh kur u vu guri fillestar, gati dy mijë e pesëqind vjet më parë. Njerëzit e këtij qyteti ndërtuan në thepisje, në pjerrësi marramendëse të greminës, honit, lartësive pakuptim, në rrëpirat shtufore më poshtë sa mezi mbajnë këmbët pa u rrokullisur në përrenj. Thuhej se çdo shtëpi fshilte brenda vetes një mit, një ngjarje, një krim, një incest a kinse, gojëdhënë, mbytje në pus, tradhti që mbahej mbërthyer me një mijë gozhdë për të mos u shqepur. Nganjëherë njeriut i hipën zekthi dhe përpiqet të gërmojë në thellësi, ashtu siç hiqet suvaja, copa-copa, për të nxjerrë shtresën e mirëfilltë të murit. Atje te guri, në thellësi kërkon të mësojë të vërtetën, të fshehtë, por e ka të

¹ Stera e ujit.

pamundur. Rrallëherë gjen një vend si ky, ku drita është kaq e shndritshme dhe depërtuese po aq e fuqishme e shpuese sa hija, trishtuese dhe melankolike. Thuhej gjithashtu se natën nëpër qytet dalin fantazma e lugetër, por që Nelson Andrea asnjë syresh nuk kishte takuar, përveçse erës, uturimës, një shakullime të potershme që sikur vinte nga përposh, nga thellësitë e honeve a puseve. Shakullima vinte e mbytur, si dënesje, sepse pengohej nga pemët e bashtinës. Në erë pemët rrinë pranë e pranë dhe afrojnë krahët. Sikur duan të mbrohen. Në erë pemët kërkojnë mes tyre ngrohtësi. Nelson Andrea që s'kish ngrohur gjumë në qepalla asaj nate, u ngrit e doli jashtë. Edhe ai u mbështet pas pemës.

“Më mbroni o pemë që të mos ma marrin të gjithë shpirtin!” - djaloshi që u lut kishte mbërthyer me dy krahët e tij çerçemin e lartë, në majë të të cilit, fërshëllima e ajrit që fshikullonte butë-butë gjethet, ngjante se dilte prej rënkimeve të tij. Pak orë më parë ai kishte humbur një copëz shpirti. Rako Sirani e kishte ftuar për darkë. Në shtëpi të tij. E shoqja, shkurrja siç e kishte skicuar mendja e tij atë grua hollake, shufër thane, hije, me flokë gështenjë gjithë drudha, të pakrehur, kishte gatuar e vënë mbi tavolinë japrakë, qofte, supë barishtore, djathë të bardhë nape, qepë të njoma e raki dhe në fund nga një kupë me gliko fiku të egër. Rako Sirani e uli përballë. Shkurrja në fund të tavolinës. Rako i mbushi vetë gotat e rakisë.

- Të pimë nipçe. Kemi festë. Mbage mend këtë darkë! - dhe syri i majtë i tij, gjallëruar e zmadhuar disi, bënte logori. Kërcente. Gëzonte. E bardha hollake midis, ajo që fshihte misteret brenda kokërdhokut rrotullohej me shpejtësi. Nelson Andreea ende s'po kuptonte shkakun e festës dhe

çakërdisjes së Rakos, që kthente gotat njëra pas tjetrës. Do ta kujtonte atë darkë kohë më pas, kur iu desh të shkonte në fshatin e atit të tij e të ngrinte nga varri dëshmitarin e një krimi të përbindshëm.

- Tani ti je yni o nipçe! - gota e radhës u kthye me fund.

Duke ndjekur kokërdhokun e majtë të Rakos që gati po i dilte vendit, ai pati dëshirën të zbulonte të fshehtën që ndrynte. Dëshira lidhej me siguri me tundimin e maskimit të një hileje. Gjithnjë pas një mirësie a përkëdheljeje fshihej një humbje, humbje e identitetit të tij. Në fund të fundit, te çdo hile apo grackë e ngritur është gjithmonë ajo pjesë e historisë që shprehet me fjalët: Të marrësh atë që dëshiron. Të marrësh atë që dëshiron, të ngadhënjesh, është në njëfarë mënyre dhe fundi i një të fshehte, qoftë dhe e gënjeshtërt. Pas saj vjen miratimi ose qortimi.

Rako Sirani nxori gjithë përkujdesje nga xhepi i brendshëm i xhakëtës gjysmushtarake një gjë të vogël, të kuqërremtë, mbështjellë me letër të bardhë. E ngriti lart si trofe dhe buluriti me zërin prej basi: - Ta gëzosh pasaportën e re o nipçe! Nelo Andrea, me fotografi, ditëlindje, vendbanim e numër rendor në regjistrin e shtetasve shqiptarë. Merre, gëzohu dhe ti me pasaportën e re, Nelo Andrea!

- Po unë jam Nelson Andrea, shtetas amerikan!
- gojëtharë, duke luftuar me mendimet e veta, duke lexuar veten para se ta lexonte Rakoja, ai s'e fshehu dot turbullimin. Dhe tërbimin. Frika e bën ujkun më të madh se ç'është. U ngrit në këmbë, erdhi rrotull dhomës dhe ndali në dritare. E hapi. Zgjati kokën jashtë. Në qiell iu drejtua Zotit që sikur përgjonte pas një reje të ngjeshur: "Dua të rrëfhem! Gjithmonë prita e kërkova mëshirë për diçka që

se kam kryer. Por mjaft më!'. Zgjati dhe krahët përjashta si të prekte me duar vëmendjen e tij. "Mjaft më! Vetë e lejova Rako Siranin të bënte diçka të keqe, të më merrte jetën, emrin, identitetin. Të më bënte kaq pis. Me të zezë. Me të zezën e tij. Një ditë do t'i paguajë të gjitha!", - dhe u dënes, sepse besonte që krahas çlirimit do të ndodhte pak a shumë diçka e ngjashme: pushtimi i xhelatit prej frymës së viktimës.

Rako Sirani rrëkëlleu gotën tjetër pa ia hequr sytë. Kërkoj të hetonte nëse në turbullimin e tij kishte prapamendim, domethënë adhurim të fshehtë për nderin e bërë apo mëri të mbuluar? Kur u bind se nuk kishte asgjë të tillë, fytyra e veçanërisht syri i majtë iu ndriçua si për festë. Ai është i regjur me vaj e uthull, shtinjak, me pushtet të fshehtë, akrobat i fjalës dhe veprimit, njëkohësisht e, si të mos mjaftonte kjo, është nëpunës e spiun i shtetit, i martuar e pa familje, pa fëmijë, ose, më saktë, as ashtu e as kështu.

- Eja, ulu këtu afër meje. Merre gotën, - sytë e tij ishin zbutur si tokë e shkrifët, pas një shiu të shtruar. - Gjirokastra, ngado që ta shikosh është goxha qytet. Do ta shohësh dhe vetë. Nuk e beson? - gjuha rrotullohej në shkumë epileptike me një krekosje të pafre.

- E besoj.

- Besomë mua. Sot kapërcyem pengesën e parë. Më të vështirën, pasaportën. Tani kemi dhe dy të tjera, një shtëpi dhe një punë për ty.

- Po violinën kur do ta marr? - si një i verbër që thur rrjetën pa pushim, vështrimi i tij lutës deshi një premtim: - Se në fund të fundit njeriu nuk lind për të mbetur vetëm dhe çdo rrëmbim dreqi ta marrë e ka një shpagim.

- Avash, avash nuk bëhet muri i shtëpisë në një ditë. Do kohën e tij.

- Domethënë unë qenkam Nelo Andrea...? Kështu?

- Ohu... në një vrimë ky! Po ç'ke o derëbardhë? Nelson apo Nelo e njëjta gjë është. E njëjta rrënjë. Emër shqiptar. Llagapin po e ke të njëjtë, Andrea. Llagapi është baza, shtresa tektonike që s'duhet të lëvizë, pa për të tjerat ç'i qi t'ëmën... - dhe e ktheu sërish me fund.

Kjo ishte dhe koha kur koka e tij u var poshtë, koha kur ai kinse u mund prej pijes, koha kur nis t'i rrotullohet në qepalla gjumi i rëndë, pa ëndrra, plot makthe e frikëra ndëshkimi. Kjo ishte koha kur e vërteta mbetet në duart e natës dhe kur mushkonjat e dyshimit që vinin prej jashtë, nga bashtina, nisin të palodhura festën e shpagimit. Shkurrja, që e njihte mirë të Zotin e vet, u ngrit pa u ndier, e zuri për supesh dhe e shtriu hopa në minderin prej dhogash të dhomës. Dhoma e ngrënies ishte plot me heshtje të zymtë dhe ajër të ngarkuar me armiqësi. Nga dritarja e hapur përgjysmë, hëna fanepsej mbi murin e odëjashtës si kafshëz e ngordhur.

Nata kishte thyer krahët. Ngado që ta rrotulloje shikimin përplasej në mure. Mure, mure pafund. Qyteti tretej heshtur. I akullt. Asnjë tingull muzikor. Qytet ku nuk dëgjohen të qeshura. Qytet me njerëz që në vend të faqes kanë një pllakëz guri të lëmuar. Po të doni ejani këtu dhe shikojini këta njerëz. Erërat që fryjnë nga disa qafa kreshtash e trazojnë trishtimin, por nuk e largojnë dot. Gjithnjë është aty, sikur e pjell guri çdo ditë. Sikur të ketë lindur këtu.

Prej tij nuk shpëton dot. Të futet brenda lëkurës, në ajrin që thith e të bën azmatik. Kur hëna e plotë qëndron mbi krye të kështjellës, trishtimi i ngjan një zonje të plakur, veshur gjithë rrecka të grisura. Mbase ky është imazhi i pikëllimit a ndoshta i mërzi. Kjo natë si asnjëherë tjetër solli shume mërzi. Pa fund. Po ajo zonja plakë përse sonte më ngjan me Hana Erdalin? Dhe më tha: “I gjori ti. Misteri s’është ushqim, por burim. Si mund të jem plakur unë kur jam jashtëzakonisht e babëzitur dhe dua çdo gjë nga jeta? Dua të jem grua dhe të shtrihem përnatë në shtratin martesor me burrin që dua. Të bëj dashuri sa të shqepem. Të bëhem fije-fije. E nesërmja nuk është e sigurt, por dua të kem shumë miq dhe të kem edhe vetmi, edhe privatësi, të punoj shumë dhe të shkruaj libra të mirë muzike, të udhëtoj pareshtur dhe të shijoj verën, të jem egoiste dhe aspak e urtë, të notoj në oqean dhe të fluturoj me avionë. Për të gjetur vetveten, mendoj për vetveten. E shikon? Është e vështirë të plakesh kur ke gjithçka që dëshiron. Ti e di që unë gjithmonë ia dal, por kur ngec, çmendem nga zemërimi. Po ti ç’bën aty?”.

Nelson Andrea doli jashtë. Jashtë strehës së ngushtë ku të merrej fryma. Jashtë odëjashtës. Gjete një drejtim. Që të mos pengohet nga degët e pemëve. Hapi krahët dhe u nis për fluturim. Të ikte. Në pafundësi. Si një shpend i madh, i egërsuar. U ngrit lart në qiell. Era e shtynte përpara. Kur u duk se gjithçka po shkonte siç e ëndërroi, befaz mbi të ra një rrjetë e stërmadhe telash me gjemba. Dhe e zuri. Dhe e nduku osh. Zvarrë. Pa mëdyshje. Pa mëshirë. Deri në oborr të bashtinës. Me siguri e kishin spiunuar. Ia kishin përgjuar ëndrrën. Kushedi, ndoshta Shkurra që nuk e mbyllte asnjëherë synë.

Kreu IV

Shtatori më keq se korriku e gushti pëlçiti nga një vapë torturuese që s'mbahej mend. Rako Sirani mbajti fjalën; e sistemoi në punë Nelo Andrean. Në fidanishte. Në fidanishten e qytetit, Nelo Andrea do të hapte gropa, do të mbillte pemë, do të shtronte e krasiste vreshtat, do të ngrinte këmbarë, do të spërkaste me kimikate pjeshkoret, do të pastronte kanalet kulluese e plot punë të tjera të rënda, në kodra e harca shkurrestash ku s'kishte shkelur këmbë dhe as kishte vënë dorë njeriu. Nelo Andrea nuk pipëtiu. Nuk kishte si t'i dorëzohej pafuqisë për t'ia dhënë dreqit jetën e vet. Të fajësosh një gjarpër se ka dhëmbë helmues nuk është mençuri. Në fund të fundit duhej të punonte për të siguruar bukën e gojës. Boll më në kurriz të Rako Siranit! Njeriu falsifikon monedhën, monedha falsifikon njeriun - kështu thoshte darkave kur kthehej i lodhur nga puna ati i tij, që sapo kishte nisur jetën e emigrantit në Amerikë. Rakoja, me atë zellin e duhur, të çuditshëm, e çoi vetë në ditën e parë të punës deri te zyrat, diku mbi kodrinë, pranë liqenit të Viroit. Rruga gjer aty ishte e gjatë, kalonte përfund përroit të Çetemelit, dilte në qafë të Gërhotit, kapërcente dy kodra me bimësi të djegur vape, futej nëpër disa ormane të mbushura dëng me thanë e driza, për të dalë në kokalet e majës, ku gjendej zyra e brigadier Bariut. Brigadier Bariu, burrë fjalëpakë, kontrollloi autorizimin që i zgjati Rakoja,

lëshuar nga Këshilli Popullor i qytetit, i rrahu shpatullat Nelos duke e pranuar menjëherë në brigadë.

- Ke ardhur në vend të duhur, - tha shtruar, - brigada ka njerëz të mirë. Do t'i njohësh vetë! - Nelo Andrea nuk mund ta harronte atë ditë. Rakoja u largua pas prezantimit dhe ai me Bariun zbritën poshtë, drejt liqenit. Liqeni ishte dyst prej thatësirës. Vetëm në mes gjarpëronte një vijëz e gjatë e qelbur uji ku gjithë ditën dëgjohej kori i bretkosave. Vinte një erë përçe, erë përcëllime po dhe erë kalbësirash nga ujërat e turbullta. Liqeni ishte tharë e zhuritur. Toka e tij qe bërë thela-thela. Kaluan matanë, në faqen tjetër. Në dorë i dhanë të mbante një kosore. Kur iu afruan faqes së kodrinës, Bariu e porositi: - Prit shkurrestet deri në majë. Nesër këtu do fillojmë me gropat...! Jepi!

Nelo Andrea nuk foli. Kur buburrecët rendin fort në kërkim të së vërtetës dhe fytyra e njeriut, zëri e sendet marrin ngjyrën e dheut të djegur. Ashtu dhe entuziazmi i tij. Hoqi teshat e sipërme, lidhi kanotierën si çallmë mbi krye dhe filloi të shkulë e të presë shkurrestet. Shqopa të thara, xana, ferra, trëndafila të egër që gjendshin të korkolepsur me njëri-tjetrin. Ishte i vetëm. Vetmi e plotë që i ngjante harresës. Krahët e hollë, të bardhë, krejt si dëborë, lëkundeshin gjithë mundim të manovronin kosoren. Dy fluga të mëdha uji i përcëlluan pëllëmbët. I çau me gjemb murrizi. Lodhja dhe djersa ia ngathtësuan disi mendimet e gjymtyrët. Nuk e dha veten. Kapërceu disa bokërima të thara krejt dhe nisi të pastrojë në pllajën përbri. Kur i qe afruar rrëpirës së butë me xana, rrëpirë çuditërisht më e njomësht se sipërfaqja tjetër (kushedi ku rridhnin ujërat e nëntokës), ndjeu se diçka e ëmbël, e afërt, që dridhej

si gjethe në thëllim, fëshfëriti para këmbëve të tij. Ishte zvarranik. E gjatë dhe kaq elegante. Lëvizte kokën në formë trekëndëshi, me dy sy shumë të bukur në formë vertikale, jeshilë me pikëza në mes. Mbi shpinë i dalloheshin disa pulla në formë zigzagu ngjyrë kafe të errët, si ajo e tokës, në asimetri, por që krijonin një harmoni të përkryer me rrëshqitjen. Nuk i kishte qëlluar asnjëherë të shihte një të tillë, që rrëshqiste me naze, sipas një ritmi që vetëm ajo e ndiente, si përgjumësh dhe ishte kaq lazare. Dhe ishte nepërkë pika-pika, rreth gjashtëdhjetë centimetra e gjatë, me brirët në majë të fytyrës, mbuluar me luspa shkëlqyese, ngado. Sytë e saj u ndeshën me sytë e tij dhe ajo u shtang. Qëndroi si e ngrirë. Kurse ai lumëmadhi ngase mahnitur, lektisur a në kllapi të lodhjes, mbase përhumbshtëm, nga kurioziteti a pakujdesia, sikur ta kishte goditur një curril ujë-akulli mbi krye, u ul në gjunjë, deshi ta prekte, ta merrte në duar, t'i përkëdhelte pullat e shpinës. Zgjati dorën dhe nepërka, barkfryrë (pasi ato pjellin në vjeshtë të parë) nuk e kurseu. Pickimi e përvëloi më shumë se dielli pingulthi mbi kokë dhe vapa sflitëse. Me mundim u ngrit, eci deri te një gorricë që mezi lëshonte një fill të hollë hije dhe ra përdhe. Nepërka nuk pyeti kush ishte ky njeri, ç'kërkonte në atë bokërimë të vetmuar kur Zoti i kishte dhënë jetën si detyrë, por i nguli dhëmbët. Pastaj bëri një kollotumbë të lehtë dhe rrëshqiti me shpejtësi nëpër barin e zverdhur. U zhduk. Kësisoj nuk e dimë nëse ajo pas kësaj (në betejë, e vërteta, është viktimë e parë) shkoi të pillte e qetë të vegjlit e saj, pesë apo shtatë, me gjatësi deri në dhjetë centimetra siç e kërkon zakoni i nepërkave apo ngordhi. Nelo Andrea nga ana e vet u mbështet me mundim në trung të gorricës,

ndërsa llëra e parakrahut të djathtë zuri të përhapë si rrathët në ujë një vurratë të madhe mavi. Parakrahu po i dhembte padurueshëm. Po mpihej. Vagullthi, vuri re Bariun që po vraponte me një kompas druri, metrin e famshëm, që mbante përherë me vete. Po vinte drejt tij. Sikur t'i kishte rënë zëti. E kishte kuptuar grackën e natyrës. Bariu kapi me dy duart ganxha parakrahun e tij, gjeti menjëherë vendin e pickimit, e thithi fort lëngun e mishit, gjakun që kërceu përpjetë dhe pastaj nxori një biçak, e preu kryq e tërthor vurratën mavi. Me rrip të fortë ia lidhi parakrahun, sa i hëngri fuqia. Mbi vurratën e ënjtur vuri duhan. Pasi u bind se e keqja shkoi e vate, e rrëmbeu në krahë djalin dhe zbriti rrëpirën teposhtë. Rrëngën e shpëtimit e mori me vete dielli që po kapërcente majën e malit për të ikur drejt perëndimit.

Me Nelo Andrean nuk mund të flisje për të kaluarën. Ishte kasafortë e mbyllur, me çelësin hedhur në det. E vetmja gjë e mbetur, ishte një tundje e lehtë koke dhe një pohim me gjysmë zëri. Tre shokët e rinj të brigadës, Otoja, Neri dhe Sadiku apo Dikja siç i thërrisnin shkurt, i thanë ku do të shkonin. Hipën mbi pemën e parë dhe panë të përpjetën që kishin për të ngjitur, pas të cilës besonin se dukej horizonti. - Amerikan, nisemi? - Otoja, një ish-mësues fizike që e kishin sjellë në fidanishte për riedukim, i shkeli syrin dhe nuk priti atë okej-in e zbehtë e të zbrazët. Pasi kapërcyen një rrip të gjerë përplot gurë e zall, shtegu nisi të hollohej, si udhë milingonash që bënte përpjetë pa dredha, si të shkonte drejt qiellit. Befas humbiste për t'u

rishfaqur pak më tutje, nën një qiell që i kishte ulur retë gati mbi kokën e tyre. Qiell i përhimë, gjysmë i nxirë me re të heshtura, të shterpëta. Nuk ishte stinë gjethesh. Ishte kohë e bardhë dhe e thatë. Kohë koprrace. Gjithë pluhur e rrapëllimë. Kohë gjembash të shkrumbosur, të egër. Ankth e frikë. Në nisje, brigadier Bariu, kishte thënë: - Kujdes. Jeni në teh të briskut! - Ç'donte të thoshte me këtë: teh të briskut? Otoja do t'ia gjente me siguri kuptimin në mbarim të ditës. Ky nuk ishte thjesht një paralajmërim! Otoja, ishte nja dyzet vjeç, i pamartuar, me flokë gjysmë të rënë, ballë gjithë vija rrudhash sikur brenda tyre fshiheshin jo kalvari i vuajtjeve, por formulat inteligjente të fizikës. Nuk e kishte kuptuar përse sytë e tij vështronin gjithnjë poshtë, dy sy jeshilë si me pikë në mes, gjysmë të rënduar sikur i dhembnin padurueshëm. Vinte i hequr, tretur në trup sa nuk e dinte ku i qëndronte shpirti, po kockën e kishte të trashë. Dhe ishte leshtak. E kishin përjashtuar nga arsimi duke i hequr dhe atij të drejtën e mësimdhënies, pasi siç flitej; qenkej i shthurur. Këngët e shkruara prej tij qarkullonin në qytet: *Këto vajzat e gjimnazit, dinlla—dinlla dada / se ç'të vjen t'ia shkrepeh gazit, dinlla - dinlla dada...* I këndonin djemtë, në rrugën e gurtë të gjimnazit në pritje të vajzave kur dilyn në pushimin e gjatë. Dhe këngë të tjera, si ajo e Marjanës, Margaritës dhe më e veçanta, ajo e Bela Katerinës. Nelo Andreas, këto këngë, ndryshe nga ato revolucionaret e radios ia kishin zënë veshët të kënduara nga djemtë nëpër sokakë, madje dhe nga fëmijë, por kurrë nuk i pat shkuar në mendje që autorin e tyre, Oton, do ta kishte shok brigade në fidanishte. Në fidanishte çonin për të punuar ose djem që ishin tapë-topi në mësim dhe e bënë një klasë për

tre a katër vite, ose persona me pullë, me shenjë. Këta të fundit ishin si të thuash ata që jetonin e punonin me lejë të posaçme e sigurisht që ishin njëzet e katër orë në ditë në përgjim, nën gypin e mikroskopit vigjilent. Ama Otoja nuk dukej njeri i lig. I mendoj gjithë këto, teksa ngjitej zvarrë-zvarrë për në majë të kodrinës, me këmbët e ngatërruara, të prera nga dobësia. Do të vazhdonin të ngjiteshin deri lart, për të nisur aty shtrimin e tubave të ujit dhe pastaj do të zbrisnin në anën tjetër të kodrës. E gjithë gjatësia ishte nja dy kilometra. Për të kaluar tubat e ujit do t'u duhej të hapnin kanal. Ujin do ta merrnin me motopompë nga lumi për ta çuar pastaj në krahun matanë kodrës. Kur më në fund mbërritën në majë, prej aty dukej gjithë gjatësia e lumit. Gjarpër i stërmadh. Lumi në atë pjesë ishte i gjerë dhe i thellë, sikur ishte mbledhur kutullaç dhe nuk kishte asnjë shkëmb përpara që t'i zinte rrugën. Rrëshqiste në shtratin e vet si në vaj të llurbët e të ndyrë. Herë-herë vorbullat e saj gëlltiste degët e thara që këputeshin e s'kishin kohë të ankoheshin. - Tani merr veglën e varrit, - i bëri shenjë Otoja. - Në fund të fundit ti i vdekur se i vdekur je! Dhe bjeri. Gërmim. Ti Diku sot je me Nerin. Zbrisni deri tek ajo gorrica dhe vazhdoni nga aty e poshtë. - Nelo Andrea që s'kishte folur asnjë fjalë, nduku osh kazmën duke bërë një vijë drejtimi në tokën e tharë, eshkë prej thatësisë së tejzgatur. Koka i rrihte shkulma gjaku. Kishte rreth dy muaj që kishte nisur punën në fidanishte dhe ndihej i rraskapitur. I mbaruar. Trupi dhembte e digjte përditë. Mendoj se këto ishin vërtet grahamat e zvergura të vdekjes që po vinte ngadalë. Pa u nxituar. Përmes kazmës, kësaj vegle që Otoja e quante vegla e varrit. Gishtat e duarve ishin trashur e bërë

kollopaqe. Të çara, me vija të pista. Me thonj të paprerë e të palarë. - Si mund ta prek me këta gishtërinj një tel violine? Harku me siguri do të më ngjajë me një degëz të tharë, shkarpë. Do të ulërinte a nuk e di ç'do të bënte, sapo ta prekja! - Hoqi rrobat e trupit, rrëmbeu kazmën dhe nisi të godiste fort tokën. Sikur i binte mu në nyjë fatit të tij që e kishte zënë me gurë dhe nuk jepte asnjë shenjë pendimi.

Qyteti u zgjua në festë. Ose ndoshta kështu iu duk Nelo Andreas ngase ca sazexhinj që s'dihej nga kishin ardhur u binin pa pushim veglave muzikore. Klarinetë, fizarmonikë dhe def, def që kërcente e hidhej përpjetë. Ai dridhej dhe rrotullohej në shtrat prej tingujve të çakorduar, atyre tingujve që binin si me dhunë në veshët e njeriut nga fillimi deri në fund, pa asnjë ndryshim, pa asnjë ndalesë. Ishte e panatyrshme mënyra se si luanin. Ngjante se ishin nën një nxitje e shfryrje shtazarake, të çuditshme, të panatyrshme, për ta dërguar zhurmën e tyre (për muzikë as që bëhej fjalë), nga kreu në fund, edhe pse ishte dukshëm blasfemi, në timpanet e qytetarëve mjeranë. Me siguri te sazexhinjtë ka elemente transi, ngushëlloi hakmarrjen profesionale dhe u kthye në krahun tjetër të shtrojës duke i mbyllur sytë fort. Ishte e diel dhe dëshironte të flinte. Nuk donte t'ia dinte për asgjë. Ndihej i lodhur. Shumë histori të trishta kishte provuar mbi kurriz muajt e fundit, histori që do të deshte të mos i kujtonte më, jo t'i përjetonte sërish. Madje nëse jeta ishte një tren ekspres që ikën me shpejtësi marramendëse, do të deshte ta ndalte atë. Ose ta kthente pas, në kohën e

shkuar. Në këtë vend që i kishte ofruar vetëm poshtërim e vuajtje pa fund, ishte i detyruar çdo ditë nga një nevojë mizore të përshëndeste njerëz që i përbuzte, t'iu buzëqeshte disa të tjerëve që as i kishte njohur më parë, të binte në ujdin me poshtërsi të vockla, të fëlliqura, t'i ndynte duart e t'i ndihte persekutorët me monedhën e tyre. Tinëzisht, pa e përfillur aspak, po e mësonin të shihte se si bëhej e keqja, të fillonte ta miratonte atë dhe në fund të niste ta bënte vetë një gjë të tillë. Me kalimin e kohës shpirti, njollosur pareshtur nga lëshime të dallavere të turpshme, të vazhdueshme, zbruhej, zvetënohej, susta e mendimeve fisnike ndryshkej, menteshat e banalitetit haheshin nga përdorimi dhe vërtiteshin kuturu, vetvetiu. Kështu, karakteri dalëngadalë nis të lëshohet, squlet, dobësohet, talenti bastardohet dhe besimi në veprën e mirë, të bukur, humb, tretet, e rrëmben rrjedha e erës së shtrëngatës. Herët a vonë ndërgjegjja e tij do ta paralajmëronte për fillimin e veprave të ulëta, të këqija. Dridhej si purtekë brenda shtrojave, rrotullohej e ikte, shmangte eshtrat e holluara prej frikës se po ia ngjyenin me kripë turpërimet e skuqura e mavijosura të muajve të fundit. Ato digjnin, përcëllonin padurueshëm. Zhurma e sazeve godiste pa mëshirë. Por ai nuk mund t'iu ikte. O Zot! Ki mëshirë! Është e diel. Pushim. Pushimmm...! Si të mos mjaftonte tortura e zhurmës në timpan të veshëve, derën e llamarintë të odëjashtës e shtyu ajo, Shkurra.

- Ngrihu! - nuk e kuptoi në ishte zë njeriu a fantazme. - Vishu e ngjitu lart. Të pret ai.

Dhe iku si hije.

Nelo Andrea u pre. Pëshpërma e saj, si pëshpërimë gjarpri e bëri të rrëqethej. U fik edhe më. Shtrëngoi grushtet

dhe i rraskapitur gëlltiti ulërimën. Sikur gëlltiti një kafshëz të gjorë. Mbase gëlltiti pafuqinë e tij ose fatin e mbrapshtë që mirëbërësin, atë të cilin deri atë kohë e nderonte disi, befasi kishte zbuluar që s'ishte gjë tjetër veç një mashtrues. Thjesht manipulues. Asaj kohe, ai s'kishte si ta kuptonte ndjellën e veprën se si shoqëria ndonjëherë ngrinte në pedestal e buste kriminelët dhe për pasojë panteoni kutërbonte i gjithi nga kufomat e vrasësve. Ç'duhej të bënte? Nuk do të ngrihem, i premtoi vetes, dhe u kthye në anën tjetër. Deshi të sillte ndër mend kujtime nga kohë e shkuar, por nuk ia doli dot. U përpoq sa s'ka, por përsëri nuk mundi. Herë pas here robërohej ta bënte këtë gjë, por jo gjithnjë ia dilte. Të jetuarit me të shkuarën, me kujtimet, e shikonte si mburojë, mbrojtje nga e tashmja. Shpesh stërsillte ndër mend episode, ngjarje, e sërish ngatërrohej. Ngecte. Diçka e pakuptueshme pengonte. Ndërpiste. Futej midis dhe bënte zhurmë. Nuk e kuptoi se sa kohë qëndroi ashtu në prehje vlimi, kur dera u hap sërish. Kësaj here e shtyra ishte e fortë, kërcënuese.

- Aha, e teprove, - tingulli që lëshoi Rako Sirani ishte në të njëjtën notë me zhurmën e sazeve. - Sot e gjete gjumin?

- Sot, - këmbëngulja ndihej e prerë në timbër. - E diel apo jo?

- Sot në ditë feste? - zemërimi u ngjiti sipër dhe përflaku fytyrën, qafën e hollë dhe buzët u drodhën.

- Sot! - sytë e tij u kthyen për të parë ç'kishte pësuar ajo vijëz e hollë, e bardhë në kokërdhokun e majtë të Rako Siranit.

- Mos e tepro nipçe! - nota e tingullit të Rako Siranit zbriti një oktavë më poshtë se ajo e sazexhinjve që tani

i binin fort e tendosur veglave, sikur të ishin tërbuar nga kundërshtimi i këtij të panjohuri. - Nuk e shikon se qyteti është në këmbë, në festë? Vetëm ne mbetëm mbyllur brenda. Do të turpërohemi ne? - pas kësaj pyetjeje, hija e misterit u rrit.

Nelo Andrea deshi të qeshte. Të qeshte me të madhe. Të tallej. Por u përmbodh. E mbajti veten. Ngazëllues, por dhe dyshues, atë çast, sepse besoi vërtet që Rako Sirani ishte i dobët, plot pika të errëta, i thyeshëm. “Nëse beson që është i thyeshëm atëherë ç’pret, hidhe hapin e parë dhe pushto frikërat e tua. Dhe kur gjërat shkojnë keq e më keq dhe duken se po shemben, kur asnjëri nuk beson te ti, kur ndihesh i vetëm dhe i lënë në baltë, beso ti i pari që ky është pikërisht ai momenti për t’iu betuar vetes sate. Se jeta është e shkurtër dhe asnjëherë s’të jep kohën e duhur për korrigjim. S’ke kohë të bësh asgjë. As edhe të mbledhësh dy-tri ditë bashkë për të marrë vesh diçka. Ngrihesh, ha mëngjesin, ikën kilometra të tërë, punon me kazmë e lopatë, ha drekë e darkë bashkë, fle si i vdekur, dhe nuk ke as edhe një grimë kohë për të luajtur me mendje një sonatë dhe as për të lexuar Senekën që të kuptosh se gjithçka e ka një zgjidhje në këtë botë.” Psherëtiu rëndshëm. Me holasje. Një gropë e thellë iu hap në kraharror. Brenda saj mund të strehoheshin hamendje të pafundme. Rako Sirani nuk duroi më. Pas vonesës së gjatë, më shumë fshehtas se haptas Nelo Andrea po e sfidonte. Nuk po ngrihej.

- E po çohu de! - as urdhër dhe as kërcënim, por më shumë si një vajtim që dëneste nga ajo fytyrë burri vjetran dhe që një sekondë më pas, sikur u thërrmua në qindra copëza lutjesh. Kureshtja për të mësuar ca më tepër, përzier me të

vërtetën e rrezikshme, pa e ditur se po i dhuronte vetes atë që nuk do të donte, e detyroi Nelo Andrean të kthehej nga Rako Sirani. Ky i fundit e ndjeu përnjëherë që erdhi çast i tij: - Çohu se sot është festë. Ditë votimesh. Nuk i dëgjon orkestrat? Voton i gjithë populli. I madh e i vogël. Kupton apo jo? - duke mënuar rrëmbyeshëm që entuziazmin e vet t'ia kallte nëpër trup edhe Nelo Andreas.

- Ç'punë kam unë me zgjedhjet këtu? - dyshoi në njehsim të kujdesshëm. - Jam shtetas amerikan.

- Ç'thua more? Mos ma bëj këtë! - ishte gati të shpërthente. Nuk e bëri. Mashtruesit kanë gjithnjë dredhitë e tyre. U hesht. U mëdysh për të vijuar me lutje: - Mos ma bëj këtë mor bir! Mungesa në votime është turpërim shumë herë më i madh se çdo mallkim. - Kokërdhoku i majtë u përlot ca më tepër se i djathti. Atë çast, torturues dhe rrënues në rebelim, e kuptoi që mospjesëmarrja do të mjaftonte për të shtuar edhe më tymnajën rreth tij. Fjalët disakuptimëshe që hidheshin kinse kur kalonte në sokakun e lagjes i kishte dëgjuar dhe ato do të vërtetoheshin nëse ai do ta çonte gjer në fund rebelimin. I dha të drejtë Rako Siranit. U ngrit. U vesh përtueshëm, heshtur, mëdyshës dhe doli pas tij. E dinte mirë ku shkonte. Do të ishte dëshmues i dashurisë për pushtetin popullor. Rako ecte serbes në rrugën që të shpinte drejt qendrës së votimit. Ajo ndodhej në katin e parë të shkollës ushtrimore, një klasë e së cilës paradite përdorej për mësim, pasdite si zyrë e këshillit popullor të lagjes. Ecnin të dy njëri pas tjetrit. I pari udhërrëfyesi, i dyti i mosduhuri. Nga vrimat a cepat e gurëve të rrugës dëgjoheshin mërmërimat: "Kapardiset dhe ky pale... Me amerikanin në krah... Po s'thotë kot populli uji fle, hasmi

s'fle... Prit pa do t'ia dëgjosh krismën... Pika që s'i bie. I çoi dëm shërbimet e partisë...".

Kur mbërritën në qendër, njeri nga anëtarët e komisionit u ngrit në këmbë dhe nderoi me grusht Rako Siranin: - Si përherë në ballë shoku Rako!

Hyri brenda, ndërkohë që atë çast, dielli dyshues e mospërfillës sapo e nxori kokën mbi kreshtën e malit. Diellin e kishin nga mbrapa. Një diell i sapolindur, pothuajse i ftohtë, i shpërfytyruar nga pluhuri që ngrinte era.

- I pari dhe sot shoku Rako, - ky nderim, sido që ta merrje, si përfitim pushteti, interes, sfidë a blasfemi e preku dhe njëherësh e vuri në mendime Nelo Andrean. Kush ishte, në të vërtetë, ky mirëbërësi i tij Rako Sirani? Me siguri që nuk është një nëpunës i thjeshtë i administratës së shtetit komunist.

- Vota jonë plumb për armikun. Të rrojë Partia. Të rrojë pushteti i popullit! - pas kësaj ngrohtësie shtirake, lëngëre¹ që të sillte të vjellën në grykë, një tjetër anëtar i komisionit u ngrit dhe i afroi një fletore - listë me emra, duke i treguar me shenjë: - Firmosni këtu. - Rako Sirani firmosi. Pas tij të njëjtën gjë bënë dhe me Nelo Andrean. I treguan ku duhej të firmoste. Firmosi dhe ai. Po a ishin firmat e tyre formë e të njëjtit thelb? Kjo mund të jetë zhgënjyese nëse gërvishtim lëvoren e sipërfaqes. Nga pamja duket sikur janë të ngjashëm. Kurse poshtë lëkurës, skuta e trurit, ngreha e kockave, gropat e syve, dhëmbët, ndonëse janë tmerrësisht të njëtrajtshme, prodhojnë ide dhe energji diametralisht të

Lëng urthi përvëlues në stomak - dialektore.

kundërt nga njëri-tjetri. Krenar për triumfin, Rako Sirani e mori për dore Nelo Andrean dhe të dy dolën jashtë. I pari fitues, i dyti humbës, ata kapërcyen krahun e rrugës dhe dolën në sheshin e madh. Zhurma e sazeve në shesh ishte shurdhuese e ngjante kaq fort si britmë vdekjeje. Rako Sirani e mori në kraharror nipçen dhe qeshi. Qeshi me të madhe. Pastaj ishte radha e Nelo Andreas të qeshte.

Ç'njeri i çuditshëm ishte ky Otoja? Ishte mbret i gjallesave të tokës. Ndryshe prej Nelo Andreas, një amerikan i shkolluar më së miri në arte, ende i pashfaqur, ndryshe dhe nga Neri Sollomoni, hebreu që pyeste për çdo gjë, pasi kishte frikë mos gabonte, Otoja ishte i mirëinformuar dhe praktik. Akoma më ndryshe ishte nga Sadik Matrënga, pjesëtari tjetër i brigadës që ishte lab, nga malësitë e Kurveleshit dhe që Otoja thoshte gjithnjë duke qeshur: ka mospërputhje midis emrit dhe mbiemrit. Ashtu si brigada jonë, ishte dhe qyteti. Turli. Kozmopolit. Në qytet kishte banorë vendas, por dhe hebrenj, arumunë, evgjitë, turq, grekë, romë, italianë madje dhe serbë e malazezë e deri kanadezë e australianë. Mbahej me të madh në Pazar një hamall që e thërrisnin Vojusha, Vojusha Antiç një kroatoserb që ishte si shkëmb. Ai ngrinte më tepër se gjithë hamejtë e tjerë të pazarit. Vojushën se shkulte dot njeri nga garat e tërheqjes së litarit dhe s'kishte burrë në botë ta hidhte në shesh në kampionat të mundjes. Askush nuk e dinte me se ushqehet ai njeri dhe ku e mbante të fshehur të gjithë atë fuqi, gati biblike. Në qytet flitej edhe për një kirurg serb,

doktor Dragonin, duartartin që kryente fshehtas operacione gjinekologjike, sidomos në disa shtëpi që njerëzit i shihnin me dyshim të madh. Flitej dhe për Papu Aristotelin që kishte sjellë në Shqipëri një vapor me grurë që nga Australia e largët. Për Janollarët që kishin ndërtuar kasaforta guri brenda, në thellësi të puseve për të fshehur florinj të e xhevahiret e shpëtuara nga vala e tretë e sekuestrimit të pasurisë e shtetëzimeve. Flitej për Zite Kovaçin e bëhej be e rrufe që flinte mbi kallëpe floriri. Kallëpet ishin shtruar poshtë dyshemesë së odasë. Pandehmat shkonin deri aty sa kishin plasur krushqitë e martesat brenda fiseve për të mos e shpërndarë e dorëzuar pasurinë. Ç' nuk flitej në këtë qytet thashethemesh? Të shkretët veshë ç' dëgjonin! Hebreu Ziga, dyshues e frikacak si përherë i kishte fshehur florinj të e tregtisë larg, në një guvë - shpellë të nëndheshme që se dinte askush, në Mal të Gjerë. Një tjetër i moshuar me emrin Thanas, vllah, ruante hartat e zonës ku mendohej se kishte naftë. I ruante si tapitë e vjetra të turkut që t'i linte trashëgim në breza. Për Kopen, një Prokop, Prokop nga Palortoja e Sipërme, thuhej se na qenkësh nipi i Vangjel Zhapës dhe do të trashëgonte pasurinë e gjithë Greqisë. Të vije duart në kokë! Por t'i besojë të gjitha këto me siguri që duhej të ishte i çmendur. Pavarësisht nga shkullnaja e mendjes, një gjë shndriste si drita e diellit në këtë qytet: qetësia. Qetësia që vinte nga pranimi. Nga dimensionin i pranimit të gjithçkaje që sillte tjetri me vete, i kulturës së tjetrit. Askush nuk të thoshte: Plaç! Qyteti ishte si të thuash ai kazani i stërmadh që përziente gjithçka. E përziente, e treste dhe e bënte ushqim për çdo stomak. Dhe në qytet nuk kishte sherre ndasish, as urrejtje. Vrasje jo e jo. Por le

t'i lëmë këto shpjegime të mërzitshme dhe të rikthehemi te njeriu i çuditshëm Oto. Oto Gajdari. Otoja jetonte i vetëm në një shtëpi të stërmadhe përfund Varoshit. Nëna, personi i fundit që mbahej mend nga ajo shtëpi me oxhak të madh kishte vdekur tre vjet më parë. Otoja ishte nga të rrallët në qytet që kishte një biçikletë. Askush nuk e dinte ku e kishte gjetur. Zëra të fshehtë thoshin se biçikleta ishte e një karabinieri që nga koha e pushtimit të Italisë. Karabinieri thuajse nuk e kishte përdorur fare. Ku ta përdorte i ziu? Në rrëpirat e sokakët e Gjirokastrës? Karabinieri ia kishte bërë dhuratë Otos, kushedi për ç'shkak. Ca thoshin se e ëma e tij gatuante për italianin, ca të tjerë se ishte fëmija i vogël Oto që i çonte bretkosa e kërmij, atje në garnizonin ushtarak në Gërhot. Hajde merre vesh. Histori lufte. Askush nuk e kishte pyetur Oton për biçikletën dhe vetë ai nuk jepte asnjë shpjegim. Ata që nuk e njihnin e thërrisnin shkurt: Oto biçikleta. Në skarën e biçikletës Otoja mbante gjithnjë shportën prej thuprash shelgu me kapak, të mbuluar me një beze. Me biçikletë vinte edhe në fidanishte. Thamë në fillim që Otoja ishte mbret i tokës. Njihte si askush tjetër të gjitha gjallesat, emër për emër, insektet, fluturat, zhapinj të, gaforret, kërmijtë, gjarpërinjtë, bretkosat, të gjitha ç'shihte syri i njeriut. Dinte dhjetëra histori me gjallesat. Otoja mbante nëpër xhepat e teshave dhe veglat e duhura, tela, pinca, gërshtë të vogël, litar mëndafshi, trasta, copa leshi. Otoja ushqehet me gjallesat e tokës. Një ditë prej ditësh, kur Nelo Andrea iu bashkua brigadës së tij në fidanishte, Otoja pikasi një gjarpër të madh. Ishte mbledhur kutullaç. Sa një tepsi e madhe. Ishte me pika të kuqe e të zeza përsipër e bus i bardhë në bark.

- Mos! Mos e vra gjarprin se ndjell ters - i bërtiti Dikja.
- Të këput shikimin, more! Të lë pa sy!

Otoja nuk e dëgjoi. Iu afrua gjarprit laragan dhe e përgjoi. E përgjoi. Sa nxori kokën nga një e çarë guri, hop, ia kapi me pëllëmbën e dorës, si darë. Me shpejtësi të habitshme nxori pincën nga xhepi me dorën tjetër dhe ia shkuli dhëmbin. Dhëmbin e ngulur në bodrumin e helmit. Trupi i gjarprit, vazhdalëbyrës u përdrodh nën lëkurën e hollë sikur ta kishte zënë korrenti. Oto e ç'mitizoi. E ngriti lart gjarprin si trofe, e rrotulloi në trup dhe më pas e uli në tokë. Ishte nja një metër e gjysmë. Pastaj e ribëri kutullaç, e lidhi me spango dhe e futi në koshin prej thupre mbi skarë të biçikletës.

- Ja dhe darka e sotme, - thirri triumfator.

- I pashpirt, - iu hakërrye Dikja me zemërimin e fjalës që i shkoi bosh.

- Zotëri, - Otoja e përdorte shpesh në brigadë këtë fjalë, - nuk më mësove të bëja bejte fshati nga ato që dije vetë. Me bejte do të kisha përfituar diçka. Do të zbavitja njerëzit. E mban mend ç'më the kur ta kërkova këtë gjë? Ik, ik kap zhapinj, bretkosa, gaforre e gjarpërinj. Shiti e ushqehu. Ashtu bëra dhe unë në fillim. Po nuk i donte askush. Le që ku ka para? Kush i blen? Kush e nxjerr paranë nga sepetet? Leku ka rrjedhur si uji. Kështu që u detyrova të ushqehem vetë. E di ti që kam tri ditë që ha lakra të ziera? Më është bërë barku lëngëre! Ndërsa sot do të gatuj gjarprin.

Ky ishte Otoja që atë paradite pas një shiu të rrëmbyer e thirri Nelo Andrean për t'i treguar një nga zejet e tij të preferuara, mbledhjen e kërmijve.

- Është tamam koha, pas këtij shiu të rrëmbyer behari. Shi shejtani, - u zgërdhi dhe i nguli sytë në ferra e bimësi,

në gjethe-gjërat, ku lëpjetat e barërat për anash trungut të rrapit me siguri fshihnin thesarin që kërkonte.

Neloja i shkoi pas. Otoja dinte ku t'i gjente butakët e shijshëm, siç i thërriste me përkëdheli. Ikën larg, matanë liqenit, në vendin që e thërrisnin pellgu i luleshtrydheve. Ishte një lirishtë me shumë lagështirë, tokë e shkrifët si kadife, përplot lule e ferra të buta që qarkonin pemë e bimësi që vinte deri mbi gju. Aty gjendeshin me dhjetëra kërmij poshtë gjetheve të trasha e të rënda. Ajo kafshëz e vogël, me trup të butë, pa skelet, e përjargur, që zakonisht mbulohet me një guaskë në trajtë spiraleje dhe me dy palë brirthe përpara, që ushqehet vetëm me vesë bari, priste e trishtuar dorën e stërvitur të Otos për ta gjetur. Zakonisht këta ishin kërmij të zhveshur (lakuriq) kërmij pa guaskë, jargësa. Të tjerët kishin guaskë në formë spirale që në disa raste ishte konike. Spiralizimi mbështillet rreth një boshti që quhet kolumelë. Otoja i mblidhte si gjahtar race, me pasionin e një paranojaku. E shtrinte krahun e gjatë deri në fund, i sigurt se mollëzat e gishtërinjve do të preknin jargët e trupin e butë të kërmillit.

- Preki një çikë me duar! E shikoj që të vjen anicirë, por kur të lahen, të ziejnë në kusi në temperaturë të lartë, trupi i tyre del këlltup dhe bëhet gati për tigan. Të skuqura me erëza, piper e pak lëng limoni ato janë ushqimi më i shijshëm që provon njeriu në jetë. Ama të betohem se po e provove njëherë, nuk ke për t'iu ndarë kurrë kërmijve. Prandaj më mirë fillo që tani me gjetjen e grumbullimin e tyre. E kam provuar vetë.

Nelo Andrea nuk kundërshtonte, veç nuk kuptonte përse një mësues fizike, që më mirë mund të ishte mësues

biologjije e botanike, me pasionin dhe energjinë e Otos duhej të shpallej i padëshiruar, i mosduhur, i penguar, i papërshtatshëm, i përjashtuar për të dhënë mësim? Ç'faj kishte bërë Otoja? Si dreqin funksionon ky shtet? Kishte ardhur rastësisht në këtë vend, djalosh ëndërrimtar dhe përnjëherë brenda katër vitesh, po shndërrohej në plakush, po thinjej e tretej nga dëshpërimi e marazi. Kishin mbledhur një trastë plot me kërmij kur shiu ia behu sërish. Në fillim me pika të mëdha. Aq të mëdha e të rënda sa dukej sikur ato, pikat e shiut, bënin vrima në tokë. Pastaj pikat sikur u pjesëtuan. Shi i shtruar. Në fillim Otoja, më pas Neloja, ia mbathën vrapit. Në strehë të një rrapi degëgjërë.

- Eja nga unë në darkë, - hetoi me sytë e jeshiltë. - E ndiej se do t'i shijosh pa masë. Kam dhe një shishe verë. Kështu tha dhe priti që të merrte një përgjigje të shpejtë. Por Otoja nuk e dinte që Neloja nuk lëvizte askund pa lejen e Rakos. Rakoja e kishte nxjerrë nga burgu. Rakoja e mbikëqyrte. Nga burgu i dënimit të tmerrshëm, ndonëse të pakuptueshëm, që mund të zgjaste me vite. E kishte marrë me vete në qytetin ku jetonte. E kishte prezantuar si nipin e tij, duke i fshehur të kaluarën. Nuk dinte ç'përgjigje t'i kthente Otos.

- Pse nuk ike në Amerikë kur dole nga burgu? - një bubullimë shkrepiti dhe sikur e çau qiellin mes për mes.

- Çfarë? - mbeti i menduar me kokën ulur. Dëgjonte tringëllimën e hollë të pikave të shiut mbi tokë. Sa andralla e vuajtje i kishte shkaktuar ajo pyetje që ia bënte vetes përnatë.

- Të morën pasaportën dhe askush nuk e di ku ke përfunduar, ë? Ke vendosur të heshtësh? - gjënimet u

shtuan, madje tri herë rresht, a thua se Zoti po lajmëronte dikë që i kishte ardhur ora e vdekjes.

- Si?

- Po pse xhanëm paske qenë kaq i fshehtë dhe misterioz. Mund të dërgosh diku një letër në anglisht. I njofton për situatën dhe vendin ku ndodhesh. Dhe me siguri ata vijnë e të marrin! Distanca nuk i ndan njerëzit, heshtja i ndan. Fundja i drejtohemi një ambasade, - nisën vetëtimat e rrufetë pas këtyre fjalëve. - Duhet të ikësh nga ky vend!

Eshka e mosdurimit shkrepiti xixa dhe qëndrimi i mëtejshëm aty kishte rrezikun e shkrumbimit. Të dy e dinin. Nelo Andrea iku i pari. Me nxitim. Pyetjet e Otos i mbetën në mend. Ama dhe frika i hyri në palcë. Por më shumë se frika ishte diçka tjetër. Kureshtja. Ku i dinte Otoja gjithë ato gjëra? Ecte si i ndërkryer pa vështuar ku hidhte hapat. Hyri në qytet. Ngadalësoi disi ecjen për të mos ngjallur dyshime, por veshët i mbajti pipëz, mos dëgjonte t'i flisnin: "Ej Nelo Andrea, mos kujto se s'të njohim, as të kemi harruar. Identitetin tënd nuk e fsheh dot!". Heshtje. "Megjithatë qëndro dhe disa kohë në errësirë." Nuk dëgjoi asgjë të tillë. Kapërceu portën e madhe dhe hyri drejt e në odëjashtë. Shiu i rrëmbyer e kishte ndihmuar.

- Sakën!

Kjo fjalë turke ka mister dhe fuqi të çuditshme. Ngrin, stepesh sa herë e dëgjon. Nuk është një fjalë e thjeshtë. Për dreq përdoret gjerësisht. Fjalë - kod, kyç.

Sakën - fjala që fsheh një raport, një marrëdhënie ndërvaresie të fortë. Kërcënuese, paralajmëruese, parandaluese, paralizuese. Si goditje rrufeje. Sakën! Fjala ka pushtet. Kaq e shkurtër e lakonike. Është e prerë, goditëse, urdhëronjëse gjer në skaj. Zbërthimi i fjalës me pesë germa sakën! mundim i egër, skëterrë. Ku e kanë gjetur? Ngjan me një prizëm ku bien gjithë lutjet, kërkesat, dëshirat, trillet, veset, mëshira dhe të gjitha thyejnë kokën në brinjët e mprehta, të thepisura, tehe që s'falin.

- Sakën!

- Sakën!

Më i vendosur se kurrë Nelo Andrea ngjiti shkallët e gurta të patit për të hyrë pastaj në oda, vendin ku të dielave, Rako Sirani pinte kafën e mëngjesit dhe sodiste luginën që zgjatej si gjarpër deri matanë kufirit shtetëror, në Greqi. E gjeti siç e pat menduar, pikërisht aty. U ul përballë. Shkurra hyri nxitimthi, si hije, pas kurrizit të tij, me kupën e manxuranës në dorë. E gostiti dhe iku. Nuk gjente fjalë të përshkruante përulësinë neveritëse të saj dhe kjo e nervozonte keq. Sikur t'i kishte rënë përmbi gjithë pesha e fuqisë së fjalës sakën dhe t'ia kishte bërë petë personalitetin. Ishte si një leckë me të cilën mund të pastrosh orenditë e të fshish këpucët. Shtëpiake e pagojë. Memece. Një qenie e bërë si shkel e shko. Përkundër saj Rakon, Zoti nuk e kishte kursyer duke e pajisur me fuqi e dashamirësi, madje edhe me ca mend në kokë siç flitej lart e poshtë. Dhe kur ai bënte ato që donte, nuk kishe si të mos ndieje siguri, trimëroheshe kur ishe me të, sepse vetëm nga një vështrim që hidhte nuk e vije fare në dyshim forcën e tij. Kishin kaluar rreth katër vjet e pak nga njohja e tyre dhe ata të dy nuk kishin folur asnjëherë

ballë përballë, hapur, në mënyrë shteruese. I druhashin një bisede të tillë. Nuk e kishin ndarë përfundimisht si thuhet shapin nga sheqeri. Në njëfarë mënyre, biseda ballas me Rako Siranin ishte si shkuarja e cjamin të kasapi, pasi ai ia kishte thënë troç disa herë: “Shyqyr që ike e shpëtove gjallë nga ai ferr! Nga vdekja”.

Po Nelo Andrea nuk bindej. Dyshonte se Rako Sirani me këtë fjali ia kishte blerë me paratë kohën. Kohën e tij. Dhe ai e kishte kuptuar se kush jep kohën, jep lirinë e tij. Këtë gjë e kishte të qartë dhe sa herë e kujtonte, ndiente një djegie në fund të stomakut. Djegia i vinte papritur, sa herë përballej me pafuqinë për ta sqaruar situatën, absurdin ku kishte përfunduar jeta e tij. Në ato çaste nga sytë e tij buronte ankth, goja i mbushej me lëngje të hidhura që duhej t’i gëlltiste pa dashur, këmbët i rëndoheshin dhe koka i mbushej me miza zukatëse që bënin zhurmë të padurueshme. U ngjit lart, tek oda të Rakoja, sepse kishte ende shpresë. Nuk mund ta pranonte idenë se kishte humbur përfundimisht. Duhej të shpresonte ende. Diku duhej të ishte fshehur pak shpresë. Kushedi, ata (sigurimi i shtetit dhe ata të burgut) mund të ishin gabuar. Ku i dihet? Ndoshta kanë kërkuar dikë tjetër e në mosgjetje të tij, si këmbim kishin marrë atë, Nelson Andean.

- Erdha të flasim, sepse ndiej që më ke fshehur gjëra të rëndësishme. Askush deri tani nuk ma ka thënë të vërtetën. As ti. Më fol hapur dhe pas kësaj unë do të iki, do të vazhdoj të merrem me punën time.

Kështu tha Nelo Andrea përballë Rako Siranit, në odën ku dikur kishte menduar se ishte limani ku lidhej spiranca e shpëtimit.

- Mirë, Nelo. Dokumentet e tua u grisën në aeroport. U dogjën. E mësove tani të vërtetën? - foli përtueshëm Rako.

- Do të dëshiroja të dija si ndodhi kjo? Keqkuptim? Ç'punë kishin me mua? Nuk mund të gjendej një zgjidhje?

- Nuk e kuptoj si erdhe ti këtu? - gjerbi një gllënjë kafeje. - Erdhe në shtetin e gabuar. Erdhe jo si shtetas amerikan, por si klandestin, si diversant. E kupton kaq gjë?

- OK., - (e përdori për herë të parë) - ja, bëra gabim. Vuajta dënimin. Tani përse nuk më lini të iki?

- Ç'deshe që erdhe? Në fund të fundit, a e di ti që Republika Popullore e Shqipërisë nuk ka marrëdhënie diplomatike me SHBA-në?

Ai kishte ende një shpresëz. Krejt të vogël, një fije të hollë që Rakoja ende s'e shihte, ose shtirej sikur se shihte. Apo siç kishte dyshuar që në fillim: Qenkësh i verbuar qyshkur!

- Nuk ka as ambasadë dhe asnjë shkëmbim, as diplomatik, as njerëzor, - dërdëlliti Rakoja.

- A mund t'i drejtohem shtetit amerikan për këtë keqkuptim? Me një letër. Përmes një ambassade të ndonjë vendi fqinj, Itali, Greqi?

- Sakën! Sakën! - tundi kokën kërcënueshëm Rako. Kokërdhoku i syrit të majtë sikur e dyfishoi perimetrin. Dëgjonte frymëmarrjen e nxituar, në ankth, frikshëm dhe kujtoi gjithë kalvarin e nxjerrjes nga burgu të Nelos. Kishte dhënë garanci me jetën e tij. - Nuk mund t'i drejtohesh askujt. Hiqe njëherë e përgjithmonë nga mendja. Ti tani je një i humbur. Si të humburit e luftës. I humbur përjetë. I zhdukur. Një numër më pak.

- Po sikur të provonim?

- Ehu, më duket se ti bën shaka me kokën, me jetën tënde. Nuk thua shyqyr që je gjallë, që e zgjidha (nuk tha të shpëtova jetën). Do të kishe mbetur atje, në ndonjë vrimë. Atje në gropat me zift të Ballshit. E di sa janë në fund të gropave me serë? Në shenjë të kishin.

- Po përse më kishin në shënjestër, as kisha vrarë, as kisha grabitur pronë, as kisha ngritur armë kundër shtetit. Përse?

- Sepse ishe amerikan. Imperialist. Ja përse. Kupton kjo koka jote apo është bosh? Thuaj shyqyr që më kishe mua. Shyqyr një mijë herë.

- Po ç'të keqe do ta gjente shtetin shqiptar prej meje? Mos e bëj tragjedi.

- Ti prapë s'kupton. Tani je njeri i lirë more eej. Shqiptar. Je shqiptar. Me dokumente të rregullta. Do të zbatosh ligjet e shtetit. Dhe sakën se i shkel!

- Dhe...

- Je i mbrojtur. Ke punë të siguruar. Ke lindur për së dyti. A nuk je i lumtur?

- Po, Shumë.

- Ta them për herë të fundit. Këtu në këtë vend mund të jetosh shumë mirë. Të kesh familjen tënde, fëmijët e tu. Rregulli kryesor është: Mos dëgjo! Mos fol! Hesht! Mos e kapërce kurrë këtë kufi!

I erdhi për të vjellë. Lëngjet e hidhura të stomakut gati fluturuan prej hundësh.

- Mirë të gjitha, po as violinën time nuk mund ta kem?

- Sakën! Ajo të identifikon more tutkun. Atë e ruaj unë si sytë e ballit. E ke në vend të sigurt. Pa asnjë merak.

Nelo Andreas i ngjau se krejt kati i sipërm i shtëpisë u përmbys me rrapëllimë. OXHAKU, trarët, rrasat e gurit, gozhdët, gurët i ranë mbi kokë.

Ishin të rraskapitur nga lodhja kur iu thanë: - Mbledhje te brigadier Bariu në zyrat e fidanishtes. - Të gjithë e dinin, kur Bariu linte mbledhje në orën 4 të pasdites, ajo ishte kohë e dëshpërimit të madh, sherreve ose dita që pritej të mbeteshe pa punë. Ikje për të mos u kthyer më. Pa shpjegime të gjata e të holla, por kësaj here tërthori ai la të kuptohej se kishte diçka tjetër. Dita ishte e keqe, me bubullima, zëra nervozë, ecje të ngadalta, turmë si gëlim krimbash të bërë shuk nëpër baltovinë, dhe dëgjohej se si era e çonte dhe e sillte atë zhurmë, duke e trazuar e kthyer në oshtimë. Punëtorët vinin nga larg, të drobitur nga dita e punës në shi, i ftohti brisk dhe nuk mendonin gjë tjetër veç mundimit të kotë për një mbledhje të thirrur kushedi se pse nga brigadier Bariu. Ata dinin gjithashtu se brigadier Bariu nuk ishte pafilatar e mburravec i zbrazët, që pas një fitoreje të fryhej nga fuqia e të foshnjërohej nga lajkat. Vinte i thatë nga pamja, i vrenjtur, qeshte rrallë dhe fjalët sikur i nxirrte me çengel. Bariu ishte lepur nga këmbët. Gati tri orë rrugë bënte çdo ditë, në këmbë, për të ardhur e kthyer nga puna e qytetit, në fshatin e ri socialist Valare, ndërtuar me pallate në anën tjetër të lumit Drino. Ora e mbledhjes mbërriti dhe të mbledhur në barakën prej llamarine që i quanin zyra, prisnin të mësonin ç'kishte ndodhur.

- Shokë, - kroi zërin brigadier Bariu për të vijuar mendimin që kushedi kur e kishte nisur, - nuk jemi vetëm.

Kemi në krah Republikën Popullore të Kinës. Kina është me ne. Ndihma e saj do të jetë e pakursyer për popullin shqiptar. Do të na bien drithë, mekanikë bujqësore, plehra kimike, gjithëka.

- E ç'na ka Kina ne? - s'u përmbajt Dikja që megjithëse i kalbur nga budallallëku e kishte një dell burrërie që kërkonte një rast të shfaqej, - aq grurë sa hanë minjtë në hambar të një anije, aq grurë do Shqipëria. Shpëtuam! Veç atyre që tha brigadier Bariu, kam dëgjuar se Kina do të na sjellë edhe copa doku, dok more dok, dok. Dok për pantallona. E dini ju sa e madhe është Kina?

- Prisni, - mori fjalën brigadier Bariu në qortim të heshtur për Diken dhe përndau mjegullën duke hedhur gurin në gropën e qëllimit. - Në qytetin tonë do të jetë për vizitë një delegacion nga Republika Popullore e Kinës. Delegacioni mund të vijë dhe këtu. Pastaj i bëri shenjë me kokë Zyrdiut, zëvendësit të tij, që nisi të shpërndajë te të gjithë punëtorët disa stema me portretin e Mao Ce Dunit.

- Mirë është t'i vendosim në gjoks, - dhe për të turbulluar mendjen e punëtorëve shtoi: - sidomos në ditë festash. Tregojnë solidaritetin dhe vëllazërinë mes dy vendeve tona.

Otos, që e kishte stresin lëmsh të mbledhur në fyt nga koha e humbur, iu duk lajthim fati skena e stemave në gjoks, nuk duroi dot dhe shprazi: - Ky është nder i madh, po kur punojmë në krasitje t'i vendosim stemat?

Brigadier Bariu e ndjeu që rasti dhe perëndia po i ktheheshin kundër ndaj ndërhyri pa mëdyshje: - Në gjoks do t'i kemi edhe kur të qërojmë të gjitha gjembat...!

- Domethënë, - e prishi dedikatën e tij Otoja, - tani kemi aleatë edhe Valarenë dhe Kinën?

Ligështimi, fillimisht i zi, e më pas i murrmë e gri, pak nga pak u tret në fytyrën e nëpunësit ngadhënor të regjimit. Ikja nga fytyra nuk do të thoshte se ligështimi humbi. Jo, jo. Ai u zhvendos në skutën e mendjes, aty ku përgatitej hakmarrja e mëvonshme. Veç sytë, sytë me atë jeshilen e errët, si rrëqebullit, pjerrtas, u tërhoqën në thellësi.

Nuk mbetej tjetër për t'u thënë kur Dikja, që kish oreks, i doli në krah brigadier Bariut: - Më thuaj ç'di t'i për Murin e Madh Kinez që na u kapardise.

Otoja nuk ktheu përgjigje, por në vend të tij për çudinë e të gjithëve u gjallërua Neri, hebreu që ngjante kaq i pazoti për ndonjë punë serioze. - Muri i Madh kinez, - si të thoshte një informacion tronditës, - ka nisur të ndërtohet rreth 2500 vjet më parë dhe është mbi 7 mijë kilometra i gjatë. U ndërtua përreth 1800 vite.

- Ua, - shqeu sytë Dikja. Po ç'u duhej gjithë ai mur, - ngau pastaj imagjinatën e vonuar.

- Mbroheshin nga sulmet mongole, - sqaroi ngadalë Neri. - Më interesantja është që muri s'ka gurë, po si material ndërtimi ka tokë e dhé. Dhe më e çuditshmja akoma është se në përbërje të murit gjendet oriz. Shkencëtarët thonë që orizi ndihmon rezistencën e murit.

- E po ti qenke fanua - i rrahu shpatullat Nerit. Gjysma e atij murit na duhet këtu dhe na merr të keqen greku e jugosllavi, - u kapardis Dikja triumfator.

- Që ta themi gjithë të vërtetën, - shpotiti Otoja, - muri u ngrit nga të burgosurit kinezë, madje për t'i dalluar nga punëtorët e thjeshtë, iu rruanin kokat dhe i detyronin të punonin me zinxhirë.

Egërsimi i Bariut i ishte afruar kufirit të klithmës, por për një çudi të pashpjegueshme, në vend të saj, kureshtja

dhe adhurimi fëminor për njohuritë e Nerit, shkrepnin në fytyrën e tij. Fill pas ikjes së tij, ai i hodhi vështirimin depërtues Otos, si për të përcaktuar saktësisht datën se kur do t'i qethte kokën dhe do t'i lidhte këmbët me zinxhirë, për ta zvarritur të mundur pas qerres triumfale.

Lexo, lexo pa pushim që të harrosh ç'të ka ndodhur! Mbrëmje për mbrëmje Nelo Andrea u turrej librave që Rako Sirani solli sipas porosisë së tij. Lexonte i uritur. Deri në mesnatë. Ndonjëherë deri në agim. Si shigjetë. Ishte shumë e lehtë të dalloje që në këtë rënie përmbys mbi ta, në fakt ai bënte ikjen e dëshiruar drejt lirisë së mohuar. Shpesh i thoshte vetes që ishte katandisur në një njeri që jetonte vetëm me lejen e Rako Siranit. Jashtë asaj leje nuk do të mund të jetonte. Rako Sirani tundte kokën djallëzisht, lehtas dhe pëshpëriste “do t'i kalojë, do t'i kalojë si të tjerat dhe kjo dalldi”, ndërsa ai ndihej i ngarkuar me një urrejtje që e shtypte dhe e dërrmonte rëndshëm. Për të zezën e tij, shfletoi një libër me tregime dhe gjeti diçka misterioze për Argjiron, princeshën e qytetit. Sipas tregimit, “ciceroni i muzeut betohej se kishte parë në ëndërr rrëmbimin e legjendës. Ishte trembur, ligështuar, kishte ndier dhimbje të piktë, të hidhur, si çarje thike në brinjë. Nuk ishte natë kërthizë dimri, e errët, - betohej për nderin e ciceronit, - ku si në një jerm, udhën ta heqin inxhindet. Jo, jo. Ajo kishte qenë natë e ndriçuar, me cërga të mëdha drite dhe herë pas here binte shi i bardhë dallgë-dallgë. Kur iu shfaq pamja, që thoshte se ra si vetëtimë, vrushullima e vërvitjes

e rrëmbeu dhe e hodhi hopa në këmbë, pranë qelqeve, në dritaret e mëdha të kthinës. Prej andej ai dëgjoi ato britma që e bëjnë agun e sapodalë nga shpërgënjtë copë e thërrime. Ç'të ishin vallë? Me sytë që i xixëronin, ajo krijesë e frikësuar në palcë, dalloi qartë avuj fryme si fjolla gri që sikur binin nga qielli me hobe. Kaq e paqartë ishte gjithçka, sa në fishkëllimën kuturu të tij ngjante se ishte derdhur gjithë pikëllimi i botës. Ciceroni dyshoi që diçka duhej të kishte ndodhur. Ndoshta mund të qe shajni ose mund të ishin grabitur eksponatet e muzeut. Atje kishte gjëra me vlerë, sende intime, një këmishë e bardhë, pelerina e luftës, kurora princërore, varëse dhe një kryq i punuar në serm plot me smeralde jeshile. Objektet e princeshës së legjendës gjendeshin në krahun e majtë të sallës. Me hapa të lehtë, të vegjël, në qetësi, si qetësi e amshimit, ciceroni mbërriti atje, te vend i krimrit, dhe kur i pa në vend të palëvizura, sikur i vuri fre një shkulmi tjetër që me siguri do t'ia kishte çarë më dysh gjoksin e ngushtë. I lehtësuar disi, me brengë në skaj të një dyshimi, ai vështroi shiun e bardhë ikanak, si prej fijesh pambuku që nderej mbi kreshtat, tutje nëpër qiej. Duke gëlltitur mëngjesin e hidhur pelin, doli nga portat e mëdha të kështjellës, zbriti përposh te shkëmbi i madh, streha e shpëtimit dhe murimit dhe bëri kryq. Vetëm ai mund të dallonte pagabueshëm nëse princesha e legjendës ishte brenda apo e kishin rrëmbyer, nëse gjiri i saj pikonte ende, madje syri i ciceronit a diç thellë tij, ndienin nëse ajo e kishte thyer betimin ose jo. Kishte dalë princesha prej shkëmbit apo gjithçka ishte paranojë, thagmë e zakonshme thashethemesh? Kohë më parë, pandehma të rrejshme kishin qarkulluar në qytet. Pandehma me tundime epshi,

kënaqësi tek e çara e qejfit në mes të trupit, ikje, hedhje sire nga dikush që shfaqej e nuk dallohej dot nga syri i njeriut, deri dhe sikur..., sikur princesha ndiente nevojën për një dashuri të re. Flitej madje se ajo dilte natën për të dëfryer në pyllin matanë kështjellës. Sikur kapërcente urën e Zerzebilit dhe hynte në pyllin e gështenjave, mbështjellë me aromat dehëse që rrëzëllenin si diej të vegjël. Ky version bëhej disi më i besueshëm, po të kihej parasysh trilli që u derdh si rrëshirë që në ngjizje të legjendës, kohë kur mëtonjësit a ndoshta gjarpërinjtë e lajmit të rremë, nxituan të zhbënin thurjen. Ata thanë kinse nëpër kafene e foltore se princesha me foshnjën e gjirit nuk u hodh nga bedenat për t'i shpëtuar turkut Hasan pasha me ushtri, por ndëshkimit për dashurinë e fshehtë. Kjo flamë shoqëroi legjendën për gati pesë shekuj e gjysmë, derisa Ciceroni i muzeut, duroi sa duroi, dhe përfundimisht vendosi të jetojë, të gdhihet e ngryset si rojë në kthinën brenda kështjellës, në anën e majtë, sipër shkëmbit, fare afër bedenës nga ku ishte hedhur princesha. 'A ishte ai?', i vetoi ndër mend, teksa u përpoq të rikrijonte fytyrën e rrëmbyesit që iu shfaq papritur në ëndërr. Ishte e para herë që prej marrjes së detyrës që trupi i imët i dridhej si purtekë thane, dhe kjo nuk kishte të bënte aspak me frikën. Nuk e kuptonte pse Zoti e kish shënjuar që vetëm atij t'ia besonte rrëngën e vet. Doemos, iu betua vetvetes, derisa më pyeti: 'Edhe sa shekuj do ta lini të murosur?'. Zoti a dikush tjetër maskuar si ai, e paska pasur një plan. Një plan djallëzor rrëmbimi. Në mos gabofsha, ajo fytyrë më është shfaqur herë si internacionalist mongol e herë si marksist nordik. Me këtë përcaktim sikur donte të përfshinte në dyshim dy skajet e botës. Apo ndoshta gaboj... se njeriu

dhe gabon? Turbull kujtohej se i huaji, mongol a nordik, fotografonte shkëmbin e murimit nga të gjitha cepat, në orë të ndryshme të ditës, në muaj e stinë të ndryshme, a thua se aty brenda, në copën e gurit të stërmadh fshihej enigma. Njëherë e pyeti, (pyetjen e kujtonte hollësisht): ‘A nuk u bë copë e thërrime princesha kur u hodh nga gjithë ajo lartësi?! Ç’paska qenë kjo histori?!’ ‘Ah, ja ku doli dhe një birbo mosbesues’, shprazi zemërimin ciceroni duke i shpjeguar të huajit krejt zejen e procesit të murimit, çarjen e shkëmbit më dysh, pritjen në gji të princeshës dhe lënien e gjirit jashtë. Gjiri pikonte ende qumësht, për të ushqyer foshnjën, kohët dhe këngët. Dhe ky zakon i njeriut të kësaj toke ka nisur të kryhet ehu, ehu, që kur njerëzimi ishte në shpella, sepse ne kemi dashur t’i japim fuqi jetëdhënëse gurit. Po, po gurit.

- Ashtu? - kishte harkuar vetullat internacionalisti mongol.

- Po prit. A nuk është Ifigjena gruaja e parë që u bë fli për perënditë?

Ciceroni që e dinte mirë se rasti i Ifigjenës ishte kinse flijim, zëvendësim i saj me një kafshëz të pafajshme, nënqeshi, ndërsa buza i lëvizte lart e poshtë pa pushim. Tani erdhe në vahun tim, fërgëlloi ciceroni dhe sytë iu mbushën me ndriçim hënor. Grekët erdhën në tokën ku jetojnë sot, rreth 25 shekuj më parë; romakët para 22 shekujsh; por ne shqiptarët gjendemi këtu, më parë se të gjithë. Ne jemi populli që flasim ende një gjuhë aq të vjetër sa edhe ajo e etruskëve. Pas këtij shpjegimi kapardisë, i huaji, mongol, diç mërmëriti më vete. Nordiku heshti. Ajo mërmërimë nuk i pëlqeu ciceronit. I ngjau sikur i tha: ‘Hajt pa do më shohësh!’. Ciceroni i muzeut ishte burrë moshëthyer, i

pamartuar, që me sa dukej për mëkat, do të ikte nga kjo botë i virgjër, kryeneç dhe i pafaj. Në të vërtetë detyra e tij ishte të ruante sendet dhe objektet e ekspozitave të muzeut nga grabitja, filmimet e paautorizuara dhe manipulimet. Por ai nuk mjaftohej me kaq. E kishte kapërcyer detyrën, ishte shtyrë thellë në shpirtërim, në përkushtim e bindje edhe e dinte veten truporë mbrojtëse të princeshës. Jetonte jetën e të gjallit me princeshën e legjendës. Fjalët që përhapeshin rreth saj, historitë false, thumbimet kinse të atyre pak vizitorëve të huaj, kryesisht nga partitë marksiste të botës, variantet simotra për princesha të tjera që gjasme kishin bërë të njëjtën gjë me pushtuesin, apo konstatimet e llojit që kjo princeshë s'është gjë tjetër veç një imitim i keq i asaj apo tjetrës princeshë të huaj, e turpëronin, tërbonin dhe xhindosnin ciceronin plak të muzeut. Nuk është gjë e lehtë të ruash një legjendë, nderin e saj, ankohej apo mburrej herë pas here ai. Deri atë mesnatë, kur iu shfaq në ëndërr fytyra e turbullt, e paformë e rrëmbyesit. Cicero ni nuk duroi dot. Zbriti vetë poshtë rrëpirës, zhguallit të ashpër, në tokën gri plot zall, gjithë popëla, për të folur si burri me burrin, me shkëmbin. Me shkëmbin e murimit, shenjën e pazbërthyer mirë, papirusin, ku prej më shumë se pesë shekujsh gjallonte legjenda. Flladi brisk i pragagut ia shponte keqas mushkëritë e dobësuar, cipëholla, të mbushura me brenga e trishtime që pluskonin me vërtik. Por cicero ni ishte i palëkundur në vendimin e tij. Të bëhej, ç'të bëhej! Do ta linte gjithë frikën e tij në shkëmb, për të mos i dhënë shkas rrëmbyesit tinëzar që diku, kushedi në ç'hangar, kishte parkuar charterin e tij gati për ikje. Mbështeti ngadalë kokën në faqen e lëmuar të gurit dhe, kur dëgjoi të rrahura zemre brenda tij, mbylli

sytë. E mori vdekja. Shpirtin ia mbërriti ta linte në dorën e princeshës së legjendës.” Ja ky tregim e përloti dhe ai u betua se nuk do ta harronte kurrë. Do ta përjetësonte në një vepër muzikore.

Dy herë u përmend, të dyja herët doli nga e njëjta ëndërr. Donte ta griste si të ishte një copë letër e shkruar. S’e kapte dot. Nuk donte ta quante të vërtetë, sado që u rrotullua gjatë në shtroje: Version i ri i daljes nga burgu. Ndiente kureshtjen, shikimet, mosbesimin dhe dashakeqësinë e kalimtarëve. Të gjithë mezi ç’prisnin: - Ju treguam që në fillim, po nuk na besuat! Ja dëgjojeni vetë rrëfimin. “Ditën që dola nga burgu nuk më priti askush. Eca më këmbë disa qindra metra se doja të ngopesha me ajër. Hyra në kafenenë e parë anës rrugës. Rrufita disa kafe. Në fund të lokalit një plak më shikonte drejt e në sy. Shkova atje. Luajmë - më foli me gjuhën e tharë. Luajmë - i thashë pa shumë dëshirë dhe lëshova thesin me gjërat e mia të vogla. Luajta një dorë domino me plakun e dehur që s’kishte kundërshtar. Pastaj u nisa te stacioni i autobusëve. Në qytet mbërrita në muzg. Vetmi drithëronjëse. Një kryq i madh ishte vizatuar në derën e kyçur. Kapërceva murin e lartë dhe hyra brenda. U ula në gurin e vjetër mbi pus. Dhe prita. Më në fund, kur e kisha mbledhur mendjen, u shfaq në oborr ajo, Hana Erdali. Në dorë mbante një kërthi. U përshëndetëm ftohtë. Si dy të huaj. Luftuam një copë herë me akuza të pabesueshme. Pastaj të lodhur futëm armët në brez dhe heshtëm. Mora prapë thesin në krah dhe u drejtova kah pragu tjetër. Ajo, me kërthinë në dorë që belbëzonte ‘bukë’, zbriti në pus. Gjithë natën ëndërrova shtegtimin nëpër gjithësi pa e ditur

se gjithësia ishte brenda meje. Po pse iku Hana Erdali dhe i kujt ishte kërthia?”

Në gjitoni ra mort. Djali njëzetvjeçar i Kalo Hadërit u vra në kufi. Kujë e pasosur. Duhej të ishte fundqershori a fillim korriku. Shtëpia e Kalos në krahun e djathtë ishte ngjitur me atë të Rako Siranit. Krahu tjetër ishte bashtinë e madhe. Sapo u mor vesh lajmi, burrat u zhvendosën te Rakoja që hapi portën. Shkurria shkoi të shërbente në ngrehën e meitit. Atje të parat erdhën plakat. Vargan. Veshur të gjitha në të zeza. Sa shumë, sa shumë. Ca prej tyre, djersitur e përsququr si buallicat në pik të vapës që mezi lëviznin, ca të tjera hollake, pipiruke, aq sa kishe frikë t’i shihje. Vargan që ecte duke ngritur pluhur e zezim. Me fytyra të përhitura. Vinin nga rruga që i binte shkurt dhe të ngjiste përnjëherë në lagjen e epërme të qytetit. Ngjanin me fantazmat që këndonin lutjet, kujtonin copëza nga vajet biblike apo kërkonin psherëtimat lehtësuese për kohët midis të qarës. Kujtesa e gjëmës ishte vënë në lëvizje, si një mekanizëm. Sillte ndër mend gjithçka, deri në detaje. Ky qytet që i ka fiksime thashethemet, dmth., zhbirimin, lëndën e parë e merr pikërisht prej tyre. Kujtesa është ditari që ato e mbajnë gjithnjë me vete. Kur ato hynë te Kalo Hadëri, Nelo Andrea i shikoi që nga odëjashta. Ato sikur ecnin me ritmin e kujës. Hoqi dorë nga numërimi i tyre dhe u shtri në dyshekun e vjetër në tejanë të dritares që shihte nga rruga. Nisi të përfytyrojë se si ishte djali i Kalo Hadërit që u vra në kufi. Nuk e njihte dhe as kishte dëgjuar ndonjëherë të

flitej për të. Kësisoj gjëma e ndodhur në gjitoni, më shumë la gjurmë sesa plagë në mendjen e tij. Njëherë pati frikë mos ato, plakati në të zeza, ngatërronin portë dhe hynin në odëjashtë, e gjenin ashtu të shtrirë, gollomesh, mbuluar me cohën e hollë që ia kishte hequr jorganit. Hynin aty dhe i turreshin, shpraznin mbi të gjithë zemëratën e mbledhur komb. Bandill o bandill, do ta mallkonin. Ti shullëshesh këtu kurse ai i gjori dha jetën për atdheun!

Po t'i turreshin, do ta bënë pistil të zi me ato duar të rreshkura, gjithë nyja të forta. Të nxirat nuk do t'i shuheshin gjithë jetën. Mendoj të ngrihej, të vishej e të dilte nga dera e pasme e odëjashtës që të nxirrte në murin e pasmë rrethues të shtëpisë së Kokobatëve, ta kapërcente atë dhe t'ia mbathte sokakut sa t'i hanin këmbët, duke i lënë me gisht në gojë plakaruqet veshur në të zeza. Hoqi dorë nga kjo mahi. Në fund të fundit ç'punë kishin me të? Mos ishte ai fajtori? Ai ngrihej çdo ditë në pikë të mëngjesit për të fituar bukën e gojës. Punonte si kafshë në kodra e rrëpira. Kthehej në darkë nga puna. Lahej disi dhe shkonte në tregun ku blihen gënjeshtat. Plot shpresë. Zinte vend mes shumë të tjerëve dhe dëgjonte lajmet e radios. A nuk hamë gjithmonë gënjeshtra kur zemrat i kemi të uritura? A nuk jemi të gjithë viktima të një ëndrre? Ç'më çani kokën! Donte t'i largonte ato ndjesi ogurzeza. T'i përudhte në tjetër drejtim. Por nuk gjente mënyrën si ta bënte këtë. Nuk e kuptoi sa u rropat ashtu nëpër shkurre e ferra moskuptimesh kur dëgjoi zërin e Rakos që e thirri: - Dil, eja rri dhe ti në radhë me burrat! - U bë gati menjëherë. Të dy bashkë u ngjitën në odanë e madhe.

U mor vesh që djali i Kalo Hadërit, Bedri quhej, ishte vrarë pabesisht nga dy shkelës kufiri. Ajo që nxituam ta quanin të mjegullt, enigmatike, ishte sqaruar përfundimisht. Paqartësia e përkohshme ia kishte lënë vendin krenarisë, kur një ushtarak nga komanda e kufirit kishte sjellë lajmin e hakut të marrë. Dy shkelësit ishin kapur, i pari i vrarë, lidhur pas zëtorit të kooperativës u tërhoq zvarrë nëpër gjithë fshatrat e zonës kufitare, ndërsa të dytit, që kufitari ia kishte këputur krahun e djathtë me breshëri, gjendej i arrestuar në spitalin e qytetit. Sado që “haku i marrë ishte kryer” (lajmi i ushtarakut të kufirit), ndër burrat e kësodhit, mosbesimi dhe angështia më shumë se lavdërimi e mburrja ua kishte mpirë nifullat. Shumica e tyre mendonin se vdekja qenkësh një bushtë e keqe, pa dhëmbë, dhe për këtë shkak sikur ndienin dhimbje koke të padurueshme dhe as që kishin dëshirë të flisnin. Ata sikur i luteshin heshturazi Zotit që minutat dhe orët e qëndrimit në mort të iknin në marramenth. Heshtja ishte e thellë. Mortërimi gjithashtu. Po seç kishte diçka ende të pashpjegueshme që të shtynte të besojë se ky mortërim bëhej sa për sy e faqe. Burrat ulur në mindere druri. Radhë-radhë. Mbështetur në jastëkë të bardhë thithnin duhan të rëndë, tymzi. Pinë kafe të zezë. Burrat bluanin. Kur u dha lajmi që Bedriu, djali i Kalo Hadërit, u vra në kufi, të gjithë përfytyruan përleshje me ushtarët grekë, shkëmbim zjarri dhe një plumb, një plumb e kishte zënë dhe trimin tonë. Ngushëllim mbi ngushëllime. Madje dhimbje e krenari. Dhe këngë trimërie. Por jo. Nuk kishte qenë kjo. Errësira nuk mund ta dëbojë errësirën, vetëm drita mund ta bëjë diçka të tillë. As urrejtja nuk mund ta dëbojë urrejtjen, vetëm e vërteta dhe dashuria e kryejnë

këtë mision. Ngandonjëherë mendja të shkon te mahia që shteti nuk e tregon krejt të vërtetën. Prej kohësh flitej se ca të rinj të dhënë pas qejfeve e zvetënimit sa rrallëkush (informacione gazetash), iu merrte koka erë dhe i turreshin kufirit shtetëror. Kur ata u shfaqën rast pas rasti në pika të ndryshme të kufirit, autoritetet u shqetësuan tepër. Ndonëse u quajtën “mbeturina” të shoqërisë, të arratisurit, iu kujtuan njerëzve, me dëshmi kokëfortësie shkruar me gjak, se edhe mund të ikje jashtë këtij shteti me tela gjembash e ushtarë kufiri. Jashtë. Tutje. Larg. Përkundër tyre, brenda gardhit me tela flitej gjerësisht për atdhedashuri, vendin e të parëve, ideale të socializmit, shoqëri e barabartë. Flitej në radio e gazeta, në punë, lagje. Kudo. Në finale: Kurrë mos kalo matanë. Andej është humbja. Mjerimi. Vdekja. Por sa më shumë që thoshin: Mos, mos, aq më shumë ndizej gjaku. Kërshëria, ngasja e zbulimit, padurimi për të sfiduar, ankthi për të takuar të pamundurën. Ja kjo paskësh qenë shtysa e dy djemve përmetarë për të kapërcyer kufirin. Për t’u arratisur. Dhe kishin rënë pritë. Natën. Nën një hënë që ndriçonte pjerrët, tinëzisht. Ushtari i kufirit, fare afër tyre i qëlloi me plumba. Plumbi, njërin e mori në krahun e djathtë. Ia bëri copë e thërrime. Tjetri u fsheh pas shkëmbit. Nduku një petë shkrepë dhe si të hidhte një disk ia lëshoi drejt e në qafë. Peta e gurit ia këputi damarin. Gjaku plasi. Ushtari klithi dhe ra përdhe. Patrulla e ndoqi këmba-këmbës. E grinë në breshëri automatiku. Atë të gririn e lidhën pas zëtorit dhe në mëngjes e tërhoqën zvarrë. Rrugës nga shkonin fshatarët për në punë. Mbuluar trupi gjak e pluhur. - Djem nënash, - mermëriti dikush që s’u mor vesh. - Të rinj! Ah...! - Dhe fjalën e kapërdinë të gjithë si ilaç mortor. U zbehën paksa

në fytyrë, u zbardhën dhe lëshuan ahe lehtësimi. Pinë sërish kafe të zezë dhe cigare tymzi. Deri në orën 12:00 të paradites tjetër. Pastaj vargani i burrave dhe kujovaji i grave mori udhën për në rrafshinën e trëndafilut të erërave, në varrezën e qytetit.

Sa më shumë afrohej festa e çlirimit, aq më të mëdha ishin përgatitjet, por dhe dyshimet për sabotim e gurë të rrëshqitshëm poshtë rrotave. Drejtuesit e Komitetit e dinin se bujtësit e lartë që vinin nga kryeqyteti sillnin shpesh me vete dhe urdhra dekorimi apo dënimi për qeveritarët vendorë. Qëllonte që gjithçka shkonte mirë e bukur, hanin e pinin dhe befas nga mesnata, nxirrej urdhri i shkarkimit, apo më keq, mbinte te dera papritur gazi 69 i policisë shtetërore dhe të hidhte prangat. Të dërgonte te Shtatë Penxheret. Burgu i kalasë, Shtatë Penxheret, që i tmerrshëm. Më i tmerrshmi mbase në të gjitha vendet e kampit socialist. Mallkimi më i rëndë pëshpëritej gjithë frikë: “Të pafsha te Shtatë Penxheret!”. Arkitekti italian që e ndërtoi u çmend që në fillim me monstrën. Nuk duroi dot. Burgu i shtatë penxhereve ishte në ballë të kalasë, në pjesën perëndimore të tij. Përballë dritës dhe diellit, sipër, mbi lagjet e epërme të qytetit. Nga dritaret e tij dukej në pëllëmbë të dorës qyteti. Po pikërisht aty ishte ngritur gracka: T’i plaste zemrën të burgosurit! Shih me sy e plas me zemër. Në orët e ajrimit i burgosuri mund t’i shikonte nga lart të afërmit e tij tek ecnin pa ditur gjë nëpër sokakët e gurtë të qytetit. Ja ky ishte tmerri i tmerreve. Siç thamë në fillim, drejtuesit e

Komitetit ishin shpërndarë të gjithë me detyra konkrete në punët e organizimit të festës. Do të bëhej koncert i madh në sheshin “Çerçiz Topulli”. Grupet folklorike kishin kohë që bënë prova, ndërsa në një beze të bardhë - ekran, 6 x 4 metrafsheh, mbërthyer në murin e madh të godinës së turizmit do të shfaqej dokumentari i ri, me fjalimet e udhëheqësit, parakalimet dhe arritjet e pushtetit popullor. Rako Sirani kishte detyrën e vështirë të sigurimit të qetësisë dhe të duartrokitjeve të zjarra. Nuk e zinte gjumi natën.

- Mos u sëkëlldis, - e qetësonte Shkurrja. - Sa herë e ke bërë këtë punë, mirë do të dalësh. Ti je i zoti! - Rako Siranit që i pëlqenin këto fjalë, nuk ia ndante sytë Shkurrës, ndërsa mendjen e kishte përtej saj, sikur ajo të mos ishte aty. Në vend që ta qetësonin ato sikur e turbullonin. Fundja nuk ishte ai qeveritari kryesor i qytetit, kishte dhe tre-katër të tjerë që përgjigjeshin direkt për gjendjen. Sa t’i vinte radha atij...? Po ku i dihej? Hodhi një sy të rastësishëm në dritaret rreth e rrotull sheshit ku do të bëhej festa. Në dritare kishte lule. Në vend të gëzohej për bukurinë e hijeshinë e tyre, u drodh. Lulet në vjeshtë dëftojnë dimër të egër. - Ububu mos qoftë thënë! - mbajti larg vetes thagmën e besëtytit. Pas disa orësh, festa filloi siç ishte parashikuar. Në fillim fjalimet e udhëheqësve të vegjël lokalë dhe më pas dokumentari. Hiri i duartrokitjeve e ndezi atmosferën. Por ashtu si ndodh njëherë në një mijë vjet, me shpejtësi, me ngut, turbullt, plot trazim midis avujve të skëterrës, rasti kur të bie tersi për short, në skenë u ngjit Anusheja, marrukja rome me dekolte ekstravagante e sisët plot, që s’linte bejte e të shara pa këngëzuar për t’i shfryrë plot lezete nga goja e saj çorape. Në të vërtetë ishte çasti kur në dokumentar udhëheqësi nga

tribuna e fitoreve hidhte lule mbi popullin dhe marrukja Anushe tërhoqi mikrofonin e ia nisi avazit si dinte ajo: *Këndo o bilbil, këndo / topemadhi i nënës-o ...!*

E qeshura pushtoi sheshin si dallgë. Altoparlantët buçisnin: *Këndo o bilbil, këndo / topemadhi i nënës-o ...!*

Por atë çast, si të kishte mbirë nga poshtë skenës, kur të tjerët që e kishin për detyrë, me sy të fryrë nga e fjetura ruanin vetëm zili e zemërim ndaj Rako Siranit, ai u lëshua si zhgabonja mbi prenë e vet duke ia rrëmbyer mikrofonin nga dora. Pastaj e përmbloodhi hopa (ku e kishte fshehur gjithë atë fuqi) dhe e zbriti pa një pa dy përposh shkallëve. Anushesë së gjorë i hodhën me shpejtësi prangat. Hekurat tringëllinë. Ajo tringëllimë hekurash ngjau me zhurmën e baltës e guriçkave kur bien mbi arkivol.

- Ti sill vetëm një pako llokume me arra, të tjerat i kam unë, - i tha Otoja.

Dhe Nelo Andrea të shtunën në pragmuzg eci nëpër rrugën e pjerrët si thikë, që ngjitej mbi përrua të Gjokone e të çonte në lagjen e vjetër të qytetit me emrin e çuditshëm Cfakë. Shtëpitë, në dy anët e një rrugice shtufi të ngushtë sa gishti, që dukej sikur sapo kishte kaluar pikëllimi, ishin me gurë të zinj, nxirë mbase prej kohës dhe me spretje të rrënuara. Edhe shtëpia e gjyshes së Otos ishte e tillë, sikur i qe djegur çatia disa herë. Vetëm se në pemët e bashtinës e mbi çati gugonin pëllumbat. Rroba po të vjetra lëkundeshin të varura në tel shkujdesshëm. Përpara shtëpisë dykatëshe gjendej dhe një pus me çikrik, kova e lidhur me litar

mëndafshi anash saj. Në hyrje e priti Otoja. Sipër, në dhomën e madhe kërcisnin dhogat e drurit sikur do të shqepeshin. Një grua, rreth tridhjetë e pesë vjeçe, bionde i dha dorën. Pas saj qëndronte një vajzë e re, ndoshta e bija, që dukej si nxënëse shkolle. Në cep, afër dritares gjendej tavolina katërkëndëshe, e mbushur sipër me shishe, qelqurina e gatime. Otoja shpejt e shpejt, me shkathtësi akrobati bëri prezantimin: - Lola, mikja ime, mësuese e gjimnazit dhe Margarita, ish-nxënësjë e saj.

- Ulemi. Për meshkujt kemi konjak, për femrat liker. A mund të shërbesh Lolë e dashur?

“Lolë e dashur” tingëlloi shumë e afërt, mikluese, intime. Më shumë si marrëdhënie dashnorësh sesa si marrëdhënie burrë-grua. Ai e dinte mirë që Otoja ishte i pamartuar. “Lolë e dashur” ishte dhe si ftesë. Ai la të kuptohej se për vete kishte zgjedhur Lolën, ndërsa atij i mbetej Margarita. Lola mbushi gotat. U ngritën në këmbë dhe i trokitën: - Për jetën dhe dashurinë!

Otoja pas kësaj, me një gjest kalorësiak kërkoi lejë. U ngrit shpejt dhe se nga nxori disa batanije me të cilat i mbylli mirë e mirë të dyja dritaret ballore. Pastaj, nga komodina anësore mori kordonin e gjatë të radios dhe e futi në prizë. Kërkoi stacione në frekuencat e bandës nga radioja e vjetër ruse, doemos të modifikuar dhe, kur tingujt e muzikës mbushën dhomën, fytyra e tij ishte e gjitha hare. Otoja ishte bërë si fëmijë. Çiltërsia e zërit, thjeshtësia e veprimeve, humori, lirshmëria e plotë në prekje, e puthura, e qeshura e thellë që për të nënkuptonte “shpresë” sikur ia mbërrinin të zgjonin mahnitshëm të gjallin tek i vdekuri.

Kur ai fiku dritën, Lola e dashur kishte ndezur katër qirinjtë mbi tavolinë.

- Tani jemi në rregull. Asnjë zhurmë, asnjë dritë jashtë. Jashtë le të mbetet errësira! Këtu brenda drita. Kërcejmë? - dhe rrëmbeu Lolën në krahët e tij.

Neloja u afrua më afër Margaritës. Ajo ishte e ndrojtur. Zeshkane. Me flokët pis të zinj. Sytë i mbante gjithë kohës përtokë. Sikur ishte e detyruar. Qëndronin pa folur. Ai zgjati dorën. Ajo të sajën. Dhe përcollën ngrohtësi te njëritjetri. Lëndimthi ai vështroi gjinjtë e saj. Drita e qirinjve nuk mjaftonte për t'i dhënë përgjigje pyetjes së heshtur që rrinte në sy: “A do mund t’i prekte ato?”. Lola, ndryshe nga Margarita, rrotullohej si flutur. Sytë e saj shkëndijonin. Herë pas here ai dhe ajo ngjisheshin. Përpiheshin. Ajo mbështeste kokën në supin e tij dhe ai lehtësisht e puthte në qafën e gjatë, të bardhë. Otoja dhe Lola qëndruan gjatë në krahët e njërit-tjetrit. Nuk ngopeshin. U ulën kur ndjenë se duhej të bënin pak pushim. Lola nuk pushonte së foluri. Fliste bukur. Si një poeteshë, ndonëse në gjimnaz jepte lëndën e biologjisë. Më pas fjala, fjala u soll rreth zakoneve të reja, mbrëmjeve të argëtimit kolektiv nën vrojtimin e mësueses kujdestare, aksioneve vullnetare dhe piknikëve që organizonin organizatat e rinisë. Lola ndihej që kishte mospëlqim ndaj kësaj fryme të re, siç e quante ajo. Çfarë do t’i bënte asaj fryma e re: do ta plakte papritur, do ta rinonte edhe më, apo do ta bënte të pavdekshme? Otoja qeshi me të madhe. Ajo që e dinte mendjen e tij, përplasi duart e buta mbi shpatullat: - I keq, i keq. Po miqësia është e përveçme. Nuk është kolektive. Edhe kujtimet. Këta po i kolektivizojnë të gjitha. Të gjitha aaaa!

- Ne gjithmonë hamë gënjeshtër kur zemrat i kemi të uritura, - kollofiti një copë të pjekur Otoja pa e lëshuar gotën nga dora, - sepse jemi viktimë të një ëndrre. Ëndrra jonë është dashuria, personalja e jo kolektivja. A e dini si shkruan poeti im i zemrës Mandelstam, ai që ngjalli rezistencën kundër regjimit të pamëshirshëm të Rusisë Sovjetike? Dhe nisi recitimin:

*Të gjitha i humbëm, duke dashuruar;
Në dhjetor të vitit shtatëmbëdhjetë,
Dikush u grabit me vullnetin e popullit,
Tjetri grabiti veten e vet...*

Duartrokitje. Dhe gotat u ngritën sërish. Pastaj sërish. Pastaj me fund. Si të zgjohej nga një pendim, Margarita u ngrit në vallëzim duke tërhequr Lolën për dore. Ato vallëzuan disa çaste bashkë. Më pas Otoja i hodhi duart te Margarita, ndërsa Lola shkoi drejt Nelos.

- Po ne të dy? - qeshi pa të keq Lola. - Ne jemi kaq të largët! Margarita është afër teje. Ka dy vjet që lëngon. Ka mbaruar maturën dhe... Ka qenë e shkëlqyer, por vëllai i arratisur e mori në qafë. Nuk i japin të drejtë studimi për shkollë të lartë. Dhe ajo pret... E morën në qafë.

- Ah. E mora vesh, - argument i saj iu duk një dokërr, ndërsa mendja i fluturonte në gjëra të tjera.

- Njeriu i jep vetë formë fatit të vet - ia futi kot, dhe befas mendimi i ngriu në një pikë të largët matanë oqeanit: - ç'dërdëllit kot! - Nuk u desh më shumë se një grimë kohë, kur Otoja ia shkëputi Lolën nga krahët dhe sikur e shpëtoi kur i dhuroi Margaritën. Nuk e mbajti mend se sa vallëzoi

me të. Sytë puliteshin ngazëllueshëm. Pëshpërimat hynin-dilnin te njëri-tjetri dhe një dritësim i çuditshëm binte mbi ballin dhe buzët e tyre. Shpejt e kapën veten të vetmuar, pasi Otoja dhe Lola kishin ikur në dhoma të tjera. Ai apo ajo e puthi njëri-tjetrin? Po prekeshin. Lehtë. Sikur kishin frikë mos lëndonin. Ndërsa ai e mësonte të bënte dashuri, ajo e mësonte të dashuronte!

- Jam i lumtur, - tha ai, - me mua është paqja e brendshme.

- Jam e lumtur, - tha ajo. - Është natë e bukur për mua, natë që lë gjurmë dhe jo plagë.

Qëndruan të përqaftuar ndoshta gjer në agim. Kur kapërceu portën të ikte, ngriti kokën lart dhe dallooi pirgje të zymta resh në bunacën e qiellit. Pak sekonda më pas dëgjoi një të shtënë në shpatin përballë. Një tufë gurgujsh të trembur, u ngritën furishëm dhe fluturuan matanë rrëzomës. Bënë një gjysmërrotullim dhe ikën. Ishte ende errësirë dhe s'pipëtinte këmbë njeriu. Duhej të zbriste deri poshtë, nëpër një rrokullimë, për të dalë shkurt në rrugën e madhe që të çonte në shtëpinë e Rakos Siranit. Hidhte hap e mbahej. Diku u përgjunj. Ndoshta për shkak të pjerrëpopla marramendëse a të ndonjë gjëje tjetër që se kujtonte dhe aq qartë, iu ngulit në tru mendimi që shtëpitë e Cfakës mund të rrëshqisnin në përrua nga moment në moment. Pas rënies, ujërat e rrëmbyera të Gjokonës mund t'i çonin ku të donin. U lemeris. Në odëjashtën e Rakos mbërriti pa zbardhur drita. U fut pa zhurmë. U zhvesh dhe ra në shtroje. Nuk kishte mbyllur ende sy kur dëgjoi zëra dhe hapa që zbrisnin shkallët e shtëpisë së Rakos. Vuri syrin në vrimë të çelësit. Ishin tre vetë dhe Rakoja që po i përcillte. Njëri prej tyre, ai i mesit mbante uniformë policie. Në ikje, i pari,

me sa duket më i rëndësishmi, iu kthye Rakos: - Mos harro, nga ky informacion varet gjithë suktesi. Nuk do t'i lëmë armiqtë të arratisen. Këtu do t'jua bëjmë gjyqin! Në shesh të Çerçizit do t'i varim, t'i shohë gjithë populli! - Rako Sirani nderoi me grusht. Dhe ata ikën. Nelo Andrea u fut ngadalë në shtroje. U rrotullua në krahun tjetër. Duhej gjithsesi të flinte.

Kreu V

- Kam abuzuar shumë me mikpritjen tënde, - droja e kahershme e Nelo Andreas për shkak të vështirimit mëshirues të Shkurre ishte davaritur duke i lënë vendin vendosmërisë. - Ka ardhur koha të kem banesën time! Si do bëjmë?

Rako Sirani e dëgjoi si çdoherë, kinse i merakosur. Ai vështronte gishtërinjtë e Nelo Andreas si dridheshin lehtë. Tensioni shkarkohej aty, ndrojtur, si në një poligraf që ende s'i kishte verifikuar të gjitha të dhënat. Pjerrtazi hidhte vështrime qortuese nga Shkurrja. Ajo rrinte mumie. Mumëzonte.

- Mirë, mirë, se nuk kemi mbajtur botën në krahë, - tha qetësisht, pa përcaktuar nëse bëhej fjalë për nderin ndaj Nelos apo ashtu thjesht, si për gjithë të tjerët. Nuk bëjmë llogari. Ti je nipi im dhe kjo është shtëpia tënde.

Dyshimi se fjalët e tij të pasinqerta, ishin të thëna ashtu kuturu, sa për të kapërcyer situatën, e ligështuan në çast, saqë njëherë u bë gati të ngrihej e të ikte. Por ishte Shkurrja që solli sa hap e mbyll sytë, një sini të rrumbullakët me meze, ëmbëlsira e raki, që e gozhdoi në vend. Rakoja dukej i çelur në fytyrë. Sytë, e qeshura në cepat e buzëve, madje dhe tymi i cigares që sapo ndezi, kishin diçka të ngrohtë, të shtruar, intime. Çudi me këtë njeri? Si nuk u gjend njëherë gafil, i hutuar, pa mendje, i papërgatitur? Usta, i kishte thënë

një ditë Otoja, usta e shkuar ustait. Ja ç'është Rako Sirani. Raki e zier dy e tri herë. Nelo Andreas atëherë iu dukën cinike, të ftohta, shpuese fjalët e tij. Nuk deshi t'i besonte. Mirënjohës ndaj tij, jo aq sa t'i puthte duart, Nelo Andrea mendonte se sidoqoftë, Rako Sirani ishte njeri pozitiv, njeri që e kishte ndihmuar të kapërcente çaste të vështira të jetës.

- Kam menduar gjatë për këtë gjë, - shikimi i tij depërtonte në pjesën qendrore të syve të Nelos dhe nuk ndihej i kënaqur ngase aty s'gjente mirëkuptimin e butësinë e duhur. Përkundër, ajo pjesë ishte e ashpër, dyshuese dhe mbi të gjitha kryengritëse. - Kam menduar si një baba. Sikur të ishte biri im ... - tha përhumbshëm.

Mysafirët erdhën në fundjavë. Ata u pritën në bashtinë. Shkurrja nxori gjashtë karrige dhe një tavolinë, afër pusit. Fresk dhe fërshëllimë ere nëpër gjethe pemësh. Ishin tre vetë, nëna, babai dhe *ajo*. Përballë tyre u ul Rako Sirani, ai dhe Shkurrja. Shkurrja gostiti me llokume e gliko. Më pas ëmbëlsira pafund. *Ajo* nuk preku asgjë. Sytë bojëqielli, të mëdhenj, gjithë dritë e nur, në atë lëkurë bardhoshe me kurorë ondesh pis të zeza, ishin ngulur në sytë e Nelos si shirat e bekuara në tokën e zhuritur të gushtit. Kafshonte herë pas here buzën, sa e bëri gjak. Ndërkaq me gishtërinj, kishte kapur rripin e poshtëm mbërthyes të këmishës dhe po e rrotullonte pafund. Gati në këputje. Me siguri ajo nuk e dinte gjithë të vërtetën përse ndodhej në atë shtëpi. Dinte vetëm pjesën e sipërme të historisë, fejesën me nipin e Rako Siranit.

- Gjithë besimin e kemi te Rako, përndryshe... - në vend të atit, - kishte pyetur më vonë nëna e saj.

- Ç'të them... Mua mu duk se djali, ai që ishte ulur në mes dhe që nuk i ngriti sytë fare, do ketë pasur ndonjë kleçkë. Ne nuk ia dimë historinë... mbase ...

- Jo Kristaq, as mos e mendo kthimin pas. Apo mos ke ndër mend ta prishësh krushqinë?

- Ore për mua ashtu qoftë gjithë jetën, guhak dhe pa gojë. Po pas martesë këta nisin e nxjerrin flatra. Na kërkojnë qiqrat në hell...

- Pra, e dimë si është puna dhe nuk ka nevojë t'i kërkojmë hollësi të tjera Rako Siranit? Atëherë mblidh njerëzit e barkut e ta shpallin fejesën me një drekë të përbashkët. Motra e vëllezër. Thuaji Rakos se e pranojmë dhëndrin. Për të tjerat di si të manovrosh vetë.

- Po për pajë, nishane e katandi çfarë t'u them? Për ato sa do të japim?

- Do të japim për të veshura, enë kuzhine, shtrojat, një dyshek, dy qilima dhe makinën gepëse. Dhe thuaju që të tjerat do t'i kenë kur të vendosen në shtëpinë e tyre, që të mos bredhin sa andej këndeje. Edhe diçka, a të pëlqen ajo puna e djalit? Në fidanishte iëëëë...! Thuaja dhe këtë; djali të gjejë sa më parë një punë tjetër. Të lëvizë një çikë nga vendi Rako Sirani. Si të duket, ke besim te Rako Sirani?

- E ç'më pyet për këtë. Ti ishe gati t'i hidheshe përsipër kur ai erdhi na kërkoi dorën e vajzës. Apo s'është kështu? Nuk është se e njoh mirë Rakon. Sidoqoftë faleminderit që na respektoi. E po tani duhet t'i themi që kjo punë të bëhet sa më parë. Nuk kemi ç'presim. Po s'u bë tani s'ka për t'u bërë kurrë. Dhe mbeti. Fëmijët janë të rritur; - ç'më thua.

- *Dhe shiko, Rakos thuaq që shpenzimet i kemi në mes. Sa ne, aq dhe ata. Se mos bësh të mirën, të dhembshurën? Asnjë gjë më tepër.*

- *Do t'ia them, po ti bëhu pak më burrë dhe mos ma lër mua të gjithë barrën. Gjithsesi unë do bëj timen, të pamundurën.*

Ndërkohë që dy krushqit bënë dialog absurd me mendjet e tyre, Nelo Andrea kuptoi se ajo ishte shurdhmemece dhe jo ashtu siç i kishte thënë Rakoja. Ç'rëndësi kishte për të? Ai i vdekur ishte. Edhe kujtimet po i vdisnin një nga një. Ai qe mësuar tani me vdekjen, pa atë muzikën e ëmbël të së kaluarës. Vetëm se ajo, Pandora e quanin, ishte si kukull. Rrobaqepëse. Kukull që qepte kukulla, në repartin e rrobaqepësisë.

Mesnata u lemeris pasi çnjerëzorja ndodhi pikërisht në qendër të errësirës së saj. Shumë do të tmerroheshin nëse në vend të pasqyrës do të shihnin veten në syprinën e mesnatës. Njerëzit qenkan si qelqi, kur ka diell shndrijnë, ndërsa në errësirë duhet të kenë shumë dritë brenda vetes për t'u shquar.

Ora 2:30 minuta.

Natë e ftohtë, me shi dhe erë. Lllamarinat përplaseshin nëpër qoshet, ndërsa nga sprethet e çative binin rrasa guri. Bam, bam, bam - goditje të forta. Nelo Andrea u ngrit i trembur. U afrua në dritare. Energji elektrike nuk kishte. Bam, bam, bam vinin nga përtej. Në portën përballë sokakut kondakët e pushkëve, bam, bam, bam, goditje të forta në

portë! Porta mbante ende. Nuk ishte shqyer. Dikush u çua, goditjet shtangën. I zoti i shtëpisë ngadalë zbriti në shkallët e patit për të dalë në oborr. Në dorë mbante një kandil. Thirri që nga brenda: - Kush është? Çfarë keni në këtë orë? - ishte zëri i dridhur i plakës Hasime.

Në shtëpinë e saj strehoheshin veç dy nuset e djemve dhe gjashtë fëmijë. Katër të njërit dhe dy të tjetrit më të vogël. Më i madhi nga fëmijët ishte katërmëdhjetë vjeç, i vogli dy. Të dy djemtë e plakës Hasime ishin arratisur. U arratisën nga deti. Në Sarandë. Dolën me not në Korfuz, natën. Gjysmë të vdekur. Thuhej se pas Greqisë ishin shpërngulur dhe kishin mbërritur në Amerikë, ku i priste xhaxhai i madh. Histori e ngatërruar ikja e tyre.

Porta e trashë prej lisi, me llamarinë përmbi, sa nuk shembej nga goditjet. Plaka Hasime e hapi portën përgjysmë. Mbi sytë e saj ra dritë e fortë elektriku dore, ndërsa më tej shquheshin silueta ushtarësh dhe policësh. Të gjithë të armatosur me pushkë dhe automatikë.

I pari i tyre, ai që udhëhiqte shpurën dhe ngjante jo si i kësaj bote, gjithë krekosje ngriti zërin:

- Me vendim të Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve ju njoftojmë se që prej këtij momenti, e gjithë familja do të internohet në fshatin Kaparjel. Keni më pak se 30 minuta kohë të bëheni gati, ndërkohë që ushtarët dhe policët do t'ju ndihmojnë të ngarkoni plaçkat në kamion.

Plaka Hasime u pre. Sa nuk i ra të fikët. Mblodhi veten shpejt dhe foli prerë: - Nuk kam ku shkoj natën! Gjashtë fëmijët dhe dy nuset flenë. Gjynah nga Zoti. Gdhihet dita nesër xhano! Gdhihet!

- Nuk pret puna. Është urdhër! - preu shkurt i pari i shpurës me një zë që u duk jo bindës.

- S'lëviz nga porta kaq ta bësh dhëmbin, - tha plaka dhe diç tregoi me dorë. - S'kam ku i nxjerr fëmijët natën nëpër shi. Më mirë merrmëni mua, ose më vrisni. Bëni ç'të doni! Unë s'lëviz nga pragu!

Ndërkaq dy nusët hodhën supeve mushama dhe dolën në prag. Edhe midis përgjumjesh ndodhin ndonjëherë çudi të pashpjegueshme. Njëra prej tyre u ul në gjunjë dhe u lut: - Ejani në mëngjes. Tri orë janë të shkretën. Tri dhe jo më shumë. Ç'do gjë do ta kemi gati dhe nisemi aty ku thoni ju. Si t'i ngremë tani fëmijët nga gjumi? Ç't'u themi?

Plakës Hasime gati i kishte ikur goja. Mërmëriste me vete si të dëshmonte provën e shkretimit: - Si nisi, si mbaroi, a mbaroi vërtet... korba... korba...! Ku je Adil? - i thirri burrit të vdekur pesë vjet më parë. - Ku je? Dil more?

I pari i shpurës larg çdo trazimi të dyshimtë u lëkund dhe diç foli mënjatë me një polic thatim që pinte pa pushim cigare disa metra më tutje. Disa minuta më vonë u kthye. Dhe urdhëroi me të njëjtën mungesë vëmendjeje si më parë: - Mirë. Mirë. Do të presim tri orë. Dakord. Në orën pesë e gjysmë nisemi. Mos kemi fjalë?!

Në portën e plakës Hasime menjëherë u vendosën tre persona të armatosur, një civil, një ushtar dhe një polic. Kamioni ushtarak u parkua rrëzë murit.

Plaka Hasime u ul në prag dhe nuk lëvizi.

Fiks në orën pesë e gjysmë, asnjë minutë më vonë, të tetë pjesëtarët e familjes, dy nuse, gjashtë fëmijë dhe plaka Hasime e nënta, të mbledhura kruspull në karrocërinë e kamionit ushtarak, mbuluar me jorganë të trashë e velenxa,

u nisën drejt Kaparjelit, fshatit në thellësi të maleve të Labërisë, ku shihej vetëm një kupë qiell në ditë. Për dreq, shiu nuk pushoi gjatë gjithë ditës.

Java kaloi pa u takuar me Rakon. Ai ikte. E gjithë zbrazëti e krijuar nga mosshpjegimi u shndërrua papritur në makth. U kuptua që gjithçka ishte vendosur paraprakisht. Në vend të festës apo asaj kohës së njohjes, shkëmbimit të vizitave dhe çuquritjeve pa fund, do të kishte vetëm përgatitje, llogari dhe pritje për ditën e fejesë - martesës. Një shpresë e fundit për të marrë përgjigje për gjithë hamendjet dhe pikëpyetjet, si një bubullimë e largët që tregon nëse do të mbërrijë shtrëngata, u fashit kur Rako Sirani preu datën dhe njoftoi krushqit. Gjërat po bëheshin heshtur, si nën dorë, vuvtazi. Memecëria kishte rënë si flamë duke qepur gojën e gjithsecilit. Sikur e paskëshin dashur këtë lloj flame - memecërinë! Memecëria hyri si dehje e paprovuar ndonjëherë brenda trupit të tyre. Pak nga pak, kuptimi i vërtetë i saj po zbriste në ndërgjegje. Moskomunikim. Përfytyrimi për këtë gjendje të paprovuar kurrë më parë mbeti disa ditë si i ngrirë. Të mpirë, në pezm, vështrime plot helm, kalonin përbri njëri-tjetrit sikur nuk shiheshin. Nuk e përmendte askush faktin që nusja e re, ajo për të cilën duhej të flitej, ishte memece. Ndoshta ishte më mirë fakti që memecëria e saj iu ngjit gjindjes pasi iu preu rrugën thashethemeve të rëndomta. “Më parë paska qenë e lëvizur... flitet se pasdarkave shkonte tek... atje në rrobaqepësi shefi i saj e shikon akoma vëngër... gjinekologu Ruzar paskej

thënë... por tani është e sigurt se është e pastër.” Ishte më mirë që e kishte mbledhur mendjen. Mendimi se për nuset e reja ka fjalë gjithherë e gjithkund ishte vuvosur. Shenja e fshehtë që Nelo Andrea kërkonte të kapte nga nxitimi me të cilën po ngjizej krushqia, herë jepte shkrepimë e herë fikej aty për aty. Deri ditën që ai i shkoi në zyrën e tij në komitet dhe përballë: - Pse e bën këtë krushqi?

- Dua të kesh një jetë të sigurt, - Rako Sirani e vështroi gjatë në sy. Kokërdhoku i majtë dhe ajo vijëza e bardhë në mes, u zvogëluan, gati përgjysmë.

- Çfarë jam unë, shkretan i gjetur në shkretëtirë? - sikur iu gërmush ulërimës së erës dhe ngarendjes së bishës.

- Me kohë do ta kuptosh e do më japësh të drejtë. Ti hyn në familje të kamur, me mes të fortë e me gjindje të madhe. Mos e harro këtë nipçe! - dhe nuk e kuptoi se prej nga i buroi gjithë ajo qetësi.

“A nuk mbaroi dënimi im?”- deshi të thërriste në gulç po e përmbysi thellë klithmën. Në të vërtetë ajo që nuk tha ishte: “Pse më shtoni dhe një dënim duke më martuar me memece?”.

- Ku ma gjen! Ku ma gjen që në këtë kohë e këtë vend ta kesh gruan memece, - ende pas kaq e kaq vitesh nuk është qartësuar nëse këto fjalë u thanë vërtet prej Rako Siranit apo rrodhën nga gjithë ai shqyrtim që besonte se dilte nga nënndërgjegjja e tij?

Fejesa dhe martesë u bë në një ditë. Kjo ndodhi njëzet vjet më parë. Në mes të shkurtit. Në ditën e Shën Valentinit.

Apo ka ndodhur parvjet Pandorkë? (prej asaj dite ai e përkëdhelte kështu dhe ajo e kuptonte nga timbri i zërit dhe gjatësia e shkronjave).

- Jo, vjet.

- Po tani më kujtohet me hollësi gjithçka. Ishte shkurt, 14 shkurti, Shën Valentini, një ditë e ftohtë e veshur me mjegull. Jashtë qelqeve gjithçka ngjante e rrejshme. Sikur sapo t'i fshije ato drej qelqe, do të shfaqeshin pamje të tjera, krejt të kundërta nga ato që shihje.

- Po, po, - fjalët i zëvendësoi tundja e lehtë e ballukeve.

- Po tamam, 14 shkurt ishte ajo ditë. Ju erdhët për drekë të gjithë te Rakoja. Ngjitët shkallët e drunjtja, që gati nuk u rrëzuan nga takat e grave dhe këpucët lustrafinë të burrave. Ato vetëm u tundën. U drodhën. Po kjo s'ishte asgjë para asaj që ndodhi më pas.

Ajo puliti sytë blu të thellë, sikur ndjeu dhimbje dhe deshi që ai të mos vazhdonte më.

Dasmorët u ulën të gjithë në karrige. Vendet i sistemoi Shkurrja. Sa bëheshin? Njëzet e pesë a tridhjetë vetë? Unë dhe ti u ulëm bashkë në divanin e vogël, të ngushtë. Divani binte i ulët. Shtruam jastëkë poshtë që të ngriheshim. E mban mend besoj? Këmbët e tua hipën sipër këmbëve të mia. Përvëlonin. Përsipër kishim mbulesën e tavolinës.

- A..., a..., jo, jo, - bëri zgjatjen e kurrizit të pëllëmbës si shenjë mosaprovimi.

Më duhet ta rrëfej të gjithë historinë Pandorka ime! Pas këngës së tretë, (nuk e di pse kënga e tretë ndolli aq ters) po, po këtë e kam të fiksuar, pas këngës së tretë nisën lëkundjet e tërmetit. Dasmorët të tmerruar nxituan të dilnin nga pati i katit të dytë, atje ku ishte shtruar gostia, por e

kishin të pamundur. Shkallarja e drunjtë ishte këputur. Po ashtu u shemb pjesa e anësore së majtë të çatisë. Muret po rrëzoheshin ngadalë. Kur ranë në kat të parë, veç plagëve dhe gjakut, thyerjeve dhe mallkimeve, nisën dhe të bërtiturat e thekshme. Dilnin prej shtëpisë - gërmadhë dhe vraponin ku të mundnin.

- E... e p... p... e, - diç deshi ta fajësonte.

- Si mund ta dija unë më parë që tërmeti do të binte pikërisht atë ditë dhe madje në drekë? Por ne paskemi qenë me fat, sepse kur u ça përfundimisht dhe u epua dheu, që sikur vlonte nga përbrenda, ne ia kishim mbathur. E kujton dot faktin që askush në atë kohë nuk porositi arkivol? Kur u takuam ca ditë më vonë, e kujton apo jo, ishte vetëm Shkurrja që kishte thyer krahun, ndërsa të tjerëve iu ishin përtharë zhubitjet dhe lëndimet?

- Ë ëëë... ëhë ëhë ... - ajo përplasi duart si toptha të bardha dëbore.

- Rakoja erdhi me kryetarin e komitetit për të parë se si qenkësh katandisur shtëpia e tij. Me vete, kryetari kishte marrë gjeologun, ekspertin e ndërtimeve, dy inxhinierë dhe kushedi kë tjetër, sepse ishin shtatë vetë. Ju e dini që ai nuk kishte si ta linte Rakon në baltë. Nuk kishte ardhur për zdërhallje qejfi. Dhe për besë, shtëpia u riparua për gati dy muaj e gjysmë, aty nga fundprilli, fillimmaji. E mban mend, Pandorkë?

Ca ditë më vonë, ende pa zbardhur vazhduan të frynin erërat. Erëra që kishin sjellë tërmet dhe shira. Shirat shterën

ndërsa era mbeti. Në gërmadhë, shiu nuk i mbrojti dot sendet, orenditë e rrëzuara. Era shfryhej, përdridhte trarët e varur, dyshemetë dhe bënte të rrëshqisnin rrasat e gurit të çatisë së shqyer si gojë çatalli. Rrasat rënkonin një copë herë e pastaj binin me rrapëllimë. Kuaj gjigantë resh kalonin të heshtura nëpër qiell dhe sikur ishin gati të preknin tokën. Era përplaste një kanat që kishte mbetur ende varur si një krah i thyer. Poshtë saj, si për t'u mbrojtur, me duar kryqëzuar pas kokës, lëviz njeriu këmbadoras. Është në kërkim të diçkaje që vetëm ai e di. Dy trarët e mëdhenj të tavanit janë kryqëzuar me njëri-tjetrin dhe mbajnë përsipër gjithë peshën e rrënojës. Hap një si derë dhe pastaj ndalet papritur. Vrunduj ere lëkundin trarët. Ndien t'i regëtijë zemra në mënyrë të ç'rregullt. Vagullthi shikon si këputet një copë tavani që bie nga lart poshtë. Për fat, copa, nja dy metra, rrëshqet në brinjët e trarëve duke u përplasur pas gurëve grumbull. Njeriu që e di gjithmonë çfarë kërkon, del në cep të kthinës së dikurshme dhe fërgëllon, sikur një flakë përpëlitëse përbrenda gjoksit të tij del përjashta dhe ndriçon. “E di që nuk ke vdekur, as je shkatërruar”, deshi të thërrasë papritur. “E di që shënjimi yt është të jetosh gjatë, këtë e kam kuptuar që ditën e parë, ndonëse ti ma ke fshehur. E mbaj mend mirë se si u bë zoti yt kur unë të burgosa, të fsheha, të hoqa mundësinë të ishe e lumtur në duart e mia.” E drejtoi disi trupin dhe më pas u përkul sërish duke u zvarritur drejt vendit ku e dinte që në pritje rrinte sekreti i tij. “Më lër të të dua me fatkeqësinë time!” U përpoq të zhvendosë me kujdes, me duart e veta njërin nga trarët e mëdhenj. Sekreti e la të afrohej, duke qëndruar i heshtur poshtë peshës së rëndë të hedhurinave. Me dy

krahët, ai u përpoq të zgjeronte vendin ku duhej të futej për të mbërritur aty ku gjendej e fshehta e tij. E shtyu dhe ca më tepër traun e krahut të majtë dhe pranoi mbi kurriz furinë e çatmasë, copave të drurit, llaçit, sendeve, musandarasë me tesha, enëve që u rrëzuan rrokopujë. U gjakos në shpinë dhe në veshin e djathtë, por nuk hoqi dorë. Bëri edhe ca më përpara. Tani era frynte tej përtej. Mbajti frymën kur pa që sepetja e drurit kishte mbetur thuajse e paprekur dhe i shpëtoi falënderimi: O Zot! Sepetja e drurit, zbukuruar e veshur përsipër me ornamente argjendi, mbërthyer me gozhdë të gjata, qëndronte siç e kishte lënë i zoti. Me mundim të parrëfyer, me kujdes e përqendrim e tërhoqi zvarrë për ta nxjerrë jashtë shtëpisë së rrënuar nga frika e ndonjë tërmeti tjetër. Arriti ta nxjerrë jashtë, megjithëse gjaku po kullonte në duar, në qafë e deri brenda trupit dhe kur doli te pragu u ndje sikur kishte prekur qiellin me dorë. Nelo Andrea ndihej i plotësuar. Lumëmadhi kishte shpëtuar kokën dhe të fshehtën e tij. Ç’dhuratë tjetër mund t’i bënte Zoti? Kur shqeu kapakun dhe hapi sepeten u ndje dhe më pranë Zotit, në qiell. Violina *Stradivar*, të cilën kohë pas kohe e shihte në ëndërr si burim fatkeqësie, mbështjellë në kutinë e saj, ishte e paprekur. E hapi dhe e kundroi gjithë përqendrim. Ku i fshihej fuqia? Përse ia kishin ndaluar lojën me telat e saj? “Paske qenë pa mëshirë o Rako Sirani! Nuk do ta harroj kurrë këtë krim. Do të iki një orë e më parë nga kjo shtëpi e mallkuar. Ka plot njerëz të mirë në këtë vend që do të më ndihmojnë, që do të më gjejnë punë. Nuk janë të çmendur si ti. Do të iki që tani. Do të iki që tani dhe le të më çojnë ku të duan. Edhe në burg. Do ta marr me vete dhe këtë qenin e vogël, Kulinën, që të jesh i qetë. Nuk ta besoj dot ty!”

“Qetësohu. Nuk ke për të ikur asgjëkund. Nuk ke për të gjetur asnjë vend tjetër më të mirë se ky dhe askënd që të të dojë sa unë, - i kumboi në vesh zëri buçitës i Rako Siranit që sikur e kishte ndjekur nga pas.”

“Tani kam violinën time!” - Sytë e djalit nxirrnin flakë dhe zjarrthe të vegjël. Ca sekonda më pas nisi shi. Shi që binte më rrëmbim, me kokërza breshëri të pambarimta. Era që e kishte mbërthyer për fyti mëngjesin, me sa duket ia kishte mbathur duke e dorëzuar qytetin në pushtetin e rrebeshit.

Nuk priti të pushonte rrebeshi i pandalshëm. Le të çurgonte ujët mbi ujin e ndenjur në tokë. E rrëmbeu kutinë me violinën dhe i mbështolli me rrobat e trupit. Vraponte nëpër shi. Në anën tjetër të qytetit, sipër, atje ku shtëpitë e ngritura mbi shkëmb kishin rezistuar, ndërsa ato poshtë, anës përrenjve ishin rrafshuar. Vraponte rrugëve të gurta në qytetin e goditur pesëmbëdhjetë orë më parë nga tërmeti. Gërmadha kudo. Dhe fantazma që ngjanin se e ndiqnin. Ca zogj të çuditshëm, që u thonë sqepshëmtuar, u ngritën vrikthi sipër tyre duke kërritur e rënkuar sikur ishin mbushur përplot me plagë. Shtrëngonte fort kutinë. I dukej sikur kishte gjetur kryqin e florinjte të Jezu Krishtit. Atë Kryq, që ati i tij thoshte se gjendej në kishën e fshatit mbi kodrinë, Labovë e Kryqit thërritej, mu në prehër të malit Bureto. Vraponte dhe herë pas here e shtrëngonte më fort për t’u bindur se ajo gjendej aty, brenda krahëve të kryqëzuar të tij. Matanë rrugës vështroi me keqardhje një pirg ndërtesash të rrëzuara

dhe midis tyre edhe minaren e xhamisë, të thyer më dysh. “Unë u ktheva”, deshi të thërriste fort, që zëri të dëgjohej larg, mbase matanë horizontit. “U ktheva me besimin tim, me violinën time. Gjithnjë kam besuar se e keqja, sado e keqe që të jetë, një ditë do të mbarojë. Asnjë e keqe nuk mund të zgjasë pafundësisht. Të shuajë çdo kujtim. Çdo shenjë. Sado egër dhe barbarisht të jetë ngjizur. Një ditë do të shuhet.” Tani që në krahët e tij ishte krijesa më unike, më e pazëvendësueshme e jetës: violina që bën muzikë, ndihej fuqiplotë, ndriçuar nga dritë e mirësisë dhe gëzimit. Por a e dinin këtë gjë të tjerët? Këtë gjë Rako Sirani, edhe një jetë tjetër po t’i duhej nuk do t’i mjaftonte për ta mësuar.

- Erdha të marr Pandorën, - kërkoi vajzën për të cilën një ditë më parë i thanë se do të bëhej gruaja e tij.

Kristaqi, babai i vajzës, pinte cigare në dritare dhe pyeste tokën e qullur përposh se përse ishte zemëruar kaq shumë me njerëzit e këtij qyteti. Ç’inat e kishte detyruar të dridhej e të çahet ashtu, thela-thela? Sikur kërkonte të nxirrte gjithë terrin e zi prej trupit të saj. Në vend të Kristaqit u përgjigj e shoqja.

- Është e vërtetë që te Rakoja shtëpia, trarët dhe muret u rrëzuan plotësisht?

- Po, - atij iu duk se ajo pyeti: A ranë të gjitha mëkatet plotësisht?

- Vërtet? Sa keq!

- Ashtu ndodhi, - hapi kraharorin dhe nxori prej andej kutinë e violinës. - Kjo shpëtoi!

- Sa me fat që paska qenë, - Kristaqi u afrua edhe më afër, për të hapur dritaren, pasi e dinte se ishte pikërisht ora kur vinte dielli. Po dielli nuk dukej. Me ç'dukej toka nuk ishte rrotulluar si duhej ose nuk i kishte falur njerëzit e këtij qyteti. Për Kristaqin në qytet flitej se kishte qenë familje shumë e pasur, me prona të sekuestruara, por dhe florinj të fshehur kushedi se ku. Thuhej gjithashtu se nuk i njihte mirë njerëzit dhe fliste me vete. Ai s'të drejtohej asnjëherë, as kur të kishte përballë, por shikonte diku përtej, matanë, larg, aty ku vetëm mendja a skizofrenia e tij dinte të shkonte. E kishin nxjerrë në pension para kohe. Kurse ajo, e shoqja, ishte shpuzë. Nga ato gra që rrotullojnë dhe malin.

- Eh, po ti je bërë qull, - dhe sytë e saj shtrënguar nga një dhimbje e brendshme, plot drojë prej të panjohurës, me duar që dridheshin lehtë, e ftuan të vishte tesha të thata, të reja, në atë dhomën tjetër. Atje Pandora shtronte divanet, tavolinën dhe më pas merrej me kutitë e luleve në parvazet e dritares. Ajo apo Pandora ia kishin matur mirë masat dhe kjo u kuptua kur la mbi divan pantallona, këmbishë, bluzë të re dhe një pallto kafe treçerekëshe. Dhe iku. Mbetën vetëm. Ai dhe ajo. E rrëmbeu për supesh. Ajo puliti sytë si të kishte një jetë që priste atë çast, me gojën gjysmë të hapur, çarçafin e ri të shtruar mbi krevatin tek, fustanin e tejdukshëm (sytë e tij e kishin zhveshur sapo kishte mbërritur) dhe lakuriqësinë e trupit që përpëlitej nga ëndrra dhe ëndjet. E puthi fort. Pastaj butë. E mbuloi trupin e saj që dridhej nga dëshirat dhe pëshpëriti te veshi. Ishte i bindur se ajo do ta dëgjonte. Le të ishte shurdhmemece. Ajo e tërhoqi rrëmbimthi drejt shtratit. Ai e preku poshtë. Ajo fërgëlloi menjëherë dhe ai u fundos në ngasjen e epshit të saj. Digjte. Aty për herë

të parë, ai shqiptoi: Pandorkë, Pandorkë e bukur! Dhe ajo me siguri e pat dëgjuar, pasi shumë vite më pas, sa herë ai thoshte Pandorkë, ajo përgjërohej dhe shkrihej në ëndje. Kur dolën nga dhoma, Pandora nuk ia lëshonte më dorën. Në sallon ishte shtruar mëngjesi mbi tavolinë. Nelo Andrea hëngri i uritur, shpejt, pa u merakosur se ç'përshtypje do të bënte dhe më pas, kërkoi lejë të merrte Pandorën me vete.

- Mirë, - tha e ëma dhe i bëri shenjë të veçantë së bijës që të kishte mendjen në kokë. - Më beso, që në çastin e parë kur të pashë, i thashë Kristaqit: Ky është fati, fiks për Pandorën tonë! - E përqafoi, si për t'i dhënë lejë dhe bekim.

Nelo Andrea tundi kokën. E mori për dore Pandorën dhe iku. Violinën, përsëri shtrënguar në gjoks, si kryq të shenjtë.

Dhe iu ngjitën një rrëpire mbi qytet. Zall e gur. Sipër shtëpive. Andej nga Këculla. Vendi vinte i thepisur. Shqyer ngado. Me shkëmbinj e gremina që s'dihej ku e kishin fundin. Në shpellat e guvat e shumta, njerëzit e qytetit thoshin se fshiheshin ëndrrat dhe fantazmat e tyre. Qiparisa të vjetër ishin ngulur anash tyre, në zgripe, pjesën e butë të tokës. Era që frynte me shakullimë arrinte të lëkundte vetëm majat, ndërsa trupat e tyre vazhdonin të qëndronin drejt. Rrallëherë të bie rasti të shohësh gurë e shkëmbinj të përmasave të tilla. Ato kanë një pamje të murrme, herë-herë gri në të zezë. Thonë që kanë mbi vete hirin e përvëlur të dhimbjeve të tokës. Anash tyre ka rrëkeza të bleruara fshehtas, lule qumështore dhe një bimësi gjembaçe që duron çdo vuajtje. Ka dhe ujëra që rrokullisen e përplasen gurëve.

- Ku vemi? - pyetën butë sytë e saj bojëqielli.
- Prit. Ta tregoj atje sipër, - zëri i tij ishte ndryshe. Ajo e ndjeu këtë.
- Ma thuaj tani, - ngulmuan bebëzat.
- Në parajsë. Në parajsë do të vemi, - i tregoi me dorë vendin ku do të mbërrinin.

Kur mbërritën në majë, Nelo Andrea i tha Pandorës të rrinte përballë tij. Hoqi pallton treçerekëshe, e palosi me kujdes dhe ia dha asaj. Pastaj hapi kutinë e violinës *Stradivarius*. Ishte e paprekur. Si katër vjet më parë. Fletoret e muzikës dhe shënimet po ashtu. Faleminderit o Zot! E preku gjithë mall, harkun, trupin, pecetën, gjithçka. Ngriti harkun lart. Krahu u drodh. Violina lëshoi tingull. Pastaj një tjetër. Tjetër. Tinguj të pastër. Ashtu si dikur. Si paskësh ngrirë koha? Violina paska kohën e saj, të çuditshme, të përveçme, të vetëmjaftueshme, kohë që s'ka të bëjë fare me kohët e tjera të njeriut. Apo violina ka diçka të fshehtë, magjike që të rikthen aty ku ajo dëshiron? Gishtërinjtë e tij, të trashë, plot shenja çarjesh e dregëzash, befas u holluan, u zgjatën dhe kërcyen shkathtësisht mbi telat. Lëvizja e tyre fitoi shkathtësi dhe energji që as vetë nuk e kuptoi se prej nga erdhi. Era e Malit të Gjerë, frynte ende në atë grykë të thepisur që zbriste në hon të thellë nja katërqind metra poshtë, por kjo s'e pengonte të përqendrohej imtësisht në tingujt që lëshonin gishtërinjtë e tij mbi ato tela. Sa e kishte marrë malli more! Ehu ç'mall e kishte marrë! Hodhi një sy poshtë, në anën tjetër të malit, atje ku shtrihej qyteti i sakatuar. Tis gri. Si paranojë. I trashë, si llojë dëbore. Përmbi. E pengonte pamjen e vërtetë të tij. Ai ngriti kokën si kalorës, vendosi harkun mbi tela dhe i bëri shenjë Pandorës

ta ndiqte. Nisi të luante *Katër stinët* e Antonio Vivaldit. E donte veçanërisht atë vepër. I sillte ndër mend debutimin e parë si solist. Në skenën e filarmonisë të Bostonit. Në të vërtetë ai ishte një konkurs i violinistëve më të mirë dhe Nelson Andrea kishte studiuar pa pushim, ditë-natë. Konkurrenca me hebreun, izraelito-amerikan Itzhak Perlman. Ai ishte yll i violinës. Dhe kishte një violinë *Stradivarius*. Ai ishte djalë industrialisti, ndërsa ati i tij harxhoi qimet e kokës për ta blerë. Gjithë kursimet e viteve të para në Amerikë.

- Ku je sot ti, hebreu Itzhak Perlman? - nuk thërriti dot, pasi harku ishte i tëri elektrizues dhe vallëzonte mbi tela dhe i duhej të ndiqte me kujdes ritmin, duke kënduar. Tinguj të ëmbël, të lehtë, të shkëlqyer, që vraponin e lumturoheshin gëzueshëm. Çfarë kënaqësie për veshin e njeriut? Edhe qiparisat sikur kërcenin. Edhe gjembaçet fërgëllonin. Edhe era, pasi i shijonte ata tinguj, i rrotullonte për t'i mbajtur sa më gjatë për vete dhe pastaj i dërgonte larg. Çdo tingull sikur rrëfente një histori. Një histori që e kishte përjetuar, që e kishte parë me sytë e mendjes. Historia sinkronizohej me tingujt dhe të ngërthente. Të mbante shtang. Skenat e stinëve kalonin para syve, pranvera, vera, vjeshta, dimri. Ato rrëfenin se, zogjtë e mirëpresin pranverën me këngë të lumtura dhe ja tek e sjellin tingujt e kësaj muzike. Megjithatë, shpejt Nelo ngryset në fytyrë, domethënë se do të kemi një shtrëngatë. Jo vetëm që nis një stuhi muzikore si shtrëngata dhe rrufeja, por shohim edhe më shumë zogj, të lagur, të frikësuar, dhe të palumtur. Një shi breshëri po shkatërron fushat. Kur sapo jemi trishtuar mjaftueshëm, vjen “vjeshta” që sjell me vete gjuetarët e uritur, të cilët kanë dalë jashtë

në ndjekje të presë së tyre. Pas tij vjen dimri që fillon me një kërcitje dhëmbësh në të ftohtë përpara strehimit në një zjarr bubulak. Pastaj ndodhemi sërish jashtë në stuhi ku do të ketë rrëshqitje dhe të rëna mbi akull. Ditët e dimrit lëvizin të mbushura me ngjarje e dhurata, viti i vjetër po ikën, dhe po kështu edhe stinët. Ai luante si i çmendur. Pa pushim. Dhe lëvizte në ritmin e tingujve. Kaq bukur, sa...? Muzika e tij fluturonte nëpër atë pamje madhështore, nëpër shkrepë, të çara shkëmbinjsh, hone, në hapësira të pamata. E lirë. E paprekur, e pacenuar nga askush. Ndoshta dëgjohej edhe poshtë, në qytetin e mbuluar rëndshëm nga mjegulla e trashë. Ndoshta. Po Pandora ç'bënte? Gjithë kohës që ai luante, kërcente nga tingujt e violinës, ajo përplaste duart e ngazëllyer. E mrekulluar. E dëgjonte? Me siguri që e dëgjonte. E dëgjonte me veshët e shpirtit ose me sytë e butë që e përpinin gjithë dashuri, përderisa muzika e tij vazhdon të tingëllojë si një ecje kuajsh në lëvizje.

Kreu VI

- Mos më shpjer atje, në atë strehën e re, për kokën tënde,
- luteshin sytë e Pandorës gjatë rrugës. Binde Rako Siranin!

- Nuk e bëj dot. Shtëpia është vogël dhe nuk i nxë të gjitha, edhe dëshirën tënde, edhe ëndrrën time. Unë dua të qëndroj vetëm, vetëm me ty Pandorkë.

Ishte vapë dhe gurët e kalldrëmit bënë bësh-bësh. Nxirrnin dufe të nxehta, përvëlake. Muret e larta, shtrembaluqe bënë gjysma hijesh pa asnjë efekt mbi temperaturën që ishte çmendur. Bësh-bësh sikur guri do pëlcoiste.

- Po ti mund ta bindësh, - puliteshin në alarm qepallat e saj. Bëj ç'është e mundur dhe thuaj se kam mbetur shtatzënë, - dhe vuri duart mbi bark. - Shko dhe njëherë, mbase ai ndryshon mendje. Ishte ajo kohë kur Pandora kishte një lëkurë të përsosur, fizik të shkëlqyer, sytë xixëllonjë dhe dashuri pakufi. Ajo ende nuk po e kuptonte se armiku më i madh i mospranimeve të saj, ishte pikërisht goja e saj. Ajo ishte e plotë, e lakuar, mishtore që ndizte e bënte lakmitar edhe të vdekurin. Me shenja që tani ai i kuptonte mjaft mirë, ajo i thoshte atij se kishte frikë nga të pasurit frikë.

- Nuk i lutem atij njeriu. Mirë që shpëtova prej tij, - mërmëriti duke shtrënguar dhëmbët.

Dielli sipër, si një saç gjigant, nuk linte asnjë centimetër pa djegur. Thahej pështyma nën gjuhë. Ku të fshihehe?

- Thuaj që..., - nuk kishte më forcë. - Shikomë dhe kuptomë! - i thërrisnin sytë. Kishte filluar ta prekte shpirtin e burrit të saj. E ndiente që ishte lodhur, përpëlitej.

- Jo. Jo.

Dhe vijoi të ngjiste në katin e dytë, çantën e madhe me teshat e bëra deng dhe valixhen me gjërat e Pandorës.

- Të çlodhem pak dhe do të shkoj nga të tutë të marr makinën qepëse, mirë?

- Atëherë thuaj dhe nënës sime që të mos vijë të më takojë, - lotët e saj e prekën thellë.

- Nuk i them, - Nelo Andrea i mori kokën e hijshme në duar Pandora Bukëvallës dhe u ulën në një nga minderet e kreut të dhomës bosh, në hyrjen e re. - Ajo le të vijë sa herë të dojë!

Ai e kishte marrë vendimin e tij. Do të jetonte më vete. Rako Sirani i kishte sistemuar në ndërtesën e moçme të Kokolatëve. Ajo ishte e madhe, trekatëshe, madhështore, në formë U-je, sekuestruar nga shteti, ku brenda saj Këshilli Popullor pas disa restaurimeve përshtatëse kishte strehuar pesë familje. Nelos i kishin dhënë dy dhoma në katin e dytë me pamje nga rruga e madhe dhe një kube në katin e parë. Brenda kubesë së gjatë si vagon treni, ishte banja, ulluqet dhe tubacionet e sterës së ujit.

Neloja u ngrit nga divani prej dërrasash të vjetra që tundeshin dhe eci drejt dritares ballore. Ajo ishte gati dy metra e lartë dhe një e gjysmë e gjerë. E hapi me vështirësi. Në dhomë hyri drita. Dritë e fortë. Me tepri. Pastaj ai e mori përsëri në duar kokën e saj si statujë antike. Afroi trupin. Sa hijshëm i derdhej fustani në trup!

- Sot do të bëjmë atë që vlen ta bëjmë sot! - dhe sepse iu kujtua ajo batuta e adoleshencës: - s'ka burra të shenjtë në këtë botë!

Nuk mendoi asgjë dy herë, por e puthi me afsh. Më pas i hoqi fustanin. Dhe u prekën, dhe i dhanë frymë njëri-tjetrit, dhe u shqepën duke bërë dashuri. Fije-fije. E gjithë qenia e tij sikur thoshte: “Është mirë ta kemi dhimbjen e kësaj dite me vete. Ta lëmë, hë për hë, diku, në raftet e kujtesës, si relikte apo shajni për të na kujtuar se do ta kemi një ditë kohën e duhur për shpagimin tonë!”.

- Tani po shkoj të marr gjërat e tjera, - dhe u çua të vishej. - Me siguri me mua do të vijë edhe nëna që të sjellë mbulesat dhe enët e kuzhinës. Mos më rri ashtu, kujdesu për veten dhe fëmijën që presim!

Pandora kryqëzoi shikimin dhe duart mbi gjoks, sikur dëshiroi të thoshte që tani, për të do të kujdesej vetëm ai dhe Zoti.

Shtëpia e Kristaq Bukëvallës gjendej në krahun tjetër të rrugës, rreth treqind metra larg asaj të Nelo Andreas. E kthyer e gjitha me pamje nga perëndimi. Me portë e kangjella hekuri, mur rrethues, oborr të vogël, një tendë hekuri për hardhitë dhe pemën e manjolës në fund. Dritaret të gjitha ishin me lule. Shtëpi dykatëshe, ku balli i shtëpisë, që nxirrte në pah dritaret e sipërme, vinte i pjerrët skiç mbi muret bazament të katit të parë. E bardhë e gjitha. Nelo Andrea i ra ziles dhe ajo u hap menjëherë. Vjehrra e priste. E kishte përgjuar nga dritarja. Plaçkat ishin shumë. Korridori i katit të parë mbushur plot me sende, karrige, llambadarë, relikte, enë kuzhine e qilima. Ngjante se pjesa tjetër e shtëpisë ishte zbrazur.